

VJETARI STATISTIKOR



2018

Vjetari Statistikor 2018

Drejt看 botimi:
Delina Ibrahimaj

Punoi: INSTAT

© **Copyright INSTAT 2018**

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo
transmetimi i tij në cilëndo formë,
pa autorizimin paraprak me shkrim të mbajtësit të
së drejtës së autorit.



INSTITUTI I STATISTIKAVE
Rr. Vllazen Huta, Nd.35, H.1
Njësia Administrative Nr.2, 1017
Tiranë / Albania
Tel: + 355 4 2222411 / 2233356
Fax: + 355 4 2228300
e-mail: info@instat.gov.al
www.instat.gov.al



PËRMBAJTJA

1. POPULLSIA	5
2. STATISTIKAT JURIDIKE	15
3. MBROJTJA SOCIALE	22
4. SHËNDETËSIA	28
5. ARSIMI	37
6. TREGU I PUNËS	45
7. STATISTIKAT E KONSUMIT	61
8. INDEKSI I ÇMIMEVE TË KONSUMIT	65
9. REGJISTRI STATISTIKOR I NDËRMARRJEVE	70
10. TREGTIA E JASHTME	76
11. BUJQËSIA	84
12. BLEGTORIA	93
13. PYJET DHE BIODIVERSITETI	102
14. REZULTATET E ANKETËS STRUKTURE TË NDËRMARRJEVE	108
15. STATISTIKAT AFATSHKURTRA	118
16. TURIZMI	126
17. MJEDISI	128
18. ENERGJIA	132
19. TRANSPORTI	140
20. PRODUKTI I BRENDSHËM BRUTO (PBB)	143

POPULLSIA



I Hyrje

Ky kapitull jep një përshkrim të zhvillimeve të fundit në popullsinë e Shqipërisë, duke marrë në konsideratë disa nga treguesit kryesorë demografikë, duke përfshirë informacionin mbi ndryshimet në numrin e popullsisë përgjatë viteve 2013-2017, dendësinë e popullsisë, lindshmërinë, jetëgjatësinë dhe raportet e varësisë moshore. Treguesit e pasqyruar sugjerojnë një rënie të lehtë të popullsisë në periudhën në fjalë, e cila po shkon drejt procesit të plakjes si rezultat i rritjes së jetëgjatësisë dhe lindshmërisë që vazhdon të mbetet nën nivelin e zëvendësimit.

I Popullsia dhe ndryshimet e popullsisë

Zhvillimet e fundit demografike tregojnë se popullsia e Shqipërisë po zvogëlohet, ndërkohë që struktura e saj tregon se popullsia po shkon drejt plakjes. Kjo si pasojë e rritjes së jetëgjatësisë, dhe nga ana tjetër e lindshmërisë e cila vazhdon të jetë nën nivelin e zëvendësimit.


Dendësia e popullsisë në mes të vitit 2017 është 100 banorë për km², vlerë e cila ka pësuar një rënie shumë të vogël në pesë vitet e fundit.

Tab. 1
Popullsia mesatare sipas gjinisë dhe dendësia, 2013-2017

Popullsia Mesatare (në mijë)			Dendësia
2013	Gjithsej	2.895	100,7
	Meshkuj	1.461	
	Femra	1.434	
2014	Gjithsej	2.889	100,5
	Meshkuj	1.461	
	Femra	1.428	
2015	Gjithsej	2.881	100,2
	Meshkuj	1.460	
	Femra	1.421	
2016	Gjithsej	2.876	100,0
	Meshkuj	1.456	
	Femra	1.420	
2017	Gjithsej	2.873	100,0
	Meshkuj	1.446	
	Femra	1.427	

Nga 1 Janari 2013 deri në 1 Janar të 2018 popullsia e Shqipërisë është zvogëluar me rreth 27 mijë banorë, ose ka rënë mesatarisht me 0,19 % në vit.


Fig. 1
Popullsia sipas gjinisë, 2013-2017



Ndryshimet në popullsi vijnë si rezultat i dy komponentëve: shtesës natyrore të popullsisë dhe migracionit neto. Shtesa natyrore e popullsisë ka

pësuar rënie gjatë tre viteve të fundit, kjo si pasojë e rënies së numrit të lindjeve dhe rritjes së numrit të vdekjeve.


Fig. 2
Lindjet, vdekjet dhe shtesa natyrore, 2013-2017



Migracioni neto negativ (flukset dalëse tejkalojnë flukset hyrëse) ka luajtur një rol thelbësor në rënien e popullsisë në vendin tonë. Figura 3 pasqyron ndryshimet në popullsi si pasojë e ndryshimeve në dy komponentët kryesorë. Siç mund të vihet

re, ndryshimet në migracionin neto pasojnë ndryshimet në popullsi. Kjo për faktin se një impakt të rëndësishëm në ndryshimin e popullsisë e jep balanca e migracionit neto.

Fig. 3
Komponentët e ndryshimit të popullsisë, 2012-2016




I Struktura e popullsisë

Në vitin 2017, në popullsinë mesatare gjithsej të Shqipërisë, të rinjtë 0-14 vjeç zënë 17,9 %, popullsia në moshë pune 15-64 vjeç zë 68,7 % dhe popullsia mbi 65 vjeç përbën 13,4 % të popullsisë gjithsej. Figura 4 pasqyron trendin e zhvillimeve që

kanë ndodhur për grupmoshat në fjalë. Tendenda drejt procesit të plakjes së popullsisë në të ardhmen vihet re nga rritja e lehtë e përpjesës që zë popullsia 65 vjeç e lart, shoqëruar kjo me uljen e numrit të popullsisë në moshë të re (0-14 vjeç).


Fig. 4
Popullsia mesatare sipas 3 grupmoshave kryesore, 2013-2017



Ky trend mbështetet nga projeksionet e popullsisë. Pritet që të ketë një reduktim në numrin e popullsisë për grupmoshën 0-14 vjeç dhe 15-64 vjeç, kështu që në vitin 2060 grupmosha 15-64 vjeç pritet të arrijë rreth 1,4 milion nga 2,0 milionë në vitin 2017. Ndërsa grupmoshat 65-79 dhe 80+ pritët të kenë një rritje gjatë periudhës në fjalë.

Tabela e mëposhtme paraqet raportet e varësisë moshore, tregues i cili analizon edhe më qartë strukturën e popullsisë. Raportet e varësisë llogariten duke krahasuar numrin e personave (të rinjtë 0-14 vjeç dhe/ose të moshuarit 65+ vjeç) me popullsinë në moshë pune. Për vitin 2017 raporti i varësisë së të moshuarve në Shqipëri është 19,4 % kundrejt 17,3 % në vitin 2013. Nga ana tjetër, raporti i varësisë së të rinjve në vitin 2017 është 26,0 % kundrejt 29,0 % në vitin 2013, duke folur kështu për një tendencë në rënie të këtij raporti në vendin tonë.

Fig. 5
Projeksionet e popullsisë sipas grupmoshave kryesore, 2021-2060



Tab. 2
Treguesit e strukturës së popullsisë, 2013-2017

	Mosha mesatare	Raporti i varësisë së të rinjve	Raporti i varësisë së të moshuarve	Raporti i varësisë gjithsej
	(vite)		(%)	
2013	35,8	29,0	17,3	46,3
2014	36,2	28,2	17,9	46,0
2015	36,6	27,3	18,4	45,7
2016	37,0	26,7	18,9	45,5
2017	37,4	26,0	19,4	45,5

Piramidat e popullsisë tregojnë shpërndarjen e popullsisë sipas gjinisë dhe moshës. Figura 6, 7 tregojnë ndryshimet në strukturën e popullsisë duke krahasuar popullsinë më 1 Janar 2013 dhe 1 Janar 2018 si dhe popullsinë e projektuar.

Piramidat e popullsisë 2018 dhe 2060 tregojnë se popullsia e Shqipërisë është projektuar të vazhdojë të plakët. Në dekadat e ardhshme numri i lartë i të lindurve në vitet 60 (baby boomers) do të ndikojë në rritjen e koeficientit të varësisë së të moshuarve.

Fig. 6
Piramida e popullsisë, 2013-2018





Fig. 7
Piramida e popullsisë, 2018-2060



Mosha medianë dhe ajo mesatare e popullsisë janë indikatorë të cilët tregojnë qartë tendencat drejt plakjes së popullsisë sonë. Mund të vihet re një rritje e ndjeshme e moshës medianë e cila arrin në 35 vjeç në vitin 2017 nga 33 vjeç që ka qenë në vitin 2013. Mosha medianë 35 vjeç tregon se gjysma e popullsisë gjithsej është më e re se kjo moshë dhe gjysma tjetër më e madhe. Nga ana tjetër mosha mesatare shënon vlerën 37 vjeç në vitin 2017, vlerë kjo më e lartë se ajo e vitit 2012 me rreth 2 vjet.

Martestat dhe divorcet

Në vitin 2017 janë regjistruar në zyrat e gjendjes civile rreth 23 mijë martesa, ose e shprehur si koeficient bruto 7,9 martesa për 1.000 banorë. Ky koeficient ka pësuar luhatje gjatë periudhës pesëvjeçare 2013-2017.

Divorcet për vitin 2017 shënojnë një rritje me 4.508 raste nga 3.747 divorce të ndodhura në 2013. Gjatë viteve 2013-2017 vihet re një rritje e kësaj norme nga 1,3 divorce për 1.000 banorë në 2013, në 1,6 divorce për 1.000 banorë në 2017.

Fig. 8
Mosha mesatare dhe mosha medianë e popullsisë, 2013-2017





Fig. 9
Koeficientët bruto të martesave dhe divorceve, 2013-2017



Muaji më i pëlqyer nga shqiptarët për të lidhur martesë gjatë kësaj periudhe 5 vjeçare është muaji Gusht dhe pasuar nga muaji Shtator.

Tab. 3
Martestat sipas muajit të martesës, 2013-2017

Muajt	2013	2014	2015	2016	2017
Gjithsej	23.820	23.769	24.997	22.562	22.641
Janar	2.168	2.207	2.221	1.894	1.895
Shkurt	1.820	1.792	1.844	1.741	1.719
Mars	1.780	1.758	1.975	1.711	1.771
Prill	1.894	1.840	2.024	1.599	1.658
Maj	1.756	1.690	1.748	1.710	1.929
Qershor	1.583	1.568	1.979	1.433	1.662
Korrik	1.841	1.627	2.222	1.573	1.794
Gusht	2.769	2.732	3.050	2.811	2.696
Shtator	2.255	2.359	2.207	2.110	2.022
Tetor	2.059	2.158	2.075	2.135	2.118
Nëntor	1.756	1.721	1.668	1.809	1.639
Dhjetor	2.139	2.317	1.984	2.036	1.738

Lindshmëria

Gratë në Shqipëri po lindin gjithmonë e më pak fëmijë duke ngadalësuar kështu shtesën natyrore të popullsisë. Në vitin 2013 ky indeks shënon vlerën 1,73 fëmijë për grua duke ruajtur pothuajse të njëjtën vlerë deri në vitin 2014 dhe më pas ky tregues ka pësuar rënie deri në 1,48 fëmijë për grua në 2017. Ky indeks është nën nivelin e zëvendësimit prej 2,1 fëmijë për grua.

Nëse i referohemi normave specifike të lindshmërisë (lindjet për 1.000 gra), numri më i lartë i lindjeve regjistrohet në grupmoshën 25-29 vjeç, ndjekur nga grupmosha 20-24 vjeç. Gjatë periudhës 2013-2017, normat specifike të lindjeve kanë pësuar rënie vit pas viti në grupmoshat 20-24 dhe 25-29 vjeç. Ndërsa e kundërta mund të thuhet për një rritje të normave specifike të lindjeve gjatë vitit 2017 në grupmoshat 30-34 dhe 35-39 vjeç.

Fig. 10
Indeksi sintetik i fekonditetit, 2013-2017





Fig. 11
Normat specifike të lindshmërisë, 2013-2017



Lindjet sipas muajit të lindjes përgjatë viteve 2013-2017 shënojnë numrin më të madh të tyre në muajin Shtator dhe pasuar nga muaji Korrik.

Tab. 4
Lindjet sipas muajit të lindjes, 2013-2017

Muajt	2013	2014	2015	2016	2017
Gjithsej	35.750	35.760	32.715	31.733	30.869
Janar	2.839	2.837	2.742	2.517	2.423
Shkurt	2.408	2.491	2.350	2.274	2.169
Mars	2.621	2.674	2.554	2.372	2.324
Prill	2.450	2.708	2.489	2.269	2.231
Maj	2.870	2.955	2.766	2.456	2.541
Qershor	3.062	3.078	2.736	2.640	2.711
Korrik	3.451	3.519	2.986	2.999	2.814
Gusht	3.258	3.273	2.733	2.946	2.827
Shtator	3.499	3.537	2.996	3.141	2.898
Tetor	3.429	3.165	2.923	2.882	2.803
Nëntor	2.949	2.776	2.596	2.580	2.538
Dhjetor	2.914	2.747	2.844	2.657	2.590

I Vdekshmëria dhe jetëgjatësia

Në vitin 2017 jetëgjatësia për femrat është 80,0 vjet dhe 77,1 vjet për meshkujt. Gjatë kësaj periudhe 2013-2017 jetëgjatësia për femrat ka qëndruar pothuajse në nivele të njëjta ndërsa për meshkujt ka pësuar rritje krahasuar me vitin 2013.

Ndër vite diferencat gjinore në jetëgjatësinë në lindje kanë ardhur në rënie, kështu viti 2017 shënon një diferencë prej 2,9 vjet midis 2 gjinive, ndërkohë në vitin 2013 kjo diferencë ishte 4,3 vjet.

Fig. 12
Jetëgjatësia në lindje sipas gjinisë, 2013-2017





Fig. 13
Jetëgjatësia në lindje, diferencat gjinore, 2013-2017




Në vitin 2017, në zyrat e gjendjes civile regjistrohen rreth 22,2 mijë të vdekur gjithsej, rreth 3,9 % më shumë vdekje se një vit më parë, ose 9,8 % më shumë vdekje krahasuar me vitin 2013.

Vdekjet foshnjore gjatë kësaj periudhe 5 vjeçare, kanë pësuar luhatje, me tendencë në rënie në vitin 2015 me 233 të vdekur dhe në vitin 2017 me 248 të vdekur.

Numri i vdekjeve foshnjore është më i lartë tek meshkujt sesa te femrat gjatë periudhës 2013-2017.

Fig. 14
Vdekshmëria foshnjore sipas gjinisë, 2013-2017



I Burimi i të dhënave

INSTAT mbledh një gamë të gjerë të dhënash demografike duke përfshirë statistika të popullsisë në nivel kombëtar dhe rajonal, si dhe të dhëna për eventet demografike të cilat kanë një ndikim në madhësinë dhe në strukturën e popullsisë. Për drejtorinë e statistikave sociale burimet kryesore të të dhënave, për përmbushjen e objektivave në llogaritjen e treguesve specifik janë të dhënat administrative dhe Censuset e Popullsisë dhe Banesave.

Burimet administrative:

- Lindjet, Vdekjet, Martesat

Të dhënat e lindjeve, vdekjeve dhe martesave dërgohen elektronikisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Kjo mënyrë e dërgimit të të dhënave të eventeve demografike siguron një plotshmëri më të lartë dhe përmbushjen e afateve të publikimeve përkatëse.

- Censusi i popullsisë dhe banesave

Censusi i popullsisë dhe banesave, 2011 është një burim mjaft i rëndësishëm për statistikat e popullsisë. Ai shërben si bazë për vazhdimësinë e përlllogaritjeve vjetore të numrit të popullsisë.

I Përkufizime

Statistikat vitale: Janë të dhëna demografike mbi lindjet, vdekjet, vdekjet nën 1 vjeç dhe martesat. Lindje e gjallë: Lindjet e fëmijëve që shfaqën shenja jete. Është numri i lindjeve që përjashtojnë lindjet e vdekura.

Vdekje: Nënkupton zhdukjen e përhershme të të gjitha shenjave të jetës në çdo kohë pasi ka ndodhur një lindje e gjallë (ndërprerjen e funksioneve vitale pa aftësinë e ringjalljes). Shtesa natyrore e popullsisë: Shpreh rritjen/rënien e popullsisë si rezultat i proceseve biologjike (lindjeve dhe vdekjeve) të saj gjatë një periudhe kohe. Pra diferenca midis lindjeve dhe vdekjeve në një vit të caktuar shpreh shtesën natyrore të popullsisë për atë vit.

Densiteti i popullsisë: Numri i banorëve për njësi sipërfaqeje toke (për km²).

Koeficienti i rritjes së popullsisë: Është frekuenca me të cilën një popullsi rritet (ose zvogëlohet) në një vit të dhënë në sajë të rritjes natyrore dhe

migracionit neto, shprehur si përqindje e popullsisë bazë.

Raporti i varësisë së përgjithshme: Raporti i numrit të personave nën moshën e punës (0-14 vjeç) dhe personave të vjetër mbi moshën e punës (65+ vjeç), me numrin e personave që janë në moshë për të punuar (nga 15 deri në 64 vjeç) shprehur në përqindje.

Raporti i varësisë së të rinjve: Raporti i numrit të personave nën moshën e punës (0-14 vjeç), me numrin e personave që janë në moshë pune (nga 15 deri në 64 vjeç), shprehur në përqindje.

Raporti i varësisë së të moshuarve: Raporti i numrit personave të vjetër (65+ vjeç), me numrin e personave që janë në moshë pune (15 deri në 64 vjeç), shprehur në përqindje.

Migracioni neto: Është diferenca midis imigracionit dhe emigracionit të popullsisë së një territori të caktuar në një periudhë të dhënë kohe.

Norma bruto e martesave: Është numri i martesave për 1000 banorë të një territori të caktuar në një vit të dhënë.

Norma bruto e divorceve: Është numri i divorceve për 1000 banorë të një territori të caktuar në një vit të dhënë.

Indeksi sintetik i fekonditetit: Numri mesatar i fëmijëve që një grua mund të lindë gjatë periudhës së saj riprodhuese 15-49 vjeç.

Jetëgjatësia mesatare në lindje: Numri mesatar i viteve që një i lindur sot pritët të jetojë, duke marrë parasysh normat korrente të vdekshmërisë.



STATISTIKAT JURIDIKE

I Hyrje

Statistikat juridike të prezantuara në këtë seksion pasqyrojnë të dhëna mbi veprat penale të ndodhura gjatë një viti, autorë, të dhëna mbi personat e dënuar në gjykatat e shkallës së parë si dhe të burgosur sipas veprave penale të kryera për vitet 2013-2017.

I GJETJET KRYESORE

I Vepra penale

Veprat me të cilat cënohen, dëmtohen vlerat juridike të njeriut dhe të bashkësisë së caktuar quhen vepra penale apo me një term të përgjithshëm kriminalitet.

Në vitin 2017 janë evidentuar 34.317 vepra penale gjithsej, 1,5 % më shumë se në vitin 2016, ose shprehur në terma absolut 509 më shumë vepra të evidentuara.

Për të paraqitur një informacion më të qartë për shpërndarjen e kriminalitetit në vend është paraqitur figura 1, e cila paraqet normën e kriminalitetit shprehur për 10 mijë banorë. Kjo normë tregon numrin e veprave penale për 10 mijë banorë, duke i vënë veprat në raport me popullsinë banuese. Në vitin 2017, kjo normë regjistron 119.4 vepra penale të evidentuara për 10 mijë banorë. Kjo normë ka ardhur në rritje nga 2013 në 2015, në vitet në vijim vihet re një rënie e lehtë.


Figura 2 ilustron normën e vrasjeve me dashje të ndodhura gjatë një viti shprehur për 100 mijë banorë. Nga figura shohim që trendi i vrasjeve është në rënie gjatë periudhës 2013-2017. Viti 2017 regjistron normën më të ulët, 1.7 vrasje për 100 mijë banorë.

Tab. 1
Vepra penale të evidentuara, 2013-2017

Veprat penale	2013	2014	2015	2016	2017
Vrasje	104	98	54	71	50
Vrasje mbetur në tentativë	206	156	138	132	129
Plagosje e lehtë me dashje	1.340	1.463	1.312	1.122	1.165
Krime seksuale	87	97	149	120	113
Vjedhje pasurie	6.064	8.635	6.980	5.466	4.985
Fallsifikime	533	553	771	946	1093
Mashtrime	563	546	803	1.031	1.127
Krime kundër pastrimit të parasë	125	326	341	364	377
Krime në fushën e drogës	1.334	1.776	2.321	3.249	2.071
Shkelje rregullave të qarkullimit rrugor	2.987	4.315	5.003	4.983	5.002
Krime të tjera	10.743	14.959	17.992	16.324	18.205
Gjithsej	24.086	32.924	35.864	33.808	34.317


*) Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Fig. 1
Vepra të evidentuara për 10 mijë banorë, 2013-2017



*) Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, INSTAT

Fig. 2
Norma e vrasjeve



*) Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, INSTAT

Autorët

Të dhënat mbi veprat penale dhe autorët sigurohen nga Drejtoria e Policisë së Shtetit dhe bëjnë fjalë për persona të dyshuar në kryerjen e një vepre penale.

Tabela 2 paraqet autorët sipas vepra penale për vitet 2013-2017. Në vitin 2017 janë evidentuar 36.051 autorë gjithsej, 4,0 % më shumë autorë ose shprehur në terma absolut rreth 1.377 autorë më shumë krahasuar me vitin 2016.


Figura 3 paqyron se sa përqind e personave të dyshuar dënohen nga gjykatat e shkallës së parë. Viti 2016 shënon 40,2 % persona të dyshuar në kryerjen e një vepre penale të cilët janë dënuar.

Tab. 2
Autorët sipas veprave, 2013-2017

Veprat penale	2013	2014	2015	2016	2017
Vrasje	123	110	81	80	48
Vrasje mbetur në tentativë	244	196	190	164	156
Plagosje e lehtë me dashje	1.623	1.802	1.711	1.488	1.576
Krime seksuale	89	101	163	127	111
Vjedhje pasurie	3.832	5.423	5.399	4.377	3.698
Fallsifikime	561	572	905	1.079	1.142
Mashtrime	557	589	855	1.086	1.141
Krime kundër pastrimit të parasë	148	403	463	452	466
Krime në fushën e drogës	1.413	1.692	2.189	2.489	2.482
Shkelje rregullave të qarkullimit rrugor	2.972	4.279	4.945	4.872	4.961
Krime të tjera	10.281	14.426	20.211	18.460	20.270
Gjithsej	21.843	29.593	37.112	34.674	36.051

*) Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Fig. 3
Norma e fajësisë tek personat e dyshuar, 2013-2017



*) Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, INSTAT

Shënim: Përqindja e personave të dyshuar në kryerjen e një vepre penale të cilat janë dënuar.

I Dhuna në familje

Tabela 3 ilustron raportimet e dhunës në polici në këtë periudhë 5 vjeçare, kërkesat për urdhër mbrojtje nga personat e dhunuar si dhe numri i personave të dyshuar lidhur me këtë fenomen. Nga tabela shohim që rastet e raportimit kanë ardhur në rritje, edhe si faktor i ndërgjegjësimit të popullsisë lidhur me këtë fenomen.

Tab. 3
Dhuna në familje, 2013-2017

Dhuna në familje	2013	2014	2015	2016	2017
Raste të evidentuara nga policia	3.020	4.121	3.448	3.695	4.005
Nga të cilët të vdekur	28	22	20	16	13
Kërkesa për urdhër mbrojtje	1.851	2.422	2.148	2.207	2.593
Autorët	2.951	3.991	3.534	3.845	4.166

*) Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Nga të dhënat e siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë rezulton se në vitin 2017 si rezultat i dhunës në familje janë regjistruar 13 vdekje, rreth 3 më pak se në vitin 2016. Ndërkohë krahasuar me vitin 2013 kemi 15 raste më pak. Lidhur me personat e dyshuar që ushtrojnë dhunë rezulton që në vitin 2017 janë 4.166 autorë, shprehur në terma absolute kemi 321 autorë më shumë se 2016. Nga tabela shohim që numri i personave të dyshuar ka ardhur në rritje gjatë periudhës 2013-2017, si rezultat edhe i rritjes së numrit të raportimeve.


I Persona të dënuar

Të dënuar, ky term u shqiptohet personave të cilët me veprat apo sjelljet e tyre kanë cënuar apo kanë dëmtuar të mirat juridike që mbrohen me ligj. Ndaj këtyre personave aplikohen sanksione penale të cilat konsistojnë në marrjen apo kufizimin e disa të drejtave të cilat i kanë gëzuar deri në momentin e kryerjes së veprës penale, sanksione këto që konsistojnë në dënime me burg, gjobë ose dënime alternative.

Në vitin 2017 janë 10.903 të dënuar, 90,6 % e të dënuarve janë burra dhe 9,4 % janë gra. Në krahasim me vitin 2016 janë 25,4 % më pak të dënuar, ose shprehur në terma absolut kemi 3.711 të dënuar më pak.


Figura 5 pasqyron përqindjen e të dënuarve nën 18 vjeç për vitet 2013-2017. Nga figura vihet re një rënie e kësaj përqindjeje, vit pas viti numri i të dënuarve të mitur ka rënë.

Fig. 4
Të dënuar sipas gjinisë, 2013-2017



*) Ministria e Drejtësisë

Fig. 5
Të dënuarit e mitur, 2013-2017



*) Ministria e Drejtësisë

Shënim: Përqindja e personave nën 18 vjeç që janë dënuar në totalin e gjithë personave të dënuar.

I Të burgosurit

Të dhënat për të burgosurit përfshijnë personat e mitur dhe të rritur të cilët janë dënuar me vendim të formës së prerë në të gjitha llojet e qendrave të burgimit, gjithashtu baza e të dhënave përfshin edhe të dhëna për të paraburgosurit. "I paraburgosur" nënkupton çdo person, shtetas shqiptar, i huaj, ndaj të cilit është marrë masë sigurimi "arrest me burg", ndërkohë "i dënuar me burg" nënkupton çdo person, shtetas shqiptar, i huaj, i dënuar me burgim me vendim të formës së prerë të gjykatave shqiptare.

Në vitin 2017 numërohen 5.418 të burgosur gjithsej, 8,9 % më pak krahasuar me 2016. Në Shqipëri norma e ndryshimit midis vitit 2013 dhe 2017 është 8,4 %, që do të thotë se në vitin 2017 janë 8,4 % më shumë të burgosur se në vitin 2013, ose shprehur në terma absolute janë 420 të burgosur më shumë se në vitin 2013.

Për të pasqyruar një informacion më të qartë për peshën që zë popullsia e burgosur në totalin e popullsisë është paraqitur figura 6, e cila ilustron normën e të burgosurve për të gjitha veprat penale shprehur për 10 mijë banorë. Gjithashtu në figurë janë paraqitur dhe numri i të burgosurve dhe të paraburgosurit. Në vitin 2017 janë 18.9 të burgosur për 10 mijë banorë. Nga figura shohim që norma e

të burgosurve ka ardhur në rritje nga viti 2013 deri në 2015, ndërkohë viti 2016 dhe 2017 shënon një rënie të kësaj norme.


Figura 7 pasqyron përqindjen e të paraburgosurve të ndodhur në privim lirie. Viti 2017 shënon 43.1 % të paraburgosur në burgje. Nga 5.418 të burgosur në total, 2.335 janë të paraburgosur. Kjo normë ka ardhur në rritje nga viti 2012 deri në vitin 2015, ndërkohë në vitin 2016 dhe 2017 kemi një rënie të saj krahasuar me vitin 2015.

Tab. 4
Të burgosur sipas grupmohave dhe gjinisë, 2013-2017

	2013	2014	2015	2016	2017
Të burgosur(dënuar me burg)	2.942	2.838	2.985	3.104	3.083
Të burgosur të rritur	2.923	2.829	2.972	3.089	3.076
Të burgosur të mitur	19	9	13	15	7
Të paraburgosur	2.056	2.615	3.143	2.842	2.335
Të burgosur të rritur	1.977	2.531	3.069	2.799	2.303
Të burgosur të mitur	79	84	74	43	32
Gjithsej	4.998	5.453	6.128	5.946	5.418


*) Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

Fig. 6
Numri i të burgosurve dhe norma e të burgosurve për 10 mijë banorë, 2013-2017



*) Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, INSTAT

Fig. 7
Të paraburgosur në privim lirie, 2013-2017



*) Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, INSTAT

I Burimi i të dhënave

Për statistikat juridike, burime të dhënash në përmbushjen e treguesve të ndryshëm janë të dhënat administrative. Të dhënat për veprat penale, autorët e veprave penale dhe dhunën në familje, i sigurojmë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë. Baza e të dhënave përfshin gjithashtu të dhëna për të burgosurit dhe të dënuarit. Të dhënat për të burgosurit i sigurojmë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, të dhënat për të dënuarit i sigurojmë nga Ministria e Drejtësisë, burime këto shumë të rëndësishme për mbarrëvajtjen e punës dhe për përmbushjen e afateve të caktuara.

I Përkufizime

Vepra penale: Veprat me të cilat çënohen, dëmtohen vlerat juridike të njeriut dhe të bashkësisë së caktuar quhen vepra penale apo me një term të përgjithshëm kriminalitet. Ato ndahen në krime dhe kundravajtje penale.

Autorë: Persona të cilët me veprimin ose mosveprimin e tyre lejon që të ndodh një vepër penale pra shkakton pasojën e veprës penale. Autorët mbi 14 vjeç kanë përgjegjësi penale ndërkohë fëmijët nën 14 vjeç janë të përjashtuar nga përgjegjësia penale.

Dhuna në familje: përfshihen ato akte si rrahja, apo vepër tjetër dhune, kanosja serioze për vrasje ose plagosja e rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ish bashkëshort, bashkëjetues apo ish bashkëjetues, fëmijë apo pjestar familjeje, me pasojë cënimin e integritetit fizik, psikosocial dhe ekonomik të tij.

I dënuar: personi i cili me veprat apo sjelljet e tij i ka cënuar apo ka dëmtuar të mirat juridike që mbrohen me ligj. Ndaj këtyre personave aplikohen sanksione penale të cilat konsistojnë në marrjen apo kufizimin e disa të drejtave të cilat i kanë gëzuar deri në momentin e kryerjes së veprës penale.

I burgosur: çdo person, shtetas shqiptar, i huaj apo pa shtetësi, i dënuar me burgim me vendim të formës së prerë të gjykatave shqiptare dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare edhe të gjykatave të huaja, duke respektuar kërkesat përkatëse procedurale.

I paraburgosur: çdo person, shtetas shqiptar, i huaj

apo pa shtetësi, ndaj të cilit është marrë masë sigurimi "arrest në burg".

Koeficienti i kriminalitetit: Numri i veprave penale të evidentuara për 10 mijë banorë, duke i vënë veprat në raport me popullsinë banuese.

Norma e vrasjeve: Numri i vrasjeve të ndodhura gjatë një viti ndaj popullsisë shprehur për 100 mijë banorë.

Norma e të burgosurve: Numri i të burgosurve (dënuar me burg + paraburgosur) gjatë një periudhe 1 vjeçare ndaj popullsisë shprehur për 10 mijë banorë.

MBROJTJA SOCIALE



I Hyrje

Ky nënkapitull analizon statistikën mbi mbrojtjen sociale në Shqipëri për vitet 2013-2017. Mbrojtja sociale përfshin të gjitha ndërhyrjet e bëra nga organet shtetërore dhe private, që kanë si qëllim lehtësimin e barrës së familjeve apo individëve për një sërë nevojash dhe funksionesh të caktuara. Ajo mbulon ndihmën financiare dhe shërbimet që u sigurohen personave/familjeve në nevojë ose atyre që janë të rrezikuar për të qenë të varfër.

Në këtë nënkapitull gjenden të dhëna mbi kontribuesit në skemën e sigurimeve shoqërore; numrin e përfituesve të pensioneve sipas gjinisë; masën e pensioneve, numrin e familjeve dhe fondin e ndihmës ekonomike sipas strukturës së familjeve; llojit të ndihmës, si edhe të dhëna rreth papunësisë së regjistruar dhe pagesës së papunësisë.

I Gjetjet Kryesore


I Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore

Shpenzimet për sigurimet shoqërore janë komponenti që zë peshën më të madhe në shpenzimet për mbrojtjen sociale. Shpenzimet për sigurimet shoqërore, në raport me Produktin e Brendshëm Bruto nominal, kanë ardhur në rritje gjatë periudhës 2013-2017 (Tabela 1). Shpenzimet për sigurimet shoqërore në vitin 2017 përbënin 7,7 % të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) nominal. Shpenzimet për sigurimet shoqërore gjatë vitit 2017 shfaqën një tendencë me 1,2 % krahasuar me vitin 2016.

Gjatë vitit 2017, shpenzimet për sigurimet shëndetësore janë mesatarisht 2,5 % e PBB-së (Tabela 1).

Norma e varësisë së sistemit të sigurimeve shoqërore, që shpreh numrin e kontribuesve për një përfitues, (Figura 1) pëson një rritje të lehtë gjatë vitit 2016-2017. Rritja e numrit të kontribuesve gjatë vitit 2017 sjell një përmirësim të këtij treguesi, i cili nga 1,17 kontribues për një përfitues që ishte në fund të vitit 2016 shkon në 1,21 kontribues për një përfitues në fund të vitit 2017. Gjatë vitit 2017, rritja e numrit të pensionistëve ishte më e vogël se rritja e numrit të kontribuesve, e cila solli edhe një rritje të lehtë të normës së varësisë (Tabela 2).

Fig. 1
Norma e varësisë së sistemit



Norma e varësisë së sistemit (Raporti kontribues - përfitues)

Burimi i informacionit: Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Raport vjetor 2017

Gjatë vitit 2017, struktura e pensioneve urbane dhe rurale sipas llojit të pensionit është thajse e njëjtë. Mesatarisht 78 % e pensioneve urbane janë pensione pleqërie; 13 % pensione invaliditeti dhe 9 % pensione familjare (Tabela 3). Mesatarisht 89 % e pensioneve rurale janë pensione pleqërie, 6 % pensione invaliditeti dhe 5 % pensione familjare (Tabela 4). Masa mesatare mujore urbane e pensionit të pleqërisë në vitin 2017 u rrit me 4,4 % dhe masa mesatare mujore rurale e pensionit të pleqërisë u rrit me 2,9 %, krahasuar me vitin 2016 (Tabela 5).

I Ndhimja ekonomike dhe pagesa e papunësisë

Ndhimja Ekonomike është një nga skemat kryesore që ka si qëllim uljen e varfërisë. Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave dhe Ekonomise, për treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar, në vitin 2017, shpenzimet për ndihmën ekonomike përbëjnë 1,3 % të Produktit të Brendshëm Bruto nominal (Tabela 1).

Numri i familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike ndryshon sipas përbërjes së familjeve (Tabela 6) dhe llojit të ndihmës që përfiton familja (Tabela 7). Gjatë vitit 2017, familjet me katër pjesëtarë zënë peshën më të madhe në familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike (31,8 %) pasuar nga familjet me pesë pjesëtarë (24,2 %). Në vitin 2017, numri i familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike është rritur me 1 %, krahasuar me vitin 2016.

Numri mesatar vjetor i punëkërkuësve të papunë të regjistruar gjatë vitit 2017 ka rënë me 29.9291 persona, krahasuar me një vit më parë. Të papunët e regjistruar, të cilët përfitojnë pagesë papunesie gjatë vitit 2017, janë 2.178 persona. Niveli i pagesës mujore të papunësisë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe është e njëjtë për të gjithë përfituesit; gjatë vitit 2017 ishte 11.000 lekë (Tabela 8).

I Burimet e të dhënave

Sistemi i mbrojtjes sociale në Shqipëri përbëhet nga: (1) Sistemi i sigurimeve shoqërore; (2) Sistemi i sigurimeve shëndetësore; (3) Ndhimja ekonomike dhe shërbimet sociale; dhe (4) Shërbimet e punësimit.

Të dhënat e shpenzimeve për mbrojtjen sociale në raport me PBB-në nominale janë marrë nga raportimet periodike për treguesit fiskalë të buxhetit të konsoliduar në faqen zyrtare

të internetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë:

http://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/07/Treguesit_Analitik_Fiskal_-_Dhjetor_2017.xls

Instituti i Sigurimeve Shoqërore është burimi i të dhënave për kontribuesit në skemën e sigurimeve shoqërore dhe numrin e përfituesve të pensioneve sipas gjinisë.

Sistemi i Sigurimeve Shoqërore mbështetet në parimin kontributiv, parimin e vetëpërgjegjësisë së individit për rreziqet e së ardhmes në fushën sociale, si dhe në parimin e marrëveshjes së brezave “paguaj sot, që të përfitosh nesër”. Për skemën e ndihmës ekonomike, burimi i të dhënave është Shërbimi Social Shtetëror. Për programin e pagesës së papunësisë, burimi i të dhënave është Shërbimi Kombëtar i Punësimit. Programi i pagesës së papunësisë është pjesë e politikave shtetërore të punësimit, të cilat sigurojnë mbështetjen me të ardhura të të papunëve në momentin e daljes së tyre si të tillë, duke synuar krijimin e kushteve për rikthimin e tyre në tregun e punës.

I Përkufizime

Numri mesatar i kontribuesve përfaqëson personat që kanë derdhur kontribut të sigurimeve shoqërore gjatë periudhës përkatëse. Shteti paguan kontribut për ushtarët, të papunët në pagesë papunesie, personat në pagesë kalimtare nga sigurimi suplementar shtetëror dhe ushtarakët në reformë që përfitojnë nga sigurimi suplementar për ushtarakët. Numri mesatar i kontribuesve llogaritet çdo muaj, bazuar në listë-pagesat që subjektet janë të detyruar të paraqesin pranë agjencive të sigurimeve shoqërore.

Pension pleqërie është pensioni që përfitohet nga personat e siguruar në formë kësti mujor në moshën 65 vjeç burrat dhe 60,5 vjeç gratë, pasi të kenë plotësuar 35 vjet sigurim. Nën atë që kanë lindur 6 a më shumë fëmijë, të cilët janë mbi 8 vjeç, kanë të drejtë të dalin në pension kur mbushin moshën 56,6 vjeç dhe kanë 30 vjet sigurim. Pensionet e pleqërisë mund të jenë dhe të reduktuar ose të pjesshëm.

Pension invaliditeti është pensioni që përfitohet nga personat që bëhen të paafte për çdo veprimtari

ekonomike dhe kanë gjymtime të forta e dëmtime fizike (duke përfshirë verbimin).

Pensioni familjar është pensioni që përfitohet nga anëtarët e mbetur të një familjeje të personit të vdekur (bashkëshorti, bashkëshortja, fëmijët).

Norma e varësisë së sistemit është raporti kontribues-përfitues.

Ndihma ekonomike është një ndihmë në kesh për familjet e varfra dhe shpërndahet çdo muaj. Ajo mund të jetë e pjesshme ose e plotë, në varësi të

të ardhurave të familjes. Shuma e ndihmës së pjesshme llogaritet si diferencë ndërmjet shumës së plotë të ndihmës ekonomike dhe të ardhurave reale të familjes. Ndihmë ekonomike përfitojnë të gjitha familjet shqiptare, në qytet dhe fshat, të cilëve u mungojnë të ardhurat dhe mjetet e jetesës krejtësisht ose i kanë ato të pamjaftueshme.

Pagesa e papunësisë është një ndihmë në kesh që i jepet për një periudhë 12 mujore personave të dalë si të papunë dhe që kanë kontribuar në sigurimin shoqëror jo më pak se 12 muaj.

Tab. 1

Shpenzimet për Mbrojtjen Sociale, 2013-2017

në % të PBB

Përshkrimi	2013	2014	2015	2016	2017
Sigurime Shoqërore	7,1	7,4	7,5	7,6	7,7
Sigurime Shëndetësore	2,2	2,3	2,3	2,4	2,5
Pagesa e papunësisë	0,06	0,07	0,04	0,05	0,04
Ndihma Ekonomike	1,43	1,64	1,23	1,33	1,32

Burimi i informacionit: Ministria e Financave, Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar, Dhjetor 2017

Tab. 2

Kontribuues në skemën e sigurimeve shoqërore, 2013 - 2017

Përshkrimi	2013	2014	2015	2016	2017
Kontribues (numër mesatar)	561.169	654.563	718.070	718.286	752.383
urbanë	496.895	526.835	628.543	665.118	693.857
ruralë	64.274	127.728	89.527	53.168	58.526
Numri i pensioneve (gjendja në fund)	570.423	585.483	598.932	611.544	621.186
urbanë	418.399	436.337	454.163	472.390	488.408
ruralë	152.024	149.146	144.769	139.154	132.778
Norma e varësisë së sistemit % (Raporti kontribues-përfitues)	0,98	1,12	1,20	1,17	1,21
urbane	1,19	1,21	1,38	1,41	1,42
rurale	0,42	0,86	0,62	0,38	0,44

Burimi i informacionit: Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Raport vjetor 2017

Tab. 3

Pensione urbane në skemën e sigurimeve shoqërore sipas gjinisë dhe llojit të pensionit, 2013 - 2017
(gjendja në fund)

	2013	2014	2015	2016	2017
Pensionistë urbanë	418.399	436.337	454.163	472.390	488.408
Femra	182.719	202.423	213.302	218.863	227.396
Meshkuj	235.680	233.914	240.861	253.527	261.012
Pleqërie	311.382	327.604	345.315	363.664	379.379
Femra	150.402	156.680	167.734	172.972	179.431
Meshkuj	160.980	170.924	177.581	190.692	199.948
Invaliditeti	59.241	61.200	62.101	61.938	62.412
Femra	22.934	24.850	25.001	25.192	25.569
Meshkuj	36.307	36.350	37.100	36.746	36.843
Familjare	47.776	47.533	46.749	46.788	46.647
Femra	19.383	20.893	20.567	20.699	22.396
Meshkuj	28.393	26.640	26.182	26.089	24.251

Burimi i informacionit: Instituti i Sigurimeve Shoqërore: Statistika të Sigurimeve Shoqërore 2017

Tab. 4

Pensione rurale në skemën e sigurimeve shoqërore sipas gjinisë dhe llojit të pensionit, 2013 - 2017
(gjendja në fund)

	2013	2014	2015	2016	2017
Pensionistë ruralë	152.024	149.146	144.769	139.154	132.778
Femra	94.042	91.975	89.035	85.962	83.485
Meshkuj	57.982	57.171	55.734	53.192	49.293
Pleqërie	135.904	133.132	129.160	124.378	118.794
Femra	86.421	84.213	81.548	78.902	76.880
Meshkuj	49.483	48.919	47.612	45.476	41.914
Invaliditeti	7.229	7.579	7.764	7.456	7.304
Femra	2.980	3.268	3.400	3.227	3.173
Meshkuj	4.249	4.311	4.364	4.229	4.131
Familjare	8.891	8.435	7.845	7.320	6.680
Femra	4.641	4.494	4.087	3.833	3.432
Meshkuj	4.250	3.941	3.758	3.487	3.248

Burimi i informacionit: Instituti i Sigurimeve Shoqërore: Statistika të Sigurimeve Shoqërore 2017

Tab. 5

Masa e pensionit mesatar mujor, urban dhe rural sipas llojit, 2013-2017

(në lekë)

	2013	2014	2015	2016	2017
Urban					
pension pleqërie	14.076	14.518	14.585	14.873	15.527
pension invaliditeti	12.181	12.593	12.648	12.803	13.390
pension familjare	6.785	6.765	6.696	6.613	6.707
Rural					
pension pleqërie	7.465	7.825	8.330	8.556	8.808
pension invaliditeti	5.832	6.113	6.501	6.595	6.451
pension familjare	3.149	3.252	3.240	2.830	2.478

Burimi i informacionit: Instituti i Sigurimeve Shoqërore: Statistika të Sigurimeve Shoqërore 2017

Tab. 6

Numri i familjeve dhe fondi i ndihmës ekonomike sipas strukturës së familjeve, 2013-2017

	2013	2014	2015	2016	2017
Familje në ndihmë ekonomike gjithsej	104.398	78.071	80.057	80.147	80.964
<i>prej të cilave</i>					
me 1 pjesëtar	5.641	3.854	4.406	4.301	4.634
me 2 pjesëtarë	9.218	6.534	6.724	7.097	7.492
me 3 pjesëtarë	16.581	12.517	13.188	13.821	14.095
me 4 pjesëtarë	30.340	22.954	23.938	24.271	25.744
me 5 pjesëtarë	22.998	17.699	18.124	17.963	19.607
me 6 pjesëtarë	11.309	8.502	8.284	7.994	9.365
me 7 pjesëtarë e më shumë	8.311	6.012	5.394	4.702	6.572
Fondi i ndihmës ekonomike gjithsej (në mijë lekë)	4.655.834	3.569.361	4.095.878	4.115.224	4.091.663
<i>prej të cilit sipas strukturës së familjeve</i>					
me 1 pjesëtar	175.979	119.038	160.531	133.409	1.600.903
me 2 pjesëtarë	330.058	225.173	256.044	271.740	3.260.879
me 3 pjesëtarë	635.901	482.710	563.179	596.865	7.162.377
me 4 pjesëtarë	1.321.026	991.276	1.190.713	1.225.664	14.707.972
me 5 pjesëtarë	1.114.640	876.252	1.013.792	1.028.710	12.344.525
me 6 pjesëtarë	590.285	489.705	528.726	516.361	6.196.329
me 7 pjesëtarë e më shumë	487.945	385.208	382.893	342.476	4.109.707

Burimi i informacionit: Shërbimi Social Shtetëror

Tab. 7

Numri i familjeve dhe fondi i ndihmës ekonomike sipas llojit dhe ndarjes administrative, 2013-2017

	2013	2014	2015	2016	2017
Familje gjithsej	104.398	78.071	80.057	80.147	80.964
<i>prej të cilave sipas llojit të ndihmës</i>					
ndihmë të pjesshme	71.325	52.591	41.490	40.561	39.945
ndihmë të plotë	33.073	25.480	38.567	39.587	41.019
Fondi gjithsej (në mijë lekë)	4.655.834	3.569.361	4.095.878	4.115.224	4.091.663
<i>prej të cilit sipas llojit të ndihmës</i>					
ndihmë të pjesshme	2.990.760	2.302.170	1.938.883	1.918.394	1.854.848
ndihmë të plotë	1.665.074	1.267.191	2.156.995	2.196.833	2.236.815

Burimi i informacionit: Shërbimi Social Shtetëror

Tab. 8

Pagesa e papunësisë dhe numri i përfituesve të saj, 2013 - 2017

Përshkrimi	2013	2014	2015	2016	2017
Pagesa mujore e papunësisë (në lekë)	6.850	6.850	6.850	11.000	11.000
Punëkërkuar të papunë të regjistruar (numër mesatar vjetor)	142.648	141.998	149.148	119.710	89.781
Të papunë të regjistruar në pagesë papunësie (numër)	7.824	7.395	6.186	5.141	2.178
Të papunë të regjistruar në pagesë papunësie (% ndaj të punëkërkuarve të papunë të regjistruar)	5,5%	5,2%	4,1%	4,3%	2,4%



SHËNDETËSIA

I Hyrje


Qëllimi i këtij kapitulli është që të japë një vështrim të gjendjes shëndetësore të popullsisë në Shqipëri. Në të jepet një vështrim mbi statistikat e gjendjes shëndetësore aktuale të popullsisë, të cilët presin që të kenë një jetë të gjatë dhe të shëndetëshme, dhe të marrin kujdesin e duhur shëndetësor. Në këtë kapitull paraqiten statistika mbi institucionet shëndetësore, kujdesin shëndetësor, me një analizë të numrit të shtretërve spitalor, gjithashtu ky kapitull përshkruan shkurtimisht burimet e kujdesit, aksesin dhe përdorimin e kujdesit shëndetësor dhe shpenzimet e përfshira në sektorin shëndetësor shqiptar. Sistemet e kujdesit shëndetësor janë të organizuara dhe të financuara në mënyrë të ndryshme, por qëllimi kryesor është

ofrimi i një shërbimi shëndetsor universal që ti shërbeje një kujdesi shëndetësor më të mirë, me një kosto të përballueshme për të dy palët (individët dhe shoqërisë në përgjithësi), është një nevojë themelore.

I Gjetjet kryesore

Në vitin 2017 numri i vdekjeve të regjistruara është 22,232 mije, gupin më të madh në grup-sëmundjet shkaktare të vdekjeve e zënë grupi i sëmundjeve të "Sëmundje të aparatit të qarkullimit të gjakut", me 53.6%, i ndjekur nga grupi i sëmundjeve "Tumore", me 16.4% të vdekjeve gjithsej. Sipas gjinisë, koeficienti i vdekjeve bruto për 100 mijë banorë është me i lartë te meshkujt (802.9) dhe 744.2 për femrat.

Fig. 1
Koeficienti bruto i vdekshmërisë sipas grupsëmundjeve dhe gjinisë (për 100 mijë banorë), 2017




Burimi: Instat

Grupmosha 50 vjeç e lart zë 93.0 % të vdekjeve të regjistruara në vitin 2017, me 20,969 numër vdekjesh në këtë grup moshë. Grupmosha 85 vjeç e lart zë 25.4 % të vdekjeve të regjistruara në vitin 2017, me 5,645 vdekje. Numrin më të lartë të vdekjeve në grupmoshën 85 vjeç e lart e zënë femrat, të cilat përbëjnë 63.8 % ndaj totalit të kësaj grup - moshe.

I Shërbimi i kujdesit shëndetësor parësor

Shërbimi i kujdesit shëndetësor parësor është shkalla e parë ku vijnë problemet shëndetësore dhe ku jepet shërbimi bazë për popullatën shqiptare. Institucionet e shërbimit të kujdesit parësor kanë si mision sigurimin e një jetese në kushte sa më të mirë në përputhje me objektivat e Qeverisë Shqiptare. Gjatë këtyre viteve janë konsoliduar institucionet bazë publike që

Fig. 2
Numri i vdekjeve sipas grupmoshës dhe gjinisë, 2017



ofrojnë këto shërbime, krijimin e mjediseve më të përshtatshme, rritjen e cilësisë së shërbimeve si dhe në nxitjen e sektorit privat në këtë fushë. Fokusimi i të dhënave është kryesisht tek shërbimet publike në bazë të rekordeve administrative. Siç shihet numri i qendrave

shëndetësore, ambulancave dhe poliklinikave ka ardhur duke u konsoliduar në vite, kemi 413 qendra shëndetësore dhe 2.022 ambulanca (2017). Gjithashtu vërehet rritje e numrit të vizitave në total duke i krahasuar në vite, dhe kryesisht kjo e fokusuar në grup moshat nën 14 vjeç dhe mbi 60 vjeç.


Tab. 1
Aktiviteti i qendrave shëndetësore, ambulancave dhe poliklinikave, 2013-2017

Emërtimi	2013	2014	2015	2016	2017
Vizita gjithsej	7.184.404	7.825.455	7.746.290	8.120.123	7.942.742
I Qëndrat shëndetësore	409	427	408	414	413
Numri vizitave në Qendra shëndetësore	3.184.669	3.230.202	3.239.783	3.141.755	3.219.003
Vizita në moshat deri 14 vjeç	689.969	664.849	620.071	597.744	622.065
nga këto: nën 1 vjeç	186.624	169.277	16.716	167.631	164.598
Vizita në moshat mbi 14 vjeç	2.429.278	2.477.116	2.551.426	2.477.518	2.540.230
nga këto: mbi 60 vjeç	1.405.948	1.412.007	1.327.090	1.299.973	1.307.037
Vizita në banesë	72.556	88.237	68.286	66.493	56.708
II Ambulanca	1.998	2.033	2.133	2.062	2.022
Numri vizitave në ambulanca	1.334.058	1.457.920	1.330.670	1.627.521	1.545.416
Vizita në moshat deri 14 vjeç	349.794	349.238	322.393	354.070	345.029
nga këto: nën 1 vjeç	95.029	93.294	89.422	93.487	93.894
Vizita në moshat mbi 14 vjeç	930.216	1.041.412	928.092	1.107.761	1.100.013
nga këto: mbi 60 vjeç	569.579	680.516	582.070	616.024	741.503
Vizita në banesë	77.520	67.270	80.185	165.690	100.374
III Poliklinika	46	46	46	46	46
Numri vizitave në poliklinika	2.665.677	3.137.333	3.175.837	3.350.847	3.178.323
Vizita në moshat deri 14 vjeç	456.944	510.379	468.912	469.215	451.000
Vizita në moshat mbi 14 vjeç	2.208.733	2.626.954	2.706.925	2.881.632	2.727.323

Moshat që kërkojnë shërbim mjekësor kryesisht janë ato nën 14 vjeç dhe ato të moshës mbi 60 vjeç, janë afërsisht 59 % për vitin 2017. Numri total i Vizitave është pothuajse i njëjte gjatë dy viteve të fundit, duke ruajtur të pandryshueshme dhe strukturën e vizitave në qendra shëndetësore,

ambulanca dhe poliklinika. Në krahasim me 2012 vihet re një besim i qëndrueshëm i familjarëve për qendrat shëndetësore, por me kalimin e viteve vihet re që perceptimi i familjarëve për Ambulancat e sidomos Poliklinikat ka ardhur duke u rritur.

Fig. 3
Përqindja e vizitave në Qendra Shëndetësore,
Ambulanca dhe Poliklinika, 2013-2017



Tab. 2
Aktiviteti i Konsultorit të Gruas, 2013 – 2017

Emërtimi	2013	2014	2015	2016	2017
Numri i Konsultoreve	2.046	2.014	2.104	2.024	2.057
Numri i mjekëve në konsultor	731	715	739	762	765
Numri i mamive në konsultor	2.966	2.749	3.003	2.827	2965
Numri i vizitave gjithsej	292.174	299.502	284.208	269.834	272.177
Numri i vizitave gjinekologjike	38.275	39.502	41.569	42.530	45.184
Numri i vizitave obsetrikale	253.899	260.000	242.639	227.304	226.993
- me mjek	149.949	161.152	156.631	147.044	141.717
Numri i vizitave të para obsetrikale	35.515	33.304	32.490	30.734	32.787
nga këto: 0-13 javë	23.252	21.697	20807	19.726	20268
14÷28 javë	8.451	7.979	8059	7.377	8276
mbi 28 javë	3.812	3.628	3624	3.631	4243
Numri i grave me barrë pathollogjike	9.453	9.614	10.679	11.035	9.935
- nefropati	686	532	667	699	772
- anemi	2.825	2.807	3515	3.636	3168
- rrezik dështimi	3.097	3.706	3717	3.584	3510
- të tjera	2.845	2.569	2780	3.116	2485
Sëmundje gjinekologjike - gjithsej	15.400	16.485	13.748	17.028	15.083
1. Infeksione të pelvisit të sipërm	2.315	2201	1.615	2.836	2409
2. Infeksione të rrugëve	11.138	12.664	10.501	12.629	11046
3. Infeks.transmetuar në rrugë sex.	1.460	1.013	871	1.020	1036
4. Sterilitetet	487	607	761	543	592

Brenda shërbimit të kujdesit shëndetësor parësor funksionojnë dhe shërbime specifike për perkujdesin e nënës dhe fëmijës, të cilët ofrojnë shërbime për këtë grup të popullatës. Sipas të dhënave të Ministrisë të Shëndetësisë në tabelën e më poshtme pasqyrohet aktiviteti i konsultorit të gruas për vitet 2013-2017.

Ky shërbim në konsultore ndiqet nga mjeku obsetërgjinekolog dhe pothuajse numri i vizitave të para obsetrikale është përafërsisht i njëjtë me numrin e lindjeve të raportuara në vendin tonë, gjatë vitit 2017 nga këto 61,8% janë vizita të

kryera gjatë 0-13 javëve të para dhe 12,9 % janë vizita mbi 28 javeve, kjo shpërndarje ka qëndruar e pa ndryshuar në këto vite.

Nga të dhënat që Ministria e Shëndetësisë raporton vihet re që nga viti në vit ka ulje të numrit të fëmijëve që ushqehen me qumësht gjiri dhe rritje e numrit të fëmijëve që ushqehen me qumësht artificial, në vitin 2017 dhe pse ka ulje të numrit të lindjeve vërehet që numri i fëmijëve të regjistruar në konsultorin e fëmijëve ka rritje krahasuar me vitin 2016 kjo shifër është rritur me 12 %.

Tab. 3
Aktiviteti i Konsultorit të Fëmijëve, 2013 – 2017

Emërtimi	2013	2014	2015	2016	2017
Numri i konsultoreve të fëmijës	1.974	2.024	2.159	2.095	2.100
- qytet	165	176	149	154	158
- fshat	1.809	1.848	2.010	1.941	1.942
Numri i vizitave në konsultor	915.216	932.986	943.759	990.563	929.330
nga këto: sa nga mjeku	511.735	542.490	530.701	501.523	534.059
nr. i fëmijëve të regjistruar në konsultor	259.853	278.646	254.174	259.354	286.092
Nr. i fëmijëve që ushqehen vetëm me gji	21.258	24.729	22.382	20.928	20.702
nga këto:					
deri 1 muaj	4.159	4.490	4.160	3.969	4.292
1-2 muaj	3.926	4.355	3.929	3.570	3.945
2-3 muaj	3.686	4.409	3.756	3.571	3.481
3-4 muaj	3.367	4.020	3.549	3.306	3.332
4-6 muaj	3.757	4.558	4.232	3.629	3.473
6-12 muaj	2.363	2.897	2.756	2.883	2.179
Numri i fëmijëve me ushqim artificial	4.177	5.363	4.624	5.670	5.693
nga këto:					
deri 1 muaj	373	478	434	385	498
1-2 muaj	479	537	555	988	588
2-3 muaj	506	765	682	782	842
3-4 muaj	915	1.028	895	758	890
mbi 4 muaj	1.904	2.555	2.058	2.757	2.875

Burimi: Ministria e Shëndetësisë

Shërbimi i kujdesit spitalor

Në lidhje me infrastrukturën spitalore shëndetësore publike, numri i shtretërve spitalor tregon disponueshmërinë e shërbimit shëndetësor dhe mbulimin nga ky shërbim i popullsisë. Shërbimi

spitalor ofrohet nga spitalet rajonale të cilët kanë shërbimin bazë dhe nga ata të specializuara. Shërbimet mjekësore dytësorë në vendin tonë ofrohet nga 42 spitale publike me 8.169 shtretër të numëruara në vitin 2017.

Tab. 4
Aktiviteti i Institucioneve me Shtretër, 2013 – 2017

Treguesit e aktivitetit	2013	2014	2015	2016	2017
Numri i institucioneve spitalore	44	42	42	42	42
Numri i shtretërve në total	8.283	8.295	8.224	8.172	8.169
Të shtruar në institucione	260.727	257.047	276.901	275.165	273.046
Të dalë nga spitalet gjithsej	260.780	255.802	275.412	275.678	261.373
- nga fshati	106.053	88.515	99.206	91.772	80.911
- nën 1 vjeç	14.454	14.302	13.150	22.773	21242
- 60 vjeç e lartë	54.133	53.380	54.345	62.128	62936
Ditë-shtretër të realizuar	1.442.417	1.497.809	1.549.208	1.470.515	1.444.336
Shfrytëzimi i shtratit në ditë	174,1	180,6	177,3	178,0	176,8
- në %	47,7	49,5	48,6	48,7	48,4
Ditë qëndrimi mesatar të sëmurit në spital	5,5	5,9	5,6	5,3	5,4
Xhiro e shtratit	31,5	31,0	31,6	33,6	32,8
Të sëmurë të operuar gjithsej	55.038	62.393	51.470	52.248	57.475

Burimi: Ministria e Shëndetësisë

Numri i spitaleve dhe i shtretërve spitalorë është pothuajse i njëjtë gjatë viteve të fundit në Shqipëri, gjithashtu ky numër është i ulët kur krahasohemi me vendet e rajonit dhe kemi 30shtretër/10.000 banorë për vitin 2017.

Nga vështrimi i shpërndarjes së spitaleve ato janë përqëndruar kryesisht në Tiranë, duke vazhduar me Elbasanin, Korçën, Vlorën, Beratin, etj. Gjithashtu siç thamë dhe më sipër kemi vetëm informacion nga sektori publik, kjo e bazuar në regjistrimet administrative, shërbimi spitalor privat ka pësuar rritje të ndjeshme dhe sot në Shqipëri numërohen 11 spitale private.

Gjithashtu të dhënat e tabelës tregojnë që në Shqipëri shfrytëzimi i shtretërve spitalor vazhdon të jetë i ulët nën 50 %, po përse i përket ditë qëndrimit mesatar ajo ka qënë pothuajse e njëjte në vite ndersa në vitin 2016 ditët mesatare të qëndrimit të një të sëmuri në spital janë 5.4 ditë në vit.

Shërbimi i vaksinimit të fëmijëve në Shqipëri është një shërbim tashmë i konsoliduar, falë kujdesit dhe politikave të qeverisë nga viti në vit në konsultorin e fëmijëve arrihet mbulimi pothuajse në 100% i të gjitha rasteve të vaksinimit.

Tab. 5
Mbulimi Vaksinal, 2013-2017

Emërtimi	2013	2014	2015	2016	2017
Fëmijë vaksinuar në % për:					
- tuberkulozin	99,7	99,7	99,7	99,2	99,0
- difterinë	99,0	98,5	98,8	98,7	99,0
- tetanozin	99,0	98,5	98,8	98,7	99,0
- pertusin	99,0	98,5	98,8	98,7	99,0
- fruthin-rubeole-parotit*	98,7	97,6	97,8	96,3	95,7
- poliomilitin	99,1	97,6	98,8	98,3	98,9

Burimi: Ministria e Shëndetësisë

Pjesë e kujdesit spitalor është dhe shërbimi obsetrik gjinekologjik, ku në të kryhet një kujdes i veçantë për gruan shtatzënë dhe për fëmijën e porsalindur.

Numri i lindjeve në Shqipëri nga viti vit ka pësuar rënie, kjo ka lidhje me kushtet sociale të familjeve e cila ka pësuar ndryshime në strukture, njëkohësisht lidhet dhe me largimin e konsiderueshëm të popullatës jashtë vëndit. Siç shihet në tabelën e mëposhtme, nga viti në vit njëkohësisht me uljen e lindjeve kemi dhe rënie të numrit të aborteve, në vitin 2017 krahasuar me vitin 2013 ka një ulje prej

25.7% të numrit të aborteve. Raporti lindje- aborte ka ndryshuar nga 5,4 lindje në 1 abort që ishte në vitin 2012 në 5,8 lindje me 1 abort (pra në 6 lindje kryhet 1 abort) në vitin 2017. Proporcioni i abortit (aborti për 1.000 lindje gjallë) në rang vendi ka qëndruar pothuajse i njëjtë në dy vitet e fundit 171 për 1.000 lindje të gjalla.

Në lidhje me strukturën e abortit nuk kemi ndryshime në vitet e fundit, abortet spontane zënë deri në 77.4 % në vitin 2017 dhe ato me ndërprerje mjeksore në 22.6% të totalit të këtij viti.


Tab. 6
Lindjet dhe Abortet, 2013 – 2017

Emërtimi	2013	2014	2015	2016	2017
Barra	42.388	41.652	38.595	37.129	36.148
Lindje	35.750	35.760	32.715	31.733	30.869
Aborte	6.638	5.892	5.880	5.396	5.279
spontan	4.461	4.213	4.447	4.193	4.086
me ndërprerje	2.177	1.679	1.433	1.203	1.193
Aborte					
– për 1000 lindje	186	165	180	170	171
– per 1000 barra	157	141	152	145	146
Lindje / Abort	5.4 : 1	6.1 : 1	5.6 : 1	5.9 : 1	5.8 : 1

Burimi: Ministria e Shëndetësisë

Nga grafiket e mëposhtëm vihet re që numri i aborteve është i lidhur me moshën ,vëndbanimin si dhe me statusin e punësimit te gruas.


Fig. 4
Numri i aborteve sipas mënyrës, 2013-2017



Shumica e aborteve në vend kryhen nga femra të grup-moshës 20-34 vjeç (rreth 68 % kundrejt numrit total të aborteve), kurse femrat e grup-moshës mbi 35 vjeç përbëjnë rreth 26.6% të numrit


total të aborteve. Abortet vihen re më pak tek femrat adoleshente të grup-moshës 14-19 vjeç (4.8%) dhe femrat e grup-moshës ≥ 45 vjeç (1.7%).

Fig. 5
Përqindja e aborteve sipas grupmoshës së gruas,
2013-2017



Trendi i aborteve të kryera në vite, nxjerr në pah se abortet kryesisht kryhen nga femrat të cilat nuk janë të punësuar dhe të siguruara. Pothuajse gjysma e aborteve vihen re tek femrat me një nivel të ulët arsimor (40.8% me arsim fillor ose 8-vjeçar), ndërkohë që femrat me arsim të lartë kryejnë rreth 21.1% të aborteve .

Fig. 6
Përqindja e aborteve sipas nivelit arsimor të gruas,
2013-2017




I Shpenzimet në shëndetësi

Shpenzimet në shëndetësi përbëhen nga shpenzimet publike (qeverisë) dhe shpenzimet private. Aktualisht jemi fokusuar tek treguesit në sektorin publik, ku ato mbulojnë shërbimet shëndetësore parandaluese, kuruese, aktivitete për shëndetin e nënës dhe fëmijës, ndihmat emergjente për shëndetin, etj.

Shpenzimet publike në sektorin e shëndetësisë për vitin 2017 kanë qenë 45.532 miliardë lekë. Këto shpenzime përbëjnë 9,83 % të shpenzimeve publike gjithsej për vitin 2017 dhe zë një peshë prej 2,92 % në PBB-në gjithsej. Shpenzimet publike në shëndetësi shprehur si përqindje ndaj PBB dhe ndaj shpenzimeve publike gjithsej, kanë shënuar rritje krahasur me vitin 2016.

Fig. 7
Shpenzimet Buxhetore në shëndetësi



* Të dhënat janë provizore / Burimi i informacionit: Ministria e Financave

I Përkufizime

Sëmundshmëria është numri i rasteve të sëmundjeve në një popullsi të përcaktuar. Ajo matet me prevalencën ose incidencën e sëmundjeve. Përhapja e një sëmundjeje mund të ketë ndikime serioze mbi aspektet e tjera të popullsisë.

Koeficienti i prevalencës është numri i personave që kanë një sëmundje të veçantë në një pikë të dhënë në kohë për 1.000 banorë në rrezik. Ky koeficient përfshin të gjithë rastet e periudhës së specifikuar. Koeficienti i prevalencës është një "fotografi" e çastit e një situatë shëndetësore ekzistuese: ai përshkruan gjendjen shëndetësore të një popullsie.

Koeficienti i Incidencës

Ky koeficient tregon numrin e rasteve të raportuara të një sëmundjeje specifike për 100.000 banorë gjatë një viti të dhënë. Koeficienti i incidencës është një tip i veçantë i koeficientit të prevalencës por ndryshon nga ai në atë që është i bazuar në numrin e rasteve të reja të raportuara, i cili nuk është domosdoshmërisht numri i personave që preken nga sëmundja (disa persona mund ta ndeshin sëmundjen më shumë se një herë).

Numri i Spitaleve

Spitali është një rezidence institucionale i pajisur për të ofruar kujdes mjekësor dhe hoteleri 24-orësh, diagnostikim, trajtim dhe rehabilitim të të sëmurëve dhe të dëmtuarve që mund të kenë nevojë si për ndihmë mjekësore dhe kirurgjikale: i pajisur me staf të përgatitur profesionalisht dhe me të paktën një mjek. Spitali mundet jo në mënyrë të detyrueshme të siguroj gjithashtu shërbim dhe pacientëve të jashtëm.

Shtrimet në spital-sëmundjet

Numri gjithsej i pacientëve të shtruar në të gjitha spitalet gjatë një viti të dhënë kalendarik me diagnozë kryesore që bën pjesë në grupin e sëmundjeve të klasifikuara në ICD 9 / ICD 10.

Dalja nga spitali

Është përfundimi i një periudhe ku i sëmuri trajtohet i shtruar në spital dhe më pas rikthehet në shtëpinë e tij, ose transferohet në një ambient tjetër rehabilitues (transferimi në një pavion tjetër të të njëjtit spital nuk konsiderohet dalje nga spitali) ose kur vdes.

Kohëzgjatja mesatare e qëndrimit, në të gjithë spitalet

Është raporti i numrit total të shtretërve të zënë në spital me numrin total të pranimeve ose daljeve nga spitali. Kohëzgjatja e qëndrimit në spital e një patienti është e barabartë data e daljes minus data e pranimit. Në qoftë se data është e njëjtë, atëherë ditë qëndrimi në spital është një ditë.

Numri i Qendrave të Kujdesit Shëndetësor Parësor

Përfshin të gjitha institucionet shëndetsore që ofrojnë kujdes shëndetsorë për pacientët e jashtëm p.sh. qendra e konsultave nëpër spitale, poliklinikat, ambulancat, qendrat mjekësore, urgjenca e ndihmës së shpejtë etj, të cilat janë të paisur me të paktën një person të kualifikuar nga ana mjekësore (mjekë ose infermier).

Aborti është përfundimi (ndërprerja) i shtatzënisë para se fetusit të jetë zhvilluar.

I Burimi i të dhënave

INSTAT është një nga institucionet kryesore në vend që publikon të dhëna mbi treguesit shëndetësor dhe shëndetin. Burim të dhënash në përgjithësi janë të dhënat administrative si dhe vrojtime të veçanta në vite që janë kryer dhe kryhen nga institucioni. Të dhënat statistikore administrative sigurohen nga institucionet shëndetësore ku burim kryesor për këto të dhëna janë regjistrat kombëtar të pacientëve ose raportet e përvitshme nga regjistra themeltar të institucioneve, që raportohen në formate të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë. Zgjedhja dhe caktimi i kriterëve metodologjike bëhet duke u mbështetur në koncepte, përkufizime, metoda të krahasueshme ndërkombëtare. Në këtë botim burime të dhënash për tregues të ndryshëm janë ato administrative të marra në bazë të evidencave statistikore nga Ministria e Shëndetësisë, etj. Në këtë kapitull janë të pasqyruar kryesisht informacione për aktivitetin e institucioneve parandaluese, kuruese, shpenzimet shëndetësore.

ARSIMI



I Hyrje

Arsimi luan një rol shumë të rëndësishëm në krijimin e kapitalit njerëzor dhe është një nga premiset për zhvillimin ekonomik dhe social të një vendi. Në Shqipëri e drejta e arsimimit është e garantuar me Kushtetutë, për të gjithë shtetasit pa asnjë lloj dallimi.

Dokumentet nëpërmjet të cilave shprehen politikat arsimore janë Strategjitë e zhvillimit për arsimin e lartë dhe atë parauniversitar, si edhe ligjet përkatëse.

Ndërsa janë statistikatat ato, që pasqyrojnë në të dhëna dhe tregues, aktivitetin arsimor që kryhet në vend.

Informacioni në Vjetar, përfshin statistika për arsimin zyrtar që kryhet në të gjitha nivelet e sistemit arsimor shqiptar, i cili përbëhet nga arsimi parauniversitar dhe arsimi i lartë.

Arsimi parauniversitar përfshin arsimin parashkollor, arsimin 9 vjeçar dhe atë të mesëm. Arsimi 9 vjeçar ose arsimi bazë, është i detyruar, fillon në moshën 6 vjeç dhe zgjat 9 vjet. Nxënësi është i detyruar të ndjekë arsimin bazë deri në moshën 16 vjeç. Arsimi bazë përbëhet nga dy cikle: arsimi fillor që kryhet në klasat 1 - 5 dhe arsimi i mesëm i ulët, ose cikli i lartë i arsimit bazë, që kryhet në klasat 6 - 9.


Arsimi i mesëm përfshin: arsimin e përgjithshëm që kryhet në gjimnaz, arsimin profesional dhe atë social kulturor. Shërbimi arsimor në vend ofrohet nga institucionet arsimore publike si edhe ato jo publike.

INSTAT në përpunimin e të dhënave dhe llogaritjen e treguesve të arsimit përdor klasifikimin standard ndërkombëtar të arsimit ISCED 2011, i cili i rekomanduar nga Eurostat dhe UNESCO, zëvendësoi në të njëjtën kohë në të gjitha vendet përdoruese, versionin e mëparshëm të vitit 1997. Për herë të parë klasifikimi i ri është zbatuar për të dhënat e vitit shkollor / akademik 2012-2013.

I Gjetjet kryesore


Treguesit kryesorë që masin pjesëmarrjen në arsim të nxënësve dhe studentëve, janë raporti bruto dhe neto i regjistrimeve. Këto raporte konsiderohen veçanërisht të rëndësishëm në arsimin e detyrueshëm 9 vjeçar, e sidomos në atë fillor. Nëse treguesi GER është mbi 100.0 %, do të thotë se marrin pjesë në një nivel të caktuar të arsimit nxënës ose studentë me moshë më të vogël ose më të madhe sesa ato që i përkasin popullsisë që sipas ligjit duhet të marrin pjesë në nivelin e caktuar arsimor. Për shembull nëse GER në fillorë është 104.0 %, kjo do të thotë se këtu marrin pjesë jo vetëm fëmijë të moshës 6-10 vjeç por edhe nxënës 5 ose mbi 10 vjeç. Por nëse raporti është nën 100 do të thotë që jo të gjithë fëmijët e grup moshës 6-10 vjeç kanë ndjekur arsimin për vitin e caktuar. Raporti NER është gjithmonë më i vogël se ai GER. Kjo ndodh për shkak se NER krahason të regjistruarit e një grup moshe të caktuar të një niveli arsimor, me popullsinë e grup moshës që me ligj i përket këtij niveli. Për shembull, NER për arsimin fillor, krahason të regjistruarit 6-10 vjeç në arsimin fillor me popullsinë e vendit 6-10 vjeçare.

Fig. 1
Raporti Bruto dhe Neto i Regjistrimit në dy ciklet e arsimit 9 vjeçar



Në vitin 2017-2018 morën pjesë në arsim në të gjitha nivelet arsimore 82.8% e popullsisë së grup moshës 3-22 vjeç.

Fig. 2
Pjesëmarrja në arsim sipas niveleve arsimore GER, NER viti 2017-2018




Arsimi parashkollor ofrohet në kopshte e në klasa përgatitore, që frekuentohen nga fëmijë të moshave 3 deri 5 vjeç. Pjesëmarrja e fëmijëve në kopshte në vitin 2017 shënohet 80.3 % krahasuar me popullsinë përkatëse.

Nxënësit e arsimit parauniversitar kanë një ulje të vazhdueshme në vlerë absolute.

Por megjithëse numri i nxënësve në arsimin e mesëm ka një ulje prej 21.0%, në vitin 2017-18 krahasuar me vitin 2013-14, nxënësit në arsimin profesional paraqiten me rritje prej 2,6 pikë përqindje.

Struktura e nxënësve në arsimin e mesëm ka ndryshuar ndër vite sikurse tregohet në figurën më poshtë


Fig. 3
Nxënës në arsimin e mesëm Gjimnaz dhe Profesional



Gjithashtu të diplomuarit e arsimit profesional në vitin 2017, janë rritur 1.2 herë krahasuar me vitin 2013.

Diplomohen në programet Bachelor në vitin 2017, 58.1 % e studentëve të diplomuar në arsimin e lartë. Pjesa tjetër prej 41.9 % përbëhet kryesisht prej atyre që diplomohen kryesisht në programet Master dhe një përqindje e vogël në Doktoraturë


Fig. 4
Të Diplomuar në arsimin e lartë



Nga krahasimi i të diplomuarve në arsimin e lartë për tre vitet e fundit, midis fushave të gjera të studimit, rezulton se numri më i madh i tyre i përket fushës së "Biznesit, administrimit dhe ligjit". Vendin e dytë e zë fusha "Shëndet dhe mirëqenie, megjithëse numri i të diplomuarve në këtë fushë

është afërsisht sa gjysma e atyre të vendit të parë. "Shkencat e natyrës" dhe "Inxhinieritë" mbajnë akoma vlera jo shumë të larta ndër të diplomuarit, megjithatë kanë një rritje prej 1.1 pikë përqindje, duke krahasuar vitet 2013 dhe 2017.


Fig. 5
Të diplomuar sipas fushave të studimit



Një tregues i rëndësishëm në arsim, është raporti i nxënësve ose studentëve për 1000 banorë. Këto raporte paraqiten në rënie për disa arsye. Një arsye kryesore është që studentët por edhe

nxënësit shqiptarë kanë kohë që preferojnë të studiojnë jashtë vendit. Por ndikon gjithashtu edhe plakja e popullsisë së vendit.

Fig. 6
Numri i nxënësve dhe studentëve për 1000 banorë



Shpenzimet publike për arsimin janë pothuaj të qëndrueshme në vite.

I Metodologjia

Klasifikimi ISCED-2011 që përdoret në statistikat e arsimit, është i përbërë nga këto nivele sipas programeve arsimore:

Niveli 0 - Arsimi Parashkollor – çerdhe / kopshte
 Niveli 1 - Arsimi Fillor ose cikli i ulët i arsimit bazë
 Niveli 2 - Arsimi i mesëm i ulët ose cikli i lartë i arsimit bazë
 Niveli 3 - Arsimi i mesëm i lartë - Gjimnaz / Profesional
 Niveli 4 - Arsimi pas të mesme por jo i lartë
 Niveli 5 - Arsimi i lartë cikël i shkurtër
 Niveli 6 – Bachelor ose ekuivalent
 Niveli 7 - Master ose ekuivalent
 Niveli 8 - Doktoraturë ose ekuivalent

I Përkufizime

Arsimi parauniversitar përfshin arsimin që kryhet nga institucionet arsimore si kopshte, shkolla 9 vjeçare dhe të mesme.

Arsimi 9 vjeçar ose arsimi bazë përbëhet nga dy cikle: cikli i ulët ose arsimi fillor i cili kryhet në klasat 1-5 dhe cikli i lartë ose arsimi i mesëm i ulët i cili kryhet në klasat 6-9. Arsimi 9 vjeçar është i detyruar fillon në moshën 6 vjeç dhe zgjat 9 vjet. Nxënësi është i detyruar të ndjekë arsimin bazë deri në moshën 16 vjeç.

Arsimi i mesëm përfshin gjimnazin dhe arsimin profesional i cili ndahet në të ulët teknik dhe të lartë. Tabelat në botim i referohen arsimit të mesëm gjimnaz dhe profesional të lartë i cili përbën gjithashtu edhe pjesën kryesore të tij.

Mësues janë përcaktuar personat, aktiviteti profesional i të cilëve, përfshin transmetimin e njohurive, sjelljeve dhe aftësive që janë përcaktuar në programin arsimor tek nxënësit dhe studentët e regjistruar në institucionet zyrtare arsimore.

Institucion arsimor publik klasifikohet si i tillë nëse aktiviteti i tij kontrollohet plotësisht nga autoriteti arsimor publik.

I diplomuar në një program arsimor është një nxënës ose student i cili ka përfunduar në mënyrë të suksesshme të gjitha kërkesat e programit.

Raporti i regjistrimit bruto – GER, është numri i të regjistruarve në një nivel të caktuar të arsimit, pavarësisht nga moshë, e shprehur si përqindje e popullsisë zyrtare në moshë shkollore, që korrespondon me të njëjtin nivel të arsimit.

Raporti i regjistrimit neto – NER, është numri i përgjithshëm i nxënësve në grup moshën teorike për një nivel të caktuar të arsimit të regjistruar në atë nivel, i shprehur si përqindje e popullsisë në atë grup moshë.

Raporti nxënës për mësues është raporti i numrit të nxënësve të regjistruar në një nivel të caktuar të arsimit me numrin e mësuesve në të njëjtin nivel.

Burimi i të dhënave

Tabelat dhe figurat që janë përpunuar, komentet për këtë kapitull kanë si burim kryesor të dhënat administrative që INSTAT merr nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, etj.

Tab. 1
Nxënës dhe studentë të regjistruar në arsim

Niveli ISCED	Viti shkollor / akademik	numër				
		2013-14	2014-15	2015-16	2016-17	2017-18
	Të regjistruar në arsim					
1 - 8	Gjithsej:	704.782	665.994	622.156	596.624	571.566
	Në arsimin 9 vjeçar:					
1	Në filllore	195.720	188.371	179.564	174.836	170.861
2	Në ciklin e lartë të arsimit bazë	181.354	175.037	163.935	153.264	148.810
3	Në arsimin e mesëm:	151.937	140.042	130.380	127.114	120.062
	Në Gjimnaz	124.619	112.775	104.952	101.995	95.306
	Në Profesional	27.318	27.267	25.428	25.119	24.756
4	Në arsimin pas të mesme jo të lartë	1.952	2.017	1.521	1.803	2439
6+7+8	Në arsimin e lartë:	173.819	160.527	146.756	139.607	129.394

Shënim: Nivelet e arsimit i referohen Klasifikimit ISCED 2011

Tab. 2
Raporti nxënës për mësues

Niveli ISCED	Viti shkollor / akademik	2013-14	2014-15	2015-16	2016-17	2017-18
	<i>Në arsimin publik</i>					
1	Në filllore	19,1	18,9	18,3	18,2	17,8
2	Në ciklin e lartë të arsimit bazë	12,6	12,2	11,1	10,4	10,1
3	Në arsimin e mesëm	17,0	16,2	15,0	14,4	13,8
	<i>Në arsimin privat</i>					
1	Në filllore	16,0	15,3	16,4	15,1	15
2	Në ciklin e lartë të arsimit bazë	8,8	8,3	7,8	7,6	7,7
3	Në arsimin e mesëm	9,7	9,1	8,2	9,0	8,7

Shënim: Nivelet e arsimit i referohen Klasifikimit ISCED 2011

Tab. 3
Të Diplomuar sipas niveleve arsimore

Niveli ISCED	Viti shkollor / akademik	numër				
		2012-13	2013-14	2014-15	2015-16	2016-17
	Të Diplomuar në arsimin:					
2	9 vjeçar	47.819	44.139	44.001	43.084	36.546
3	e mesëm:	45.899	35.254	39.629	38.583	36.436
	vetëm Profesional	4.322	3.136	4.702	5.369	5.215
4	Pas të mesme jo të lartë	145	164	125	335	215
6+7+8	Në Arsimin e lartë gjithsej:	30.365	29.137	33.529	31.530	35.173
6	vetëm Bachelor	20.351	17.469	19.152	18.652	20.423

Shënim: Nivelet e arsimit i referohen Klasifikimit ISCED 2011

Tab. 4
Stafi mësimdhënës

Niveli ISCED	Viti shkollor / akademik	numër				
		2013-14	2014-15	2015-16	2016-17	2017-18
1+2	Mësues në arsimin 9 vjeçar	25.051	24.777	25.007	24.866	24.790
3	Mësues në arsimin e mesëm	8.606	8.671	8.942	9.042	8.941
6+7+8	Trupi mësimor efektiv në arsimin e lartë	4.904	4.626	4.609	4.325	4.696

Shënim: Nivelet e arsimit i referohen Klasifikimit ISCED 2011

Tab. 5
Shpenzimet publike për arsimin

	2013	2014	2015	2016	2017
<i>në përqindje kundrejt:</i>					
Shpenzimeve gjithsej të Buxhetit të Shtetit	11,2	10,5	10,2	10,6	10,4
Prodhimit të Brendshëm Bruto	3,3	3,3	3,1	3,1	3,1

Burimi : Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Tab. 6
Numri i nxënësve dhe studentëve për 1000 banorë

Niveli ISCED		2013-14	2014-15	2015-16	2016-17	2017-18
1+2+3	Nxënës për 1000 banorë	183	174	164	158	153
6+7+8	Studentë për 1000 banorë	60	55	51	49	45

Tab. 7
Studentë në arsimin e lartë sipas fushave të studimit

Numër

	2013-14	2014-15	2015-16	2016-17	2017-18
Arsim	15.426	13.654	11.236	11.779	10.689
Arte dhe shkencë humane	20.801	17.588	17.095	17.278	15.441
Shkencë sociale, gazetarë dhe informacion	15.898	10.462	12.727	10.004	12.259
Biznes, administrim dhe ligj	50.219	42.089	41.033	36.471	30.233
Shkencë natyrore, matematikë dhe statistikë	7.100	10.473	6.719	7.816	6.325
Teknologji e Informacionit dhe komunikimit	8.033	9.560	7.911	7.487	8.228
Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim	18.391	18.728	18.005	18.480	18.730
Bujqësi, pyje, peshkim dhe veterinarë	9.039	10.171	8.383	7.086	4.564
Shëndet dhe mirëqenie	25.667	22.780	21.387	20.900	19.837
Shërbime	3.245	5.022	2.250	2.306	3.088
Gjithsej	173.819	160.527	146.746	139.607	129.394

Tab. 8
Raporti Bruto i Regjistrimit - GER

%

Niveli ISCED		2013-14	2014-15	2015-16	2016-17	2017-18
0	Fëmijë në kopshte	80,1	82,3	83,3	81,5	80,3
1	Nxënës në fillore	102,7	103,7	103,0	104,0	103,8
2	Nxënës në ciklin e lartë të arsimit 9 vjeçar	101,7	102,2	100,6	96,7	97,4
3	Nxënës në arsimin e mesëm	100,0	96,9	93,2	94,7	93,9
6+7+8	Studentë në Arsimin e lartë	64,1	60,5	56,8	56,0	54,0
0-8	Gjithsej të regjistruar në arsim	87,8	86,6	84,3	83,6	82,8

Tab. 9
Raporti Neto i Regjistrimit - NER

%

Niveli ISCED		2013-14	2014-15	2015-16	2016-17	2017-18
0	Fëmijë në kopshte	73,5	75,4	76,9	77,7	76,3
1	Nxënës në fillore	95,8	96,2	96,0	97,5	96,9
2	Nxënës në ciklin e lartë të arsimit 9 vjeçar	91,0	91,4	89,7	86,8	88,3
3	Nxënës në arsimin e mesëm	76,1	75,6	74,7	77,1	76,7

Tab. 10
Institucione arsimore sipas niveleve të arsimit

	2013 - 14		2014 - 15		2015 - 16		2016 - 17		2017 - 18	
Institucione Arsimore	Publike	Private	Publike	Private	Publike	Private	Publike	Private	Publike	Private
Kopshte	1.773	127	1.751	106	1.773	124	1.831	133	1.777	142
Shkolla 9 vjeçare	1.337	127	1.372	121	1.284	120	1.249	121	1.220	125
Shkolla të mesme	386	126	381	116	381	119	380	124	380	115
Institucione të Arsimit të Lartë	14	44	14	27	12	23	13	23	13	24

Tab. 11
Të diplomuar në arsimin e lartë sipas fushave të studimit

%

Fushat e studimit	2015	2016	2017
Arsim	12,1	10,4	9,7
Arte dhe shkenca humane	11,7	11,7	11,5
Shkenca sociale, gazetari dhe informacion	7,5	10,6	12,2
Biznes, administrim dhe ligj	29,2	28,0	29,6
Shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë	5,3	4,7	5,0
Teknologji e Informacionit dhe komunikimit	5,0	4,4	6,0
Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim	7,8	8,5	8,2
Bujqësi, pyje, peshkim dhe veterinar	4,4	4,2	2,4
Shëndet dhe mirëqenie	14,7	15,5	13,6
Shërbime	2,3	2,0	1,8
Gjithsej	100,0	100,0	100,0

TREGU I PUNËS



I Hyrje

Statistikat e punësimit mund të përdoren për një numër analizash të ndryshme, përfshirë ato makro-ekonomike që e shohin punën si një faktor prodhimi. Në nivel mikro ato përdoren për të studiuar një sërë aspektesh sociale që lidhen me situatën e punësimit të një individi, siç është punësimi si një burim i të ardhurave familjare, integrimi social i imigrantëve, etj. Duke qenë një tregues strukturor dhe afatshkurtër, nga ana tjetër ai pasqyron strukturën e tregjeve të punës apo sistemeve ekonomike, si dhe ndjek ciklin e biznesit.

Shkalla e papunësisë, nga ana tjetër, e përkufizuar sipas standardeve të përcaktuara nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP), është një nga treguesit më të rëndësishëm të përdorur gjerësisht për krahasim ndërkombëtar dhe kohor. Gjithashtu është një tregues i rëndësishëm në aspektin social dhe ekonomik. Shkalla e papunësisë së një vendi nuk tregon vetëm përqindjen e forcës punëtore që nuk punon, por edhe kapacitetin e papërdorur të punës së një vendi. Për më tepër, ndryshimet në shkallën e papunësisë mund të jenë shenjat e para të një përmirësimi ekonomik apo të një krize ekonomike në vend.

Statistikat e punësimit janë thelbi i shumë politikave të një vendi, për të cilat hartohen strategji, vendosen objektiva kombëtare dhe hartohen plane veprimi që duhen ndërmarrë për implementimin e tyre. Këto statistika i shërbejnë jo vetëm hartimit të strategjive të punësimit, por edhe hartimit të strategjive të arsimit (sikurse zgjerimi dhe përmirësimi i arsimit profesional, fokusimi në degë ku kërkesat për punësim janë më të mëdha apo siguri i mundësive për arsimim përgjatë gjithë jetës), rritjes së mundësive të punësimit për të rinjtë, përmirësimeve në drejtim të disponueshmërisë së institucioneve të kujdesit për fëmijët, duke rritur kështu mundësitë për pjesëmarrje në punësim etj. Matja dhe ndjekja e ecurisë së treguesve të punësimit dhe papunësisë i shërben jo vetëm analizave të situatës aktuale, por edhe monitorimit të strategjive të hartuara dhe marrjes në kohë të masave për të parandaluar rënien ekonomike ose për të nxitur më tej përmirësimin ekonomik.

Statistikat e tregut të punës janë thelbësore për hartimin e shumë prej politikave sociale dhe ekonomike. Shkalla e punësimit, pra proporcioni i popullsisë në moshë pune, që është e punësuar, është një tregues social kyç.

Ky nënkapitull siguron informacion mbi statistikën aktuale të punësimit në Shqipëri, duke përfshirë edhe një analizë të bazuar në dimensione të rëndësishme socio-ekonomike; statistikën e punësimit tregojnë diferenca të konsiderueshme sipas gjinisë, moshës, nivelit arsimor etj.

I Gjetjet kryesore

Në bazë të Anketës së Forcave të Punës (AFP), shkalla e punësimit për personat 15-64 vjeç ka pasur një tendencë në rritje përgjatë periudhës 2013-2017, nga 49,9 % në vitin 2013 në 57,4 % në vitin 2017 (Tabela 2).

Shkallët e punësimit, përgjithësisht, janë më të ulëta për femrat dhe për të rinjtë dhe kjo është një karakteristikë që vërehet në tregun tonë të punës.

Gjatë gjithë periudhës 2013-2017, shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç ka qenë më e ulët tek femrat, krahasuar me meshkujt. Diferenca ndërmjet dy vlerave të shkallëve të punësimit, gjatë periudhës së analizimit, ka qenë më e ulët në vitin 2016 me 12,2 pikë përqindje (61,9 % për meshkujt dhe 49,7 % për femrat 15-64 vjeç) dhe më e madhe në vitin 2015 me 15 pikë përqindje (60,5 % për meshkujt dhe 45,5 % për femrat 15-64 vjeç).

Analiza sipas moshës tregon që shkallët e punësimit janë më të ulëta për grupmoshat më të reja (15-29 vjeç), krahasuar me ato më të mëdha (30-64 vjeç). Në vitin 2017, shkalla e punësimit për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç ishte 33,8 %, ndërsa për ata të moshës 30-64 vjeç ishte 68,7 %.

Për sa i përket tendencës së shkallës së punësimit të të rinjve gjatë periudhës që po analizojmë, vlera e saj ka ardhur në rritje përgjatë periudhës 2013-2017, nga 28,2 % në vitin 2013 në 33,8 % në vitin 2017. Analiza e shkallës së punësimit të të rinjve të moshës 15-29 vjeç sipas gjinisë, tregon që ajo ndjek tendencën e treguesit respektiv për moshën 15-64 vjeç, pra është më e lartë për meshkujt,

krahasuar me femrat. Diferenca ndërmjet dy treguesve ka pasur vlerën më të ulët në vitin 2016 me 8,3 pikë përqindje dhe vlerën më të lartë në vitin 2015 me 12,6 pikë përqindje.

Shkallët e punësimit ndryshojnë konsiderueshëm sipas nivelit më të lartë arsimor. Për popullsinë 15-64 vjeç, shkalla e punësimit është dukshëm më e lartë për personat me arsim të lartë dhe ata me arsim të mesëm profesional dhe kjo vihet re përgjatë gjithë periudhës 2013-2017. Në vitin 2017 ky tregues shënoi vlerën 69,1 % për të punësuarit me arsim të lartë, 68,3 % për ata me arsim të mesëm profesional, 53,0 % për ata me arsim deri 8/9 vjeçar dhe 53,6 % për ata me arsim të mesëm të përgjithshëm (Tabela 3).

Peshën më të madhe në punësimin e popullsisë 15 vjeç e lart, e zënë ata në sektorin e shërbimeve me 42,4 %, dhe ata në sektorin e bujqësisë me 38,2 %, ndërkohë që industria punëson vetëm 19,4 % të të punësuarve gjithsej në vitin 2017. Analizuar sipas gjinisë, në vitin 2017 ndër femrat e punësuar në moshë 15 vjeç e lart, 42,5 % janë të punësuar në bujqësi ndërkohë që ndër meshkujt e punësuar në moshë 15 vjeç e lart, në sektorin e bujqësisë punojnë 34,9 % e tyre. Ndër femrat e punësuar 15 vjeç e lart, përqindja e atyre që punojnë në industri është 15,1 %, ndërkohë që treguesi respektiv për meshkujt është 22,7 %. Sektori i shërbimeve nuk paraqet diferenca të mëdha në angazhimin e femrave dhe meshkujve (Tabela 4).

Të punësuarit me pagë përbëjnë 44,1 % të të punësuarve 15 vjeç e lart në vitin 2017, të vetëpunësuarit 35,8 % dhe punëtorët pa pagesë të familjes 20,1 %. Për sa i përket dallimeve gjinore, vlen për t'u veçuar fakti që në vitin 2017, ndër meshkujt e punësuar në moshë 15 vjeç e lart, 42,6 % e tyre janë të vetëpunësuar, ndërkohë që treguesi respektiv për femrat është 26,8 %. E kundërta vihet re ndër punëtorët pa pagesë të familjes ku, në të njëjtin vit, përqindja e tyre ndër femrat e punësuar në moshë 15 vjeç e lart është 26,8 %, ndërsa për meshkujt kjo përqindje është vetëm 15,1 %. Pra, ndërkohë që nuk ka dallime të mëdha në punësimin me pagë ndër femrat dhe meshkujt, femrat i gjejmë më shumë të punësuar si punëtoresh pa pagesë në biznesin e familjes dhe meshkujt më shumë si të vetëpunësuar (Tabela 5).

Për sa i përket punësimit sipas grup-profesioneve, 48,4 % e të punësuarve në moshë 15 vjeç e lart punojnë si "Punonjës të bujqësisë, pyjeve, peshkimit dhe Zejtarë" në vitin 2017, pasuar nga grupet e "Nëpunës, Punonjës të shitjeve dhe shërbimeve" me

18,6 % dhe "Menaxherë, profesionistë dhe teknikë" me 17,5 % në vitin 2017. Të punësuarit që zënë përqindje më të ulët të të punësuarve në moshë 15 vjeç e lart në vitin 2017 janë grupet "Punonjës të montimit të pajisjeve dhe makinerive" me 8,5 % dhe "Profesione elementare" me 6,6 % (Tabela 6).

Ndërkohë, për sa i përket tipit të kontratës së punës për të punësuarit me pagë, 12,6 % e të punësuarve me pagë (15-64 vjeç) kishin një punë me kontratë me kohëzgjatje të përcaktuar në vitin 2013. Ky proporcion pati një tendencë rritjeje në vitin 2014 me 13,7 %, duke u ulur më pas në vlerën me 11,8 %. Ndërsa në vitet 2016 dhe 2017, vlera e këtij treguesi janë respektivisht 12,5 % dhe 12,3 % (Figura 5).

Burimi i të dhënave

Burimi i të dhënave për të gjithë informacionin e prezantuar në këtë nënkapitull është Anketa e Forcave të Punës e kryer pranë familjeve. Për periudhën 2013-2017, Anketa e Forcave të Punës është e vazhdueshme (mbulon të gjitha javët e vitit kalendarik) dhe rezultatet e paraqitura në këtë publikim janë llogaritur si mesatare vjetore.

Anketa është kryer për herë të parë në vitin 2007 dhe më pas me periodicitet vjetor deri në vitin 2011. Që prej vitit 2012 anketa është e vazhdueshme me rezultate tremujore. Ajo siguron rezultate vjetore dhe tremujore në lidhje me pjesëmarrjen në punësim të personave në moshë 15 vjeç e lart. Ajo mbledh informacion mbi forcat e punës (personat në punësim dhe papunësi), karakteristikat e punësimit, kohën e punës, nivelin arsimor, karakteristikat demografike dhe përbërjen familjare. Anketa përdor definicione punësimi në përputhje me Organizatën Ndërkombëtare të Punës (ONP) dhe Eurostat.

Treguesit tremujorë dhe vjetorë të punësimit që llogariten nga të dhënat e Anketës së Forcave të Punës, publikohen nga INSTAT sipas gjinisë, grup-moshave, nivelit arsimor etj.

Zgjedhja e kampionit bëhet sipas një procedure dyhapëshe ku në hapin e parë zgjidhen zonat gjeografike me probabilitet përpjesëtimor me madhësinë e zonës së numërimit. Në hapin e dytë, brenda secilës prej zonave gjeografike (të zgjedhura në hapin e parë) zgjidhen sipas metodës së zgjedhjes sistematike me probabilitet të barabartë, një numër fiks familjesh.

Për realizimin e anketës së forcave të punës përdoret një strukturë panel e alternuar zgjedhjeje, përmes së cilës një familje e zgjedhur për t'u intervistuar njëherë, mbahet në kampion për pesë tremujorë të njëpasnjëshëm. Sipas strukturës panel të përdorur, në çdo tremujor një e pesta e familjeve të zgjedhura janë të reja dhe 80 % e familjeve janë të njëjta. Mbledhja e të dhënave në terren bëhet përgjatë gjithë muajve të vitit. Të dhënat e mbledhura i referohen një periudhe të caktuar që njihet si javë reference. Javë e referencës është javë kalendarike nga e hëna në të dielë para datës së intervistës.

Përkufizime


Të punësuar janë personat në moshë 15 vjeç e lart të cilët gjatë javës së referencës punuan – qoftë edhe për një orë në javë – kundrejt një page apo përfitimi. Konsiderohen të punësuar edhe personat që nuk punuan në javën e referencës, por që e kishin një punë nga e cila munguan përkohësisht për arësye si sëmundje, pushime, arsimim/trainim, grevë, leje lindje, mot i keq etj.

(Personat të cilët punojnë në fermën e tyre të vogël, të cilët nuk shesin produktet e tyre, por prodhojnë vetëm për vetë-konsum, konsiderohen të punësuar)

Popullsia në moshë pune është popullsia 15-64 vjeç.


Shkalla e punësimit është raporti i të punësuarve 15-64 vjeç kundrejt popullsisë në moshë pune.

Fig. 1
Shkalla e punësimit sipas gjinisë




Burimi i informacionit: Anketa e Forcave të Punës, 2013-2017

Fig. 2
Shkalla e punësimit sipas nivelit arsimor




Burimi i informacionit: Anketa e Forcave të Punës, 2013-2017

Fig. 3
Shpërndarja e punësimit sipas aktiviteteve ekonomike




Burimi i informacionit: Anketa e Forcave të Punës, 2013-2017

Fig. 4
Shpërndarja e të punësuarve sipas gjinisë dhe statusit në punësim



Burimi i informacionit: Anketa e Forcave të Punës, 2013-2017

Fig. 5
Përqindja e të punësuarve me pagë me kontratë pune me kohëzgjatje të caktuar



Burimi i informacionit: Anketa e Forcave të Punës, 2013-2017

Tab. 1
Punësimi sipas gjinisë dhe grup-moshave

Gjinia dhe grup-moshat	Numër				
	2013	2014	2015	2016	2017
Gjithsej	1.023.688	1.037.061	1.086.612	1.157.177	1.194.969
15-29	198.886	198.929	205.355	211.461	219.750
30-64	790.892	807.146	850.444	908.506	930.681
65+	33.909	30.986	30.813	37.210	44.539
15-64	989.779	1.006.075	1.055.799	1.119.967	1.150.430
Meshkuj	562.887	585.679	620.612	650.201	678.798
15-29	115.204	118.726	129.678	126.322	134.026
30-64	424.899	446.325	470.137	498.115	516.418
65+	2.784	20.628	20.798	25.764	28.354
15-64	540.103	565.051	599.815	624.437	650.444
Femra	460.801	451.382	466.000	506.976	516.170
15-29	83.682	80.203	75.678	85.139	85.723
30-64	365.993	360.821	380.307	410.391	414.264
65+	11.125	10.358	10.015	11.446	16.183
15-64	449.675	441.024	455.985	495.530	499.987

Burimi i informacionit: Anketa e Forcave të Punës, 2013-2017

Tab. 2
Shkalla e punësimit sipas gjinisë dhe grup-moshave

Gjinia dhe grup-moshat	%				
	2013	2014	2015	2016	2017
Gjithsej	44,1	44,3	46,2	48,7	50,3
15-29	28,2	28,2	29,8	32,4	33,8
30-64	61,8	62,7	65,2	67,2	68,7
65+	10,1	8,9	8,6	10,1	12,0
15-64	49,9	50,5	52,9	55,9	57,4
Meshkuj	50,7	51,4	53,3	54,7	57,1
15-29	33,7	33,0	35,8	36,3	38,5
30-64	70,8	72,7	74,8	75,4	77,9
65+	13,6	12,4	12,0	14,3	15,9
15-64	57,3	58,0	60,5	61,9	64,3
Femra	38,0	37,6	39,2	42,8	43,5
15-29	23,0	23,3	23,1	28,0	28,3
30-64	53,9	53,6	56,3	59,3	60,0
65+	6,6	5,7	5,3	6,0	8,4
15-64	43,1	43,4	45,5	49,7	50,3

Burimi i informacionit: Anketa e Forcave të Punës, 2013-2017

Tab. 3
Shkalla e punësimit sipas gjinisë dhe nivelit arsimor

%

Gjinia dhe Niveli arsimor	2013	2014	2015	2016	2017
Gjithsej (15-64)	49,9	50,5	52,9	55,9	57,4
Deri 8/9 vjeçar	45,3	46,7	50,2	52,5	53,0
E mesme profesionale	68,7	64,5	63,8	64,5	68,3
E mesme e përgjithshme	43,0	44,5	47,1	52,3	53,6
I lartë	67,1	66,5	64,4	66,6	69,1
Meshkuj (15-64)	57,3	58,0	60,5	61,9	64,3
Deri 8/9 vjeçar	51,8	53,0	55,5	57,2	58,7
E mesme profesionale	76,4	75,0	72,8	71,2	76,8
E mesme e përgjithshme	52,2	53,4	57,9	62,1	63,2
I lartë	70,6	70,6	71,4	69,4	73,2
Femra (15-64)	43,1	43,4	45,5	49,7	50,3
Deri 8/9 vjeçar	40,1	41,3	45,3	48,3	47,8
E mesme profesionale	56,8	48,2	50,6	54,9	54,8
E mesme e përgjithshme	33,7	34,7	34,9	40,3	42,0
I lartë	64,2	63,1	58,9	64,4	65,8

Burimi i informacionit: Anketa e Forcave të Punës, 2013-2017

Tab. 4
Punësimi sipas gjinisë dhe aktivitetit ekonomik

% ndaj popullsisë së punësuar të moshës 15 vjeç e lart

Gjinia dhe Aktiviteti ekonomik	2013	2014	2015	2016	2017
Punësimi gjithsej	1.023.688	1.037.061	1.086.612	1.157.177	1.194.969
Bujqësi	44,2	42,7	41,3	40,2	38,2
Industri	16,9	17,4	18,5	19,3	19,4
Shërbime	38,9	39,9	40,2	40,4	42,4
Meshkuj	562.887	585.679	620.612	650.201	678.798
Bujqësi	37,1	36,9	36,5	36,2	34,9
Industri	22,3	21,9	22,1	22,9	22,7
Shërbime	40,7	41,1	41,4	40,9	42,5
Femra	460.801	451.382	466.000	506.976	516.170
Bujqësi	53,0	50,2	47,7	45,4	42,5
Industri	10,2	11,6	13,8	14,7	15,1
Shërbime	36,8	38,2	38,5	39,9	42,4

Burimi i informacionit: Anketa e Forcave të Punës, 2013-2017

Tab. 5
Punësimi (15 vjeç e lart) sipas gjinisë dhe statusit të punësimit

% ndaj popullsisë së punësuar të moshës 15 vjeç e lart

Gjinia dhe Statusi në punësim	2013	2014	2015	2016	2017
Punësimi gjithsej	1.023.688	1.037.061	1.086.612	1.157.177	1.194.969
Të punësuar me pagë	40,5	41,6	41,0	41,2	44,1
Të vetëpunësuar	25,8	26,0	29,2	34,9	35,8
Punëtorë pa pagesë të familjes	33,8	32,4	29,8	23,9	20,1
Meshkuj	562.887	585.679	620.612	650.201	678.798
Të punësuar me pagë	43,0	42,1	39,9	39,7	42,3
Të vetëpunësuar	32,4	32,8	37,8	42,0	42,6
Punëtorë pa pagesë të familjes	24,5	25,1	22,3	18,2	15,1
Femra	460.801	451.382	466.000	506.976	516.170
Të punësuar me pagë	37,3	40,8	42,6	43,0	46,4
Të vetëpunësuar	17,6	17,2	17,6	25,7	26,8
Punëtorë pa pagesë të familjes	45,1	42,0	39,8	31,2	26,8

Burimi i informacionit: Anketa e Forcave të Punës, 2013-2017

Tab. 6
Punësimi (15 vjeç e lart) sipas gjinisë dhe grup profesioneve

% ndaj popullsisë së punësuar të moshës 15 vjeç e lart

Gjinia dhe Grup-profesionet	2013	2014	2015	2016	2017
Gjithsej	1.023.688	1.037.061	1.086.612	1.157.177	1.194.969
Menaxherë, profesionistë dhe teknikë	16,5	17,7	17,3	17,7	17,5
Nëpunës, Punonjës të shitjeve dhe shërbimeve	17,8	16,3	17,9	17,8	18,6
Punonjës të bujqësisë, pyjeve, peshkimit dhe Zejtarë	56,6	53,5	52,4	50,7	48,4
Punonjës të montimit të pajisjeve dhe makinerive	5,5	6,4	6,5	7,4	8,5
Profesione elementare	3,1	5,6	5,2	6,1	6,6
Forcat e armatosura	0,3	0,4	0,6	0,4	0,5
Meshkuj	562.887	585.679	620.612	650.201	678.798
Menaxherë, profesionistë dhe teknikë	14,2	15,6	14,2	15,3	14,9
Nëpunës, Punonjës të shitjeve dhe shërbimeve	20,2	17,9	19,8	19,1	19,9
Punonjës të bujqësisë, pyjeve, peshkimit dhe Zejtarë	54,9	53,2	53,2	51,5	50,2
Punonjës të montimit të pajisjeve dhe makinerive	6,8	7,3	7,1	8,2	8,3
Profesione elementare	3,2	5,3	4,8	5,3	6,0
Forcat e armatosura	0,6	0,6	0,9	0,6	0,7
Femra	460.801	451.382	466.000	506.976	516.170
Menaxherë, profesionistë dhe teknikë	19,4	20,4	21,5	20,8	20,8
Nëpunës, Punonjës të shitjeve dhe shërbimeve	14,8	14,2	15,5	16,0	16,8
Punonjës të bujqësisë, pyjeve, peshkimit dhe Zejtarë	58,6	53,9	51,2	49,6	46,1
Punonjës të montimit të pajisjeve dhe makinerive	4,0	5,2	5,8	6,4	8,9
Profesione elementare	2,9	6,2	5,8	7,0	7,3
Forcat e armatosura	...	...	...	0	0,2

Burimi i informacionit: Anketa e Forcave të Punës, 2013-2017

PAPUNËSIA

Hyrje

Tregues thelbësor në statistikat e tregut të punës është edhe shkalla e papunësisë, posaçërisht pjesa që zënë të papunët në forcën e punës.

Ky nënkapitull jep informacion në lidhje me statistikat aktuale të papunësisë në Shqipëri, të cilat, të vëzhguara në një hark kohor pesëvjeçar, japin një pamje dinamike të situatës së të papunëve në tregun e punës.

Gjetjet kryesore

Trendi i papunësisë

Statistikat aktuale të papunësisë në Shqipëri, të vëzhguara në harkun kohor pesëvjeçar 2013-2017, japin një pamje dinamike të situatës së të papunëve në tregun e punës. Pas vitit 2013 shkalla e papunësisë për popullsinë 15 vjeç e lart ka një tendencë në rënie, duke shënuar vlerën më të ulët në vitin 2017, me 13,7 %. Për grupmoshën e popullsisë 15-64 vjeç shkalla e papunësisë pësoi ulje me 14,1 %. Krahasuar me një vit më parë, ky tregues, për grupmoshën e popullsisë 15-64 vjeç, shënoi ulje me 1,5 pikë përqindje ndërsa krahasuar me 2013, ai u ul me 2,3 pikë përqindje.

Shkalla e papunësisë ndryshon sipas nivelit arsimor. Në vitet 2013-2017, shkalla e papunësisë për grupmoshën 15-64 vjeç vazhdon të jetë më e lartë për personat me arsim të mesëm të përgjithshëm. Në vitin 2017 ajo shënon vlerën 17,2 % për këtë kategori. Për të njëjtën popullsi vërehet se ka një diferencë të konsiderueshme midis shkallës së papunësisë për personat me arsim të mesëm të përgjithshëm dhe atyre me arsim të mesëm profesional, përgjatë gjithë periudhës 2013-2017. Kjo diferencë, në vitin 2017, është 4,5 pikë përqindje më shumë për të papunët me arsim të mesëm të përgjithshëm, krahasuar me ata me arsim të mesëm profesional. Për sa i përket kategorisë së të papunëve me arsim të lartë, shkalla e papunësisë në vitin 2017 është ulur me 3,3 pikë përqindjeje, krahasuar me vitin 2016. Kjo ulje e shkallës së papunësisë është më e ndjeshme tek femrat, me 3,7 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2016 (Tabela 2).

Nëse i referohemi kohëzgjatjes së papunësisë, personat e papunë prej një viti e më shumë, të quajtur të papunët afatgjatë, zënë pjesën më të madhe ndër të papunët e moshës 15-64 vjeç (65,0 % në vitin 2017) (Tabela 3).

Në popullsinë ekonomikisht jo-aktive (personat që nuk janë të klasifikuar si të papunë apo si të punësuar) të grupmoshës 15-64 vjeç, përqindja e kategorisë së të dekurajuarve shënon vlerën më të lartë në vitin 2013 (16,1 %) dhe vlerën më të ulët në vitin 2017 (8,2 %). Ky tregues është ulur me 7,9 pikë përqindje në vitin 2017, krahasuar me vitin 2013 (Tabela 4).

Trendi i papunësisë për meshkujt dhe femrat

Shkalla e papunësisë ka tendenca të ndryshme sipas ndarjes gjinore. Në Shqipëri, gjatë periudhës 2013-2017, për popullsinë 15 vjeç e lart kemi shkallë papunësie më të ulët për femrat sesa për meshkujt. Kjo diferencë, për vitin 2017, është me 2 pikë përqindje (14,6 % për meshkujt dhe 12,6 % për femrat). Në vitin 2015 shkalla e papunësisë, si për meshkujt ashtu edhe për femrat, ishte në të njëjtën vlerë, 17,1% (Tabela1).

Në vitin 2017, shkalla e papunësisë për meshkujt 15 vjeç e lart është ulur 1,3 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2016, ndërsa për femrat shkalla e papunësisë është ulur me 1,8 pikë përqindje. Vihet re se gjatë periudhës 2013-2017, si për meshkujt ashtu edhe për femrat e grupmoshës 15-64 vjeç, shkalla e papunësisë është më e lartë për kategorinë e arsimit të mesëm të përgjithshëm sesa për ata me arsim profesional dhe të lartë. Ndër personat me arsim të lartë, meshkujt 15-64 vjeç kanë shkallë papunësie më të ulët sesa femrat. Diferenca më e madhe vihet re në vitin 2015, ku shkalla e papunësisë për femrat ishte 5 pikë përqindje më e lartë sesa për meshkujt e kësaj kategorie. Në vitin 2017, shkalla e papunësisë për meshkujt me arsim të lartë është 13,7 %, ndërsa për femrat 13,9 % (Tabela 2).

Në vitin 2017, shkalla e papunësisë për femrat me arsim të lartë është ulur me 3,7 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2016 dhe për ato me arsim profesional ky tregues është ulur me 1,2 pikë përqindje.

Për sa i përket papunësisë afatgjate, nga viti 2013 deri në 2017, për popullsinë e grupmoshës 15-64 vjeç, pesha që zënë meshkujt e papunë afatgjatë ndër meshkujt e papunë është më e ulët se pesha respektive për femrat, me 63,4 % dhe 67,6 % në vitin 2017 (Tabela 3).

Ndër meshkujt e moshës 15-64 vjeç ekonomiksht jo aktivë, në vitet 2013-2017 përqindja e të papunëve të dekurajuar është më e madhe se përqindja ekuivalente e femrave (11,6 % për meshkujt dhe 6,2 % për femrat në vitin 2017). Diferenca është më e madhe për grupmoshën 30-64 vjeç në favor të meshkujve (Tabela 4).

Trendi i papunësisë tek të rinjtë

Të rinjtë karakterizohen, përgjithësisht, nga një shkallë më e lartë papunësie, krahasuar me grupmoshat e tjera. Sipas Anketës së Forcave të Punës, shkalla e papunësisë për grupmoshën 15-29 vjeç ka ardhur në rritje deri në vitin 2015 (33,2 %) dhe pastaj pëson një ulje, duke arritur në vlerën 25,9 % në vitin 2017. Ky tregues, përgjatë gjithë periudhës që analizohet, është pothuajse 2 herë më i lartë sesa shkalla e papunësisë për popullsinë 15 vjeç e lart (Tabela 1).

Nga viti 2013 deri në vitin 2017, të rinjtë meshkuj të moshës 15-29 vjeç, kanë shkallë papunësie më të lartë se femrat e të njëjtës grupmoshë, me përjashtim të vitit 2015 kur ky tregues është 2,4 pikë përqindje më i lartë për femrat sesa për meshkujt e së njëjtës grupmoshë (Tabela 1). Ndër të rinjtë 15-29 vjeç ekonomiksht jo-aktivë, përqindja e kategorisë së të dekurajuarve në vitin 2017 ulet me 6,3 pikë përqindje në krahasim me vitin 2013. Ndikimin më të madh në këtë ulje e japin meshkujt e kësaj grupmoshe me 7,1 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2013 (Tabela 4). Në popullsinë 15-29 vjeç identifikohet një grup i veçantë ku përfshihen të rinjtë që nuk janë as të punësuar dhe as duke ndjekur arsim ose ndonjë trajnim. Përgjatë viteve 2013-2017, mesatarisht tre në dhjetë të rinj në moshë 15-29 vjeç janë pjesë e këtij grupi. Në vitin 2017, të rinjtë që nuk punojnë dhe nuk janë në arsim apo trajnim përbëjnë 29,7 % të të rinjve. Vihet re se përqindja e femrave të kësaj moshe jo në punësim, arsim apo trajnim është më e lartë se përqindja ekuivalente për meshkujt, përkatësisht 34,4 % dhe 25,6 % (Tabela 5). Duke analizuar grupin e të rinjve që nuk janë të punësuar, duke ndjekur ndonjë shkollë apo trajnim sipas statusit të aktivitetit ekonomik,

rezulton që rreth 65,1 % e tyre janë ekonomiksht jo-aktivë. E parë në këndvështrimin gjinor 77,6 % e të rejave që nuk janë të punësuar dhe as duke ndjekur ndonjë shkollë apo trajnim, në vitin 2017, janë ekonomiksht jo-aktive në tregun e punës. Ndërkohë 50,4 % e meshkujve të këtij grupi janë ekonomiksht jo-aktivë për vitin 2017.

Burimi i të dhënave

Ashtu si për treguesit e punësimit, burimi i të dhënave që përdoret për të llogaritur treguesit e papunësisë në këtë nënkapitull është Anketa e Forcave të Punës që kryhet në familje dhe që zhvillohet sipas rekomandimeve të Eurostat dhe Organizatës Ndërkombëtare të Punës. Kjo anketë, e kryer në mënyrë të vazhdueshme që nga viti 2012, mundëson informacion me tregues tremujorë dhe vjetorë. Treguesit tremujorë japin informacion kryesisht të përgjithshëm mbi papunësinë, të ndarë sipas gjinisë dhe grupmoshave. Treguesit vjetorë, për vitin 2017, dhe të llogaritur si mesatare vjetore për vitet 2013-2017, janë më të detajuara duke dhënë informacion për papunësinë sipas nivelit arsimor, kohëzgjatjes, sipas kategorive të të papunëve etj. Treguesit e papunësisë publikohen nga INSTAT në vlera absolute dhe në përqindje.

Përkufizime:

Të papunë konsiderohen personat që ishin:

1. Pa punë gjatë javës së referencës, as nuk kishin një punë dhe as kryenin ndonjë punë (për një orë ose më shumë) kundrejt një page ose përfitimi;
2. Aktualisht të gatshëm për të punuar (brenda dy javëve që pasojnë javën e referencës);
3. Duke kërkuar punë në mënyrë aktive (gjatë periudhës katër javore që përfundon me javën e referencës, kishin ndërmarrë hapa specifike për të kërkuar punë me pagë ose për të ngritur një biznes të tyre) ose kishin gjetur një punë që do ta fillonin së shpejti (brenda një periudhe prej, të shumtën, tre muaj).

Si hapa specifike për të kërkuar punë konsiderohen:

- Kontaktim me një zyrë publike punësimi për të gjetur punë;
- Kontaktim me një agjenci private punësimi për të gjetur punë;
- Aplikim direkt pranë ndonjë punëdhënësi;
- Kërkuar miqve/shokëve, të afërmve, sindikatave etj;
- Vendosur ose përgjigjur lajmërimeve në gazeta;
- Studiuar lajmërimet në gazeta;

- Marrë pjesë në një test apo intervistë;
- Kërkuar për tokë, godinë ose pajisje;
- Aplikuar për leje, licenca ose burime financiare.


Forca e Punës përfshin personat e punësuar dhe të papunë.

Shkalla e papunësisë është raporti i të papunëve kundrejt forcës së punës.

Popullsia jo-ekonomikisht aktive përfshin të gjithë personat të cilët nuk janë klasifikuar si të punësuar ose të papunë (nxënës/studentë, shtëpiakë, në shërbim të detyrueshëm ushtarak, në pension, të paaftë, të papunë të dekurajuar etj.).


Papunësia afatgjatë i referohet numrit të personave të papunë prej një viti a më shumë.

Fig. 1
Shkalla e papunësisë sipas grup-moshave




Burimi i informacionit: Anketa e Forcave të Punës, 2013-2017

Fig. 2
Shkalla e papunësisë sipas gjinisë dhe nivelit arsimor




Burimi i informacionit: Anketa e Forcave të Punës, 2016-2017

Fig. 3
Përqindja e të papunëve të dekurajuar sipas gjinisë




Burimi i informacionit: Anketa e Forcave të Punës, 2013-2017

Fig. 4
Përqindja e të papunëve të dekurajuar sipas grup-moshave



Burimi i informacionit: Anketa e Forcave të Punës, 2013-2017

Fig. 5
Shpërndarja e të rinjve (15-29 vjeç) jo në punësim as në shkollë/
trajnim sipas statusit të aktivitetit ekonomik



Burimi i informacionit: Anketa e Forcave të Punës, 2013-2017

Tab. 1
Shkalla e papunësisë sipas gjinisë dhe grup-moshave

Gjinia dhe grup-moshat	2013	2014	2015	2016	2017
Gjithsej	15,9	17,5	17,1	15,2	13,7
15-29	27,2	32,5	33,2	28,9	25,9
30-64	13,1	13,3	12,5	11,8	10,8
15-64	16,4	17,9	17,5	15,6	14,1
Meshkuj	17,8	19,2	17,1	15,9	14,6
15-29	29,7	35,6	32,3	29,7	27,0
30-64	14,6	14,0	12,2	12,2	11,3
15-64	18,3	19,7	17,5	16,4	15,1
Femra	13,5	15,2	17,1	14,4	12,6
15-29	23,6	27,4	34,7	27,8	24,0
30-64	11,2	12,3	12,9	11,2	10,1
15-64	13,8	15,5	17,4	14,6	12,8

Burimi i informacionit: Anketa e Forcave të Punës, 2013-2017

Tab. 2
Shkalla e papunësisë sipas gjinisë dhe nivelit arsimor

Gjinia dhe Niveli arsimor	2013	2014	2015	2016	2017
Gjithsej (15-64)	16,4	17,9	17,5	15,6	14,1
Deri 8/9 vjeçar	14,8	15,1	14,0	13,3	12,9
E mesme profesionale	11,8	13,6	14,8	14,9	12,7
E mesme e përgjithshme	23,2	25,2	23,2	18,9	17,2
I lartë	15,0	17,3	19,2	17,1	13,8
Meshkuj (15-64)	18,3	19,7	17,5	16,4	15,1
Deri 8/9 vjeçar	18,3	18,7	16,1	15,5	15,2
E mesme profesionale	12,2	13,0	13,4	15,4	12,7
E mesme e përgjithshme	25,0	26,4	22,0	18,2	17,1
I lartë	13,6	16,1	16,6	16,5	13,7
Femra (15-64)	13,8	15,5	17,4	14,6	12,8
Deri 8/9 vjeçar	10,9	10,8	11,6	10,8	10,2
E mesme profesionale	11,2	15,0	17,4	14,1	12,9
E mesme e përgjithshme	20,3	23,0	25,5	20,3	17,5
I lartë	16,2	18,3	21,6	17,6	13,9

Burimi i informacionit: Anketa e Forcave të Punës, 2013-2017

Tab. 3
Papunësia afatgjatë sipas gjinisë dhe nivelit arsimor

Gjinia dhe Niveli arsimor	2013	2014	2015	2016	2017
Gjithsej (15-64)	72,4	64,3	66,0	66,6	65,0
Deri 8/9 vjeçar	74,4	65,7	70,1	69,7	67,5
E mesme profesionale	76,6	72,1	81,3	80,6	75,0
E mesme e përgjithshme	72,1	63,2	62,2	65,5	63,1
I lartë	64,7	59,3	57,9	54,2	56,9
Meshkuj (15-64)	69,7	60,9	65,8	65,3	63,4
Deri 8/9 vjeçar	70,8	61,6	67,5	66,8	65,1
E mesme profesionale	73,2	70,0	82,2	77,6	76,4
E mesme e përgjithshme	69,0	59,1	61,6	63,4	59,9
I lartë	63,2	57,2	59,7	54,7	54,5
Femra (15-64)	76,9	70,0	66,3	68,4	67,6
Deri 8/9 vjeçar	81,2	74,2	74,4	74,6	71,8
E mesme profesionale	84,4	76,5	80,1	86,8	71,9
E mesme e përgjithshme	78,5	71,4	63,2	69,0	68,7
I lartë	65,7	61,0	56,7	53,9	58,9

Burimi i informacionit: Anketa e Forcave të Punës, 2013-2017

Tab. 4

Përqindja e të papunëve të dekurajuar sipas gjinisë dhe grup-moshave

Gjinia dhe grup-moshat	2013	2014	2015	2016	2017
Gjithsej	11,8	10,0	8,3	7,2	5,5
15-29	11,8	11,1	9,1	7,4	5,3
30-64	21,2	17,7	15,5	14,4	11,4
15-64	16,1	14,2	12,1	10,7	8,2
Meshkuj	12,7	11,5	10,0	9,4	7,2
15-29	13,8	13,5	11,9	9,3	6,7
30-64	28,4	25,3	22,8	24,8	21,6
15-64	19,2	17,6	15,7	14,9	11,6
Femra	11,1	9,1	7,2	5,7	4,4
15-29	10,4	9,3	6,9	5,6	4,1
30-64	18,4	14,9	12,7	10,2	7,8
15-64	14,5	12,3	10,0	8,1	6,2

Burimi i informacionit: Anketa e Forcave të Punës, 2013-2017

Tab. 5

Përqindja e të rinjve (15-29 vjeç) jo në punësim as në shkollë/ trajnim sipas gjinisë dhe statusit të aktivitetit ekonomik

Gjinia dhe statusi i aktivitetit ekonomik	2013	2014	2015	2016	2017
Gjithsej (% ndaj popullsisë së të rinjve 15-29 vjeç)	33,4	34,5	32,8	30,0	29,7
<i>prej të cilëve</i>					
Të papunë	29,9	36,1	40,8	39,2	34,9
Ekonomikisht jo-aktivë	70,1	63,9	59,2	60,8	65,1
Meshkuj	31,1	31,8	29,4	27,5	25,6
<i>prej të cilëve</i>					
Të papunë	43,5	52,9	52,5	50,6	49,6
Ekonomikisht jo-aktivë	56,5	47,1	47,5	49,4	50,4
Femra	35,6	37,3	36,6	32,9	34,4
<i>prej të cilëve</i>					
Të papunë	18,7	21,2	30,5	28,4	22,4
Ekonomikisht jo-aktivë	81,3	78,8	69,5	71,6	77,6

Burimi i informacionit: Anketa e Forcave të Punës, 2013-2017

Tab. 6
Papunësia sipas gjinisë dhe grup-moshave

	Numër				
Gjinia dhe grup-moshat	2013	2014	2015	2016	2017
Gjithsej	194.043	219.797	223.864	207.770	190.427
15-29	74.447	95.922	102.025	86.148	76.776
30-64	119.059	123.440	121.506	120.995	112.618
15-64	193.506	219.362	223.531	207.143	189.394
Meshkuj	121.874	138.851	127.770	122.805	116.148
15-29	48.656	65.721	61.843	53.396	49.673
30-64	72.682	72.771	65.594	68.978	66.117
15-64	121.337	138.492	127.437	122.374	115.790
Femra	72.169	80.946	96.094	84.965	74.279
15-29	25.791	30.202	40.182	32.752	27.103
30-64	46.377	50.669	55.912	52.017	46.502
15-64	72.169	80.870	96.094	84.769	73.605

Burimi i informacionit: Anketa e Forcave të Punës, 2013-2017

Tab. 7
Papunësia sipas gjinisë dhe kohëzgjatjes

	Numër				
Gjinia dhe Kohëzgjatja e papunësisë	2013	2014	2015	2016	2017
Gjithsej	194.043	219.797	223.864	207.770	190.427
më pak se 6 muaj	33.056	51.585	45.872	40.108	39.934
6-12 muaj	20.513	26.871	30.170	30.093	27.185
12 muaj +	140.474	141.342	147.822	137.569	123.307
Meshkuj	121.874	138.851	127.770	122.805	116.147
më pak se 6 muaj	22.362	35.739	26.498	25.059	26.079
6-12 muaj	14.569	18.480	17.194	18.095	16.589
12 muaj +	84.943	84.631	84.078	79.651	73.480
Femra	72.169	80.946	96.094	84.965	74.279
më pak se 6 muaj	10.693	15.845	19.374	15.049	13.855
6-12 muaj	5.944	8.390	12.976	11.999	10.597
12 muaj +	55.531	56.711	63.744	57.918	49.827

Burimi i informacionit: Anketa e Forcave të Punës, 2013-2017

STATISTIKAT E KONSUMIT



I Hyrje

Statistikat e Konsumit sigurojnë përshkrime të nivelit dhe strukturës së shpenzimeve për konsum të Njësive Ekonomike Familjare (NjEF) në Shqipëri si dhe të treguesve të tjerë me bazë shpenzimet e konsumit. Të dhënat e konsumit llogariten bazuar në Anketën e Buxhetit të Familjes, i cili është një vërtetim statistikor që kryhet pranë NjEF me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri dhe jep një panoramë të qartë të situatës socio-ekonomike të tyre. Rezultatet e kësaj ankete përdoren gjithashtu për përditësimin e Indeksit të Çmimeve të Konsumit dhe llogaritjen e Konsumit Final të Familjeve si një agregat i rëndësishëm i PBB me metodën e shpenzimeve.

I Gjetjet kryesore

Shpenzimet mesatare mujore për konsum të NjEF në vitin 2017 llogariten të jenë 73.400 Lekë ose ndryshe në vlera me bazë vjetore, 880.794 Lekë, duke pasur parasysh se një NjEF në Shqipëri përbëhet mesatarisht nga 3,7 persona.

Struktura e shpenzimeve mesatare mujore/vjetore për konsum të NjEF na jep një panoramë të qartë të mënyrës së shpërndarjes të buxhetit familjar. Peshën më të madhe të tij, e zënë shpenzimet për ushqime dhe pije alkoolike, 44,1 përqind, një pjesë e konsiderueshme e të cilave shkon për produktet: qumësht e nënprodukte të tij, vezë, bukë dhe drithëra dhe mish dhe nënproduktet e tij. Përsa i përket shpenzimeve që NjEF i dedikojnë banesës për energji elektrike, ujë, lëndë djegëse, qira të paguar dhe riparime të vogla, ato përbëjnë 10,9 përqind. NjEF në Shqipëri i dedikojnë transportit 7,2 përqind të buxhetit gjithsej (Tab. 1).

Shpenzimet mesatare për konsum sipas tipologjisë së NjEF: Struktura e shpenzimeve për konsum sipas tipologjisë së NjEF shfaq një pjesë të kësaj panorame socio-ekonomike për çdo grup-tip të NjEF në Shqipëri. Niveli dhe struktura e shpenzimeve për konsum ndryshojnë në varësi të madhësisë dhe përbërjes së NjEF që ndikojnë në mënyrën e shpërndarjes së buxhetit familjar. NjEF e përbëra nga një person i vetëm me fëmijë në varësi shpenzojnë më shumë për ushqim krahasuar me tipet e tjera të NjEF, 47,1 përqind. Ndërsa,

shpenzimet më të larta për konsum të pijeve alkoolike dhe duhanit regjistrohen në tipet e NjEF me dy ose më shumë të rritur pa fëmijë në varësi 3,6 përqind. Shpenzimet më të larta për veshje dhe këpucë regjistrohen në NjEF e përbëra nga një person i vetëm me fëmijë në varësi dhe dy të rritur me fëmijë përkatësisht 5,5 dhe 4,7 përqind. Prezenca e fëmijëve në NjEF e përbëra nga tri ose më shumë të rritur me fëmijë sjell shpenzime më të larta për transport 8,2 përqind të buxhetit. Shpenzimet më të larta për arsim regjistrohen në NjEF e përbëra nga tri ose më shumë të rritur pa fëmijë në varësi 6,3 përqind. Ndërsa përsa i përket shpenzimeve për kujdes shëndetësor, ato janë më të larta në NjEF e përbëra nga dy të rritur pa fëmijë, 5,5 përqind. NjEF e përbëra nga personat të cilët jetojnë vetëm vihet re se shpenzojnë më shumë për mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje të zakonshme të banesës se tipet e tjera. Përsa i përket shpenzimeve në restorante dhe hotele, ato janë më të larta në NjEF e përbëra nga një person i vetëm, 7,6 përqind. NjEF e përbëra nga person i vetëm me fëmijë në varësi shfaqin shpenzimet më të larta për argëtim dhe kulturë, 5,7 përqind. Shpenzimet më të larta për komunikim regjistrohen në tipet e NjEF të përbëra nga një person i vetëm, 3,8 përqind (Tab. 2).

Shpenzimet mesatare për konsum sipas madhësisë së NjEF: Analiza e strukturës së shpenzimeve për konsum sipas madhësisë së NjEF plotëson akoma më shumë panoramën socio-ekonomike për çdo kategori të klasifikimit të saj. Shpenzimet më të larta të konsumit për ushqime dhe pije jo-alkoolike duket se janë karakteristikë e NjEF të përbëra nga 2 persona, 46,0 përqind ndjekur nga NjEF e përbëra nga 7 e më shumë persona, 45,9 përqind. Shpenzimet për konsum të pijeve alkoolike dhe duhanit, vërehen me përqindje më të lartë tek NjEF e përbëra nga më shumë se 7 persona, 4,1 përqind. NjEF e përbëra nga 1 person, shfaqin shpenzime më të larta për banesë, ujë, energji elektrike dhe qira të paguar, 14,0 përqind. Shpenzimet më të larta për transport llogariten të jenë më të larta për NjEF e përbëra nga 6 persona, 8,8 përqind. NjEF e përbëra nga 2 persona kanë shpenzimet më të larta për kujdes shëndetësor, 5,4 përqind. Ndër shpenzimet për arsim, NjEF që i dedikojnë shpenzime më të larta se llojet e tjera, janë ato të cilat në përbërjen e tyre kanë 5

persona, 5,1 përqind. Përsa i përket shpenzimeve për mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje të zakonshme të banesës, NJEF e përbëra nga 1 dhe 2 persona shpenzojnë më shumë se të tjerat, 5,5 dhe 5,2 përqind. NJEF me "4 dhe 3 persona" shfaqin përqindjet më të larta të shpenzimeve të konsumit gjithsej, për veshje dhe këpucë, 4,6 dhe 4,5 përqind. Shpenzimet më të larta për restorante dhe hotele paraqiten tek NJEF e përbëra nga 1 person 7,6 përqind (Tab. 3).

Burimet e të dhënave

Të dhënat e paraqitura në këtë material i referohen Anketës së Buxhetit të Familjes 2017. Njësitë e vrojtueshme janë Njësitë Ekonomike Familjare dhe anëtarët aktualë të tyre, që janë rezident në Shqipëri në vitin përkatës të mbledhjes së të dhënave. Individët që jetojnë në banesa kolektive dhe në institucione të tjera specifike nuk janë objekt vrojtimi. Anketa e Buxhetit të Familjes u krye për herë të parë në vitet 1999-2000 dhe ishte përfaqësuese vetëm për zonat urbane, për të vazhduar më pas në vitet 2006-2007, 2008-2009¹ dhe që nga viti 2014 e vazhdueshme. Nga viti 2006-2007 anketa është gjithë-përfshirëse për të gjithë territorin e Shqipërisë duke përfshirë zonat urbane dhe rurale si dhe me përfaqësim në nivel qarku.

Anketa e Buxhetit të Familjes 2017 u krye nga INSTAT përgjatë gjithë vitit, me një kampion prej 9.312 NJEF. Në përfundim të vrojtimit u intervistuan 7.519 NJEF të shpërndara në mënyrë uniforme në të gjithë territorin e Shqipërisë. Shkalla e përgjigjes së NJEF, e llogaritur si raport i numrit të NJEF që kanë plotësuar anketën ndaj numrit të NJEF të zgjedhura, shprehur në përqindje rezultoi 80,7 përqind. Zgjedhja e kampionit bëhet sipas një procedure dy-hapëshe. Njësitë e hapit të parë (PSU) janë zonat e Censusit të homogjenizuara², me probabilitet përpjesëtimor me madhësinë e zonës së Censusit. Në hapin e dytë, brenda secilës prej zonave të zgjedhura në hapin e parë, zgjidhen sipas metodës së zgjedhjes sistematike me probabilitet të barabartë një numër fiks prej 12 NJEF. Zgjedhja në të dyja hapat është bërë në mënyrë të rastësishme duke siguruar një përfaqësim edhe në nivel qarku. Totali i NJEF të kampionuara u nda në 4 nën-kampione tre-mujore të cilët u shpërndanë gjeografikisht në mënyrë homogjene gjatë gjithë vitit, për të bërë të mundur pasqyrimin e ndryshimeve stinore. Si rrjedhim, janë anketuar çdo muaj rreth 776 NJEF të shpërndara njëtrajtësisht.

Përkufizime

Shpenzimet për konsum të NJEF përfshijnë çdo lloj blerjeje produktesh dhe shërbimesh për të plotësuar nevojat individuale të NJEF me përjashtim të blerjeve për pajisje afatgjatë, investimeve kapitale, parave për të tretët dhe qirasë së imputuar.

Grupet kryesore të konsumit janë përcaktuar sipas Klasifikimit të Konsumit Individual sipas Qëllimit 2012.

Periodha e referencës është kohëzgjatja së cilës i referohet një çështje e caktuar informacioni. Anketa përdor periudha të ndryshme reference në varësi të tipit të informacionit që duhet marrë dhe objektivave të secilës çështje për t'u analizuar.

Njësi ekonomike familjare (NJEF) i referohet një personi ose grupi personash me lidhje gjaku ose jo, të cilët banojnë së bashku në një banesë dhe ndajnë një ekonomi pjesërisht ose plotësisht të përbashkët.

Kryefamiljari është një person, që përcaktohet si i tillë për qëllimet e anketës (person që është pronar i banesës) ose person i identifikuar si i tillë nga anëtarët e tjerë të NJEF. Nëse anëtarët e NJEF nuk e përcaktojnë vetë këtë person, do të jetë personi që kontribuon më shumë në të ardhurat totale të NJEF.

Fëmijë është konsideruar çdo individ nën moshën 18 vjeç.

¹ Periudha e kryerjes në terren ishte: tetor 2006 - shtator 2007 dhe nëntor 2008 - tetor 2009.

² Homogjene nënkupton që çdo zonë Censusi ka të njëjtat karakteristika në shpenzimet e konsumit midis NJEF dhe madhësia për secilën PSU ka përafërsisht të njëjtin numër NJEF apo individësh.

Tab. 1
Struktura e shpenzimeve mesatare mujore dhe vjetore
për konsum të NjEF, 2017

Grupet kryesore të konsumit	Shpenzimet mesatare mujore dhe vjetore për konsum		
	Vlerë (Lekë/në muaj)	Vlerë (Lekë/në vit)	%
Ushqim dhe pije jo-alkoolike	32.347	388.166	44,1
Pije alkoolike dhe duhan	2.558	30.700	3,5
Veshje dhe këpucë	3.128	37.535	4,3
Shpenzime për banesë, ujë, energji elektrike dhe qira të paguar	7.998	95.978	10,9
Mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje e zakonshme e banesës	3.505	42.055	4,8
Shëndet	2.879	34.552	3,9
Transport	5.294	63.529	7,2
Komunikim	2.479	29.749	3,4
Argëtim dhe kulturë	2.224	26.689	3,0
Arsim	2.868	34.419	3,9
Restorante dhe hotele	3.638	43.658	5,0
Të tjera mallra dhe shërbime	4.480	53.765	6,1
Shpenzimet mesatare gjithsej	73.400	880.794	100,0

Tab. 2
Struktura e shpenzimeve për konsum sipas tipologjisë
së NjEF, 2017

Grupet kryesore të konsumit	Tipologjia e NjEF						Gjithsej
	Person i vetëm	Person i vetëm me fëmijë në varësi	Dy të rritur pa fëmijë	Dy të rritur me fëmijë	Tri ose më shumë të rritur pa fëmijë	Tri ose më shumë të rritur me fëmijë	
Ushqim dhe pije jo-alkoolike	45,0	47,1	46,1	45,8	41,4	44,4	44,1
Pije alkoolike dhe duhan	2,9	1,3	3,6	3,3	3,6	3,5	3,5
Veshje dhe këpucë	3,1	5,5	3,5	4,7	4,5	4,3	4,3
Shpenzime për banesë, ujë, energji elektrike dhe qira të paguar	14,0	14,9	11,7	11,6	10,6	9,9	10,9
Mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje e zakonshme e banesës	5,5	5,1	5,2	4,8	4,6	4,6	4,8
Shëndet	4,8	2,3	5,5	2,4	3,9	3,9	3,9
Transport	4,4	3,5	5,5	7,3	7,5	8,2	7,2
Komunikim	3,8	3,2	3,4	3,2	3,6	3,2	3,4
Argëtim dhe kulturë	3,1	5,7	2,8	3,7	3,2	2,6	3,0
Arsim	0,4	0,8	2,9	1,7	6,3	3,9	3,9
Restorante dhe hotele	7,6	3,4	4,5	4,6	5,0	5,1	5,0
Të tjera mallra dhe shërbime	5,4	7,2	5,3	7,0	5,7	6,4	6,1
Shpenzimet mesatare gjithsej	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0

Tab. 3
Struktura e shpenzimeve për konsum sipas madhësisë së NjEF, 2017

Grupet kryesore të konsumit	Madhësia e NjEF							Gjithsej
	NjEF me 1 person	NjEF me 2 persona	NjEF me 3 persona	NjEF me 4 persona	NjEF me 5 persona	NjEF me 6 persona	NjEF me 7+ persona	
Ushqim dhe pije jo-alkoolike	45,0	46,0	43,0	43,3	44,0	43,9	45,9	44,1
Pije alkoolike dhe duhan	2,9	3,6	3,6	3,3	3,3	3,8	4,1	3,5
Veshje dhe këpucë	3,1	3,6	4,5	4,6	4,3	4,3	4,4	4,3
Shpenzime për banesë, ujë, energji elektrike dhe qira të paguar	14,0	11,8	11,9	10,2	10,2	10,1	10,2	10,9
Mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje e zakonshme e banesës	5,5	5,2	4,7	4,7	4,7	4,5	4,5	4,8
Shëndet	4,8	5,4	3,8	3,0	3,6	4,2	4,4	3,9
Transport	4,4	5,4	7,1	7,5	7,9	8,8	8,3	7,2
Komunikim	3,8	3,4	3,6	3,5	3,1	3,0	3,2	3,4
Argëtim dhe kulturë	3,1	2,9	3,6	3,2	2,9	2,5	2,0	3,0
Arsim	0,4	2,9	3,3	4,8	5,1	3,8	3,1	3,9
Restorante dhe hotele	7,6	4,5	4,8	5,6	4,8	4,3	3,7	5,0
Të tjera mallra dhe shërbime	5,4	5,3	6,1	6,3	6,2	6,7	6,2	6,1
Shpenzimet mesatare gjithsej	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0

INDEKSI I ÇMIMEVE TË KONSUMIT



I Hyrje

Ky kapitull paraqet informacion mbi Indeksin e Çmimeve të Konsumit (IÇK), i cili mat ndryshimin në kohë të çmimeve të konsumit të një shporte fikse mallrash e shërbimesh, të paguara nga familjet. Indeksi i Çmimeve të Konsumit përdoret si matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri. Indeksi është vetëm matësi i ndryshimit të nivelit të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve për konsum personal. Matja e ndryshimit real të nivelit dhe strukturës së konsumit personal realizohet nëpërmjet vrojtimeve speciale pranë familjeve.

I Gjetje

I Indekset –ndryshimet në kohë

Ndryshimi mesatar vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit në vitin 2017 është 2,0 %. Rritja më e madhe vjetore vërehet në grupin “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 3,9 %, ndërsa ulja më e madhe vërehet në grupin “Veshje dhe këpucë” me 1,1 %. Duke analizuar treguesin për periudhën 2013-2017 vërehet se çmimet e mallrave dhe shërbimeve për të gjithë shportën janë rritur me 7,0 %. Rritja më e madhe është në grupin “Shërbimi arsimor” me 17,5 %, pasuar nga grupet “Pije alkoolike dhe duhan” me 16,1 %, “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 14,3 %, “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 9,6 % etj. Nga ana tjetër, ulja më e madhe e çmimeve vihet re

në grupin “Shëndeti” me 7,1 %, pasuar nga grupet “Veshje dhe këpucë” me 5,6 %, “Transporti” me 2,2 %, etj.

I Burimet e Informacionit

Çmimet me pakicë mbledhen nga anketuesit nëpërmjet intervistës direkt në 11 qarqe (qytete) të Shqipërisë (Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Vlorë, Korçë, Shkodër, Berat, Lezhë, Dibër dhe Gjirokastrë), të përzgjedhura në bazë të madhësisë së popullsisë.

I Përkufizime

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve ndërmjet muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korrente në nivelin e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj.

Ndryshimi mujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korrent me muajin e mëparshëm. Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet stinore.

Ndryshimi mesatar 12 mujor mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.

Tab. 1

Indekset mesatare të çmimeve të konsumit sipas grupeve kryesore

Dhjetor 2015=100

COICOP	2013	2014	2015	2016	2017
000000 Gjithsej	96,6	98,2	100,0	101,3	103,3
01. Ushqime dhe pije joalkoolike	93,8	95,9	100,1	103,3	107,3
02. Pije alkoolike dhe duhan	87,5	93,6	99,1	100,9	101,6
03. Veshje dhe këpucë	103,8	101,9	100,2	99,1	98,0
04. Qira, ujë lëndë djegëse dhe energji	99,8	101,1	100,6	100,6	101,6
05. Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	100,2	99,6	99,5	100,2	99,8
06. Shëndeti	107,8	103,0	101,1	100,1	100,1
07. Transport	102,3	103,1	101,0	98,1	100,0
08. Komunikimi	99,5	99,1	100,6	100,2	100,5
09. Argëtim dhe kulturë	98,8	98,9	99,6	100,9	102,4
10. Shërbimi arsimor	85,9	88,8	96,7	100,2	100,9
11. Hotele, kafene dhe restorante	96,5	98,6	99,4	100,0	100,2
12. Mallra dhe shërbime të ndryshme	94,3	100,6	100,2	101,2	103,4

Fig. 1
Ndryshimet mujore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit, Janar 2015-Dhjetor 2017





Fig. 2
Ndryshimet mesatare vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit



Tab. 2

Indekset mesatare të çmimeve të konsumit sipas grupeve dhe nëngrupeve kryesore

Viti i mëparshëm = 100

Kodi	Grupet	2013	2014	2015	2016	2017
000000	Gjithsej	101,9	101,6	101,9	101,3	103,3
01.	Ushqime dhe pije joalkoolike	104,2	102,2	104,3	103,3	107,3
01.1.	Ushqime	104,3	102,4	104,5	103,5	107,7
01.1.1.	Bukë dhe drithra	101,0	98,8	99,9	100,5	100,6
01.1.2.	Mish	101,0	100,1	100,1	99,6	100,2
01.1.3.	Peshk	101,4	100,0	101,1	101,3	105,8
01.1.4.	Qumësht, djathë dhe vezë	100,9	100,6	98,5	101,4	104,7
01.1.5.	Vajra dhe yndyra	99,8	94,2	98,9	100,1	97,8
01.1.6.	Fruta	111,7	110,9	115,0	116,0	129,1
01.1.7.	Zarzavate përfshirë patate	121,3	112,4	117,0	110,1	122,7
01.1.8.	Sheqer, reçel, mjaltë, shurup, çokollata dhe ëmbëlsira	95,5	96,3	100,8	102,5	105,1
01.1.9.	Ushqime të tjera	100,1	98,8	102,6	101,1	102,5
01.2.	Pije joalkoolike	102,5	98,2	100,0	99,8	100,2
01.2.1.	Kafe, çaj dhe kakao	107,2	97,5	98,6	100,3	101,6
01.2.2.	Ujë mineral, pije të buta dhe lëngje	99,9	98,6	100,9	99,5	99,4
02.	Pije alkoolike dhe duhan	103,5	107,0	105,8	100,9	101,6
02.1.	Pije alkoolike	101,2	100,6	103,1	101,5	102,5
02.2.	Duhan	105,3	111,9	107,8	100,1	100,4
03.	Veshje dhe këpucë	96,3	98,1	98,3	99,1	98,0
03.1.	Veshje	96,1	97,8	97,4	98,8	98,1
03.1.2.1	Veshje për burra	92,7	96,5	96,4	97,7	97,9
03.1.2.2.	Veshje për gra	95,8	95,0	95,7	99,0	96,5
03.1.2.3.	Veshje për fëmijë	99,5	101,5	98,4	99,6	98,2
03.2.	Këpucë	97,1	99,0	100,7	99,9	97,8
03.2.1.1.	Këpucë për burra	95,5	96,7	100,8	99,9	97,0
03.2.1.2.	Këpucë për gra	96,0	100,4	101,1	99,5	99,0
03.2.1.3.	Këpucë për fëmijë	99,4	101,6	100,5	100,0	97,0
04.	Qira, ujë lëndë djegëse dhe energji	100,3	101,3	99,5	100,6	101,6
04.1	Qira	99,1	100,1	99,3	99,9	100,7
04.3	Mirëmbajtje	101,3	102,4	100,4	99,7	99,8
04.4	Furnizim me ujë	104,2	100,8	100,1	100,0	100,0
04.5	Lëndë djegëse dhe energji	99,9	100,1	98,9	102,3	104,2
05.	Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	100,6	99,4	99,9	100,2	99,8
05.1.	Mobilje dekora, tapete dhe mbulesa dyshem dhe riparim	99,9	98,3	98,9	100,2	99,4
05.1.1.	Mobilje dhe mobilime	99,8	98,1	98,8	100,2	99,4
05.1.2.	Tapete dhe mbulesa të tjera dyshemeje	100,6	100,7	99,6	100,0	99,2
05.2	Tekstile shtëpie	99,3	102,0	101,8	100,3	98,1
05.3	Pajisje shtëpie	101,5	98,4	99,7	100,0	98,1

(vazhdon më faqen tjetër)

Tab. 2

Indekset mesatare të çmimeve të konsumit sipas grupeve dhe nëngrupeve kryesore

Viti i mëparshëm =100

Kodi	Grupet	2013	2014	2015	2016	2017
05.3.1.2.	Makine larje, tharje rrobash dhe makinë tharëse enësh	103,4	97,5	100,9	99,1	96,3
05.3.1.3.	Pajisje gatimi	100,6	96,2	98,1	100,1	102,5
05.3.1.4.	Ngrohës dhe kondicionerë	101,6	98,5	99,6	100,4	99,6
05.4	Qelqurina, mbulesa tavolinë dhe ene shtëpie	101,0	101,2	101,0	101,0	100,6
05.6.	Mallra dhe shërbime për mirëmbajtje shtëpie	99,8	101,2	100,5	100,2	100,4
06.	Shëndeti	99,6	95,5	98,1	100,1	100,1
06.1	Medikamente dhe produkte të tjera farmaceutike	99,1	94,7	96,8	99,7	99,5
06.2	Shërbime mjeksore, paramjeksore dhe dentare	101,6	101,2	101,3	100,8	103,0
06.3	Shërbime spitalore	100,0	94,0	100,7	101,6	101,7
07.	Transport	100,0	100,8	98,0	98,1	100,0
07.1	Blerje mjeteve transporti	100,5	99,4	99,8	100,0	95,1
07.2	Shërbime ndaj mjeteve personale të transportit	99,5	101,4	96,4	97,3	101,0
07.3	Shërbime transporti	100,3	100,7	99,7	99,8	99,6
08.	Komunikimi	100,5	99,6	101,5	100,2	100,5
08.1.1.	Shërbimi postar	100,0	100,0	100,0	100,0	99,9
09.	Argëtim dhe kulturë	100,6	100,2	100,6	100,9	102,4
09.1.	Pajisje audio-vizuale, fotografike dhe riparimi i tyre	97,4	100,0	101,5	99,4	98,2
09.4	Shërbime argëtimi dhe kulturë	100,1	98,9	97,5	100,7	101,8
09.5.	Gazeta, libra dhe mjete shkollore	101,5	101,6	102,3	100,4	101,8
10.	Shërbimi arsimor	101,5	103,5	108,8	100,2	100,9
11.	Hotele, kafene dhe restorante	102,2	102,1	100,8	100,0	100,2
11.1.	Kafe - restorante(catering)	102,4	102,2	100,6	100,0	100,2
11.2	Shërbime akomodimi	100,8	101,4	102,2	100,0	100,1
12.	Mallra dhe shërbime të ndryshme	99,6	106,7	99,5	101,2	103,4
12.1	Kujdes personal	101,8	101,3	99,0	100,2	100,4

Tab. 3
Ndryshimet mesatare vjetore të çmimeve të konsumit sipas grupeve kryesore

në %

COICOP		2013	2014	2015	2016	2017
000000	Gjithsej	1,9	1,6	1,9	1,3	2,0
01.	Ushqime dhe pije joalkoolike	4,2	2,2	4,4	3,2	3,9
02.	Pije alkoolike dhe duhan	3,5	7,0	5,8	1,8	0,7
03.	Veshje dhe këpucë	-3,7	-1,9	-1,7	-1,1	-1,1
04.	Qira, ujë lëndë djegëse dhe energji	0,3	1,3	-0,5	0,0	1,0
05.	Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	0,6	-0,6	-0,2	0,8	-0,4
06.	Shëndeti	-0,4	-4,5	-1,9	-1,0	0,0
07	Transporti	0,0	0,8	-2,1	-2,8	1,9
08.	Komunikimi	0,5	-0,4	1,5	-0,4	0,3
09.	Argëtim dhe kulturë	0,6	0,2	0,7	1,3	1,5
10.	Shërbimi arsimor	1,5	3,5	8,9	3,6	0,7
11.	Hotele, kafene dhe restorante	2,2	2,1	0,8	0,6	0,1
12.	Mallra dhe shërbime të ndryshme	-0,4	6,7	-0,4	0,9	2,2

REGJISTRI STATISTIKOR I NDËRMARRJEVE



I Hyrje

Ky kapitull jep një informacion mbi Regjistrin Statistikor të Ndërmarrje (RSN); të dhënat përshkruajnë ecurinë e ndërmarrjeve ndër vite, karakteristikat kryesore të tyre dhe degët e ekonomisë ku ato operojnë. Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve është shtylla kryesore e prodhimit të statistikave ekonomike.

INSTAT ka krijuar regjistrin administrativ të ndërmarrjeve në vitin 1994 dhe që prej vitit 1998 mirëmban Regjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve. Në vitin 2010 e në vijim, INSTAT mirëmban edhe Regjistrin e Njësive Lokale. Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve përmban të gjitha njësitë ligjore jo-bujqësore (ndërmarrjet e institucionet) që ushtrojnë aktivitet ekonomik brenda territorit të Shqipërisë. Regjistri është ndërtuar në përputhje me Rregulloren e Këshillit EU (EEC) Nr 177/2008 datë 20 shkurt 2008 mbi "Ndërtimin e regjistrave të ndërmarrjeve për qëllime statistikore".

Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve identifikon qartësisht njësitë në mënyrë që:

- Të lejojë marrjen e informacionit për to nëpërmjet burimeve administrative;
- Të lejojë përgatitjen e kampionëve, koordinimin e anketave dhe grupimin e rezultateve të tyre;
- Të lejojë analizën demografike të popullsisë së ndërmarrjeve dhe njësive lidhur me to.

Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, prej vitit 2015 përmban edhe fermerë të pajisur me numër identifikimi të personit të tatueshëm, NIPT. Kjo ka ardhur si rezultat i regjistrimit të fermerëve pranë Drejtorive Rajonale Tatimore, në zbatim të udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 19 datë 3.11.2014 "Për Zbatimin e Regjimit të veçantë të Skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për Qëllime të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar".

I Gjetje

Numri i ndërmarrjeve aktive në fund të vit 2017 është 162.452, nga të cilat 36.520 janë ferma të pajisura me numër identifikimi NIPT. Gjatë vitit 2017 janë regjistruar 24.924 ndërmarrje aktive, nga të cilat 22,9 % janë persona juridikë. Ndërmarrjet

aktive që e kanë filluar aktivitetin ekonomik para vitit 2011 përbëjnë 26,6 %.

I Aktiviteti ekonomik

Grupi i prodhuesve të shërbimeve vazhdon të jetë mbizotërues në ekonominë shqiptare me 67,2 % të ndërmarrjeve aktive. Aktiviteti ekonomik "Tregtia me pakicë përveç tregtisë së automjeteve dhe motoçikletave" përfaqëson 23,0 % të ndërmarrjeve, ndërsa "Akomodim dhe shërbimi ushqimor" përfaqëson 13,5 %.

Aktiviteti ekonomik "Tregti" është i preferuar edhe në vendimarrje për një aktivitet të ri dhe përfaqëson 25 % të ndërmarrjeve të regjistruara gjatë vitit 2017.

I Madhësia e ndërmarrjeve

Ndërmarrjet e mëdha, me 50 e më shumë të punësuar, zënë vetëm 1,1 %, por kontributi i tyre në punësim llogaritet në 47,8 %. Pjesa tjetër, rreth 90,1 % e ndërmarrjeve aktive, janë ndërmarrje të vogla me 1-4 të punësuar. Pjesa më e madhe e tyre, prej 74,8 %, janë me një të punësuar.

Në grupin e prodhuesve të të mirave ndërmarrjet me 50 e më shumë të punësuar janë të përqendruara në aktivitetin "Industri përpunuese", me 23,0 % të tyre, ndërsa në grupin e shërbimeve numri më i lartë i ndërmarrjeve shënohet në aktivitetin "Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm", me 16,3 % të totalit të ndërmarrjeve me 50 e më shumë të punësuar.

I Ndërmarrjet sipas qarqeve

Në qarqet Tiranë, Fier e Korçë janë përqendruar rreth 54,7 % e ndërmarrjeve aktive. Numri më i madh i ndërmarrjeve shënohet në qarkun e Tiranës me 54.291 ndërmarrje, ndërsa numri më i vogël në qarkun e Kukësit me 1.946 ndërmarrje. Edhe gjatë vitit 2016 qarku i Tiranës ka shënuar numrin më të lartë të ndërmarrjeve aktive, sikurse edhe qarku i Kukësit numrin më të ulët.

Mbizotërimi i grupit të prodhuesve të shërbimeve është dukuri në të gjitha bashkitë, sikurse edhe në të gjitha qarqet. Në bashkitë Tiranë, Durrës dhe Shkodër janë përqendruar 50,8 % e grupit të prodhuesve të shërbimeve.

I Ndërmarrjet e huaja e të përbashkëta

Ndërmarrjet me pronarë apo bashkëpronarë të huaj zënë 3,9 % të ndërmarrjeve aktive, krahasuar me 3,5 % të ndërmarrjeve aktive në vitin 2016 dhe punësojnë 12,5 % të të punësuarve gjithsej. Ndërmarrjet nga vendet e Bashkimit Evropian përfaqësojnë 66,7 % të ndërmarrjeve të huaja e të përbashkëta, prej të cilave pronarët apo bashkëpronarët me origjinë italiane dhe greke përfaqësojnë 54,0 % të ndërmarrjeve të huaja e të përbashkëta gjithsej. Aktivitetet ekonomike si call center dhe tregti me shumicë janë aktivitetet ku kryesisht pronarët/bashkëpronarët janë të huaj. Ndërmarrjet e huaja e të përbashkëta janë përqendruar kryesisht në bashkitë Tiranë dhe Durrës, me 77,9 %.

I Femrat pronare/administratore

Gratë menaxhojnë/zotërojnë 29,7 % të ndërmarrjeve aktive gjithsej, krahasuar me 26,8 % gjatë vitit 2016. Aktiviteti tregtar shënon pjesëmarrjen më të lartë të grave në vendimmarrje, me 39,2 %. Qarku i Tiranës ka edhe përqendrimin më të madh të ndërmarrjeve të drejtuara nga gratë, me 35,6 %. Ndërmarrjet e drejtuara nga gratë janë kryesisht ndërmarrje me 1-4 të punësuar, të cilat zënë 91,6 % të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve të drejtuara nga gratë. Megjithatë, gratë drejtojnë 24,2 % të ndërmarrjeve me 50 e më shumë të punësuar, nga 19,2 % që drejtonin këtë grup gjatë vitit 2016.

I Njësitë lokale

Në fund të vitit 2017 regjistrohen 174.306 njësi lokale, nga të cilat 160.928 ushtrojnë aktivitetin ekonomik në 1 vendndodhje. Ndërmarrjet që ushtrojnë aktivitetin në më shumë se një vendndodhje janë gjithsej 1.524 ndërmarrje, të cilat përfaqësojnë vetëm 1,0 % të ndërmarrjeve aktive gjithsej dhe numri i të punësuarve në to është 26,5 % e numrit të të punësuarve gjithsej. Aktivitetet financiare kanë numrin më të lartë të të punësuarve për ndërmarrjet që kanë më shumë se një vendndodhje.

Njësitë lokale janë përqendruar në bashkitë Tiranë, Durrës dhe Shkodër me 39,5 % të numrit të përgjithshëm të njësive lokale aktive. Zhvillimi ekonomik sipas rajoneve statistikore NUTS Për nga ndarja rajonale, rajoni më i zhvilluar

është rajoni qendër ku përfshihen qarqet Tiranë dhe Elbasan. Këtu janë përqendruar 41,5 % e ndërmarrjeve aktive. Pothuajse e njëjta situatë ndeshet edhe me ndërmarrjet e regjistruara gjatë këtij viti, me 46,2 %. Të punësuarit në këtë rajon zënë 54,4 % të të punësuarve gjithsej. Aktiviteti ekonomik tregtar mbizotëron ndaj aktiviteteve të tjera me 32,8 %. Ky fenomen është i njëjtë si në nivel qarku, ashtu edhe në nivel bashkie.

I Fermerët

Fermerët të cilët shesin produktet e tyre po regjistrohen në zyrat rajonale tatimore duke u pajisur me Numër Identifikimi të Personit të Tatueshëm, (NIPT). Në këtë moment fermerët zotërojnë personalitet juridik, e si të tillë janë objekt i Regjistrat Statistikor të Ndërmarrjeve që INSTAT mirëmban dhe përditëson. Numri i fermerëve të pajisur me NIPT në fund të vitit 2017 është 36.520 nga 31.372 fermerë në fund të vitit 2016.

I Burimi i të dhënave

Regjistrat e njësive ekonomike bazohen në burime administrative nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve si edhe, duke filluar nga viti 2007, nga Qendra Kombëtare e Biznesit, një reformë e rëndësishme kjo për thjeshtësimin e regjistrimit dhe procedurën e regjistrimit të ndërmarrjeve.

Burime administrative:

- Qendra Kombëtare Biznesit;
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- Skedari i TVSH-së;
- Llogaritë vjetore të ndërmarrjeve.

Burime statistikore (vrojtimet pranë ndërmarrjeve):

- Anketa e Regjistrat të Ndërmarrjeve;
- Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve;
- Anketa Tremujore pranë Ndërmarrjeve;
- Anketa e Çmimeve të Prodhimit;
- Anketa të tjera.

I Përkufizime

Njësia ligjore

Njësia ligjore nuk është direkt njësi statistikore.

Njësia ligjore mund të jetë:

- Person juridik, ekzistenca e të cilit njihet nga ligji, pavarësisht nga individët apo institucionet që mund ta zotërojnë apo janë anëtarë në të;
- Person fizik i angazhuar në një aktivitet ekonomik në të drejtën e tij.

Ndërmarrja

Ndërmarrja është "kombinimi më i vogël i njësive ligjore, pra një njësi organizative që prodhon të mira apo shërbime, që ka një farë autonomie në marrjen e vendimeve, veçanërisht për shpërndarjen e burimeve aktuale të saj. Ndërmarrja kryen një ose më shumë aktivitete në një apo më shumë vendndodhje (njësi lokale)". Marrëdhënia mes një ndërmarrjeje dhe një njësie ligjore përkufizohet si "ndërmarrja i korrespondon ose një njësie ligjore, ose një kombinimi njësish ligjore".

Njësia lokale

Njësia lokale është një ndërmarrje apo pjesë e saj (p.sh manifakturë, fabrikë, magazinë, zyrë, minierë apo depo) të ndodhura në zona të identifikuara gjeografikisht. Tek ky apo nga ky vend ushtrohet aktiviteti ekonomik për të cilin – me përjashtim të disa rasteve – punojnë një ose më shumë persona (edhe pse me kohë të reduktuar) për një ndërmarrje të vetme.

Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike (NVE)

është klasifikim në nivel katërshifror i veprimtarive ekonomike të ushtruara në subjekte të ndryshme. Kjo nomenklaturë është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 320, datë 28.5.2014.

Fig. 1
Ndërmarrjet aktive sipas aktivitetit ekonomik, 2017




Fig. 2
Ndërmarrjet aktive për çdo qark sipas gjinisë së drejtuesit, %





Fig. 3
Ndërmarrjet aktive dhe regjistrimet , 2013-2017



Tab. 1
Ndërmarrje aktive sipas karakteristikave
Gjendje në fund të vitit 2013-2017

	2013	2014	2015	2016	2017
Ndërmarrje aktive	111.154	112.537	152.288	160.679	162.452
Regjistrime të reja	12.254	17.377	56.787	31.377	24.924
Njësitë lokale aktive	123.332	124.508	163.661	173.361	174.306
Ndërmarrje aktive me pronare / administratore femër, %	28,0	28,5	31,3	26,8	29,7

Tab. 2
Ndërmarrjet aktive sipas formës ligjore
Gjendje në fund të vitit 2013-2017

Forma ligjore	2013	2014	2015	2016	2017
Gjithsej	111.154	112.537	152.288	160.679	162.452
Fermerë			19.543	31.372	36.520
Person Fizik	84956	85.654	103.414	100.955	98.264
Person Juridik	26.198	26.883	29.331	28.352	27.668
Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	20760	21.153	23.643	22.424	22.208
Shoqëri Anonime	880	874	911	821	801
Ndërmarrje Shtetërore	936	941	935	980	932
Administrata Publike	720	768	498	797	804
OJF, Org. ndërkombëtare	2180	2.378	2.410	2.465	2.272
Shoqëri të tjera	722	769	934	865	651

Tab. 3
Ndërmarrjet aktive sipas pronësisë
 Gjendje në fund të vitit 2013-2017

Pronësia	2013	2014	2015	2016	2017
Gjithsej	111.154	112.537	152.288	160.679	162.452
Shqiptare	106.430	107.291	146.349	155.042	156.157
Të huaja e të përbashkëta	4.724	5.246	5.939	5.637	6.295

Tab. 4
Ndërmarrjet aktive sipas aktivitetit ekonomik
 Gjendje në fund të vitit 2013-2017

Aktiviteti ekonomik	2013	2014	2015	2016	2017
Gjithsej	111.154	112.537	152.288	160.679	162.452
Prodhuësit e të mirave	16.842	16.989	37.950	48.585	53.250
Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	1.690	2.260	21.194	32659	37684
Industria	10.333	10.154	11.810	11302	11066
Ndërtimi	4.819	4.575	4.946	4624	4500
Prodhuësit e shërbimeve	94.312	95.548	114.338	112.094	109.202
Tregtia	44.878	44.969	53.699	51245	48873
Transporti dhe magazinimi	8.024	7.562	7.008	6548	5928
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	17.825	18.061	23.186	22785	21909
Informacioni dhe komunikacioni	2.495	2.590	2.453	2530	2927
Shërbime të tjera	21.090	22.366	27.992	28986	29565

Tab. 5
Ndërmarrjet aktive sipas qarqeve
 Gjendje në fund të vitit 2013-2017

Qarqet	2013		2014		2015		2016		2017	
	Nd.aktive	Pronare / administratore femër	Nd.aktive	Pronare / administratore femër	Nd.aktive	Pronare / administratore femër	Nd.aktive	Pronare / administratore femër	Nd.aktive	Pronare / administratore femër
Gjithsej	111.154	30.835	112.537	32.023	152.288	47.706	160.679	43.003	162.452	48.193
Berat	4.557	1.270	4.302	1.229	7.205	2.186	8.300	1.638	8.763	1.992
Dibër	2.077	376	2.164	404	2.850	736	2.935	705	2.906	791
Durrës	10.601	2.816	9.578	2.640	13.125	3.930	13.310	3.787	12.963	4.216
Elbasan	7.442	1.858	7.859	2.016	11.493	3.367	13.301	3.297	13.201	3.823
Fier	9.830	2.615	9.693	2.576	19.199	6.106	20.497	4.174	20.818	4.767
Gjirokastrë	2.815	655	2.681	644	3.661	1.089	4.600	1.120	4.847	1.294
Korçë	6.728	1.742	7.311	1.965	11.609	3.287	14.032	2.613	13.814	3.010
Kukës	1.062	160	1.068	167	1.543	337	1.780	316	1.946	466
Lezhë	3.189	796	3.388	970	4.902	1.581	5.550	1.666	5.354	1.697
Shkodër	5.947	1.565	5.446	1.508	10.299	3.012	11.349	2.725	11.603	3.085
Tiranë	47.542	14.463	49.467	15.197	54.237	18.141	53.405	17.498	54.291	19.306
Vlorë	9.364	2.519	9.580	2.707	12.165	3.934	11.620	3.464	11.946	3.746

Tab. 6
Ndërmarrjet aktive sipas madhësisë
 Gjendje në fund të vitit 2013-2017

Madhësia sipas numrit të të punësuarve	2013	2014	2015	2016	2017
Gjithsej	111.154	112.537	152.288	160.679	162.452
1-4	99.819	101.025	136.470	145.456	146.304
5-9	5.259	5.387	8.172	7.631	8.023
10-49	4.669	4.647	5.994	5.902	6.297
50+	1.407	1.478	1.652	1.690	1.828
Prodhuesit e të mirave	16.842	16.989	37.950	48.585	53.250
1-4	13.071	13.273	33.255	44.179	48.819
5-9	1.565	1.603	2.080	1.865	1.842
10-49	1.681	1.562	1.971	1.877	1.851
50+	525	551	644	664	738
Prodhuesit e shërbimeve	94.312	95.548	114.338	112.094	109.202
1-4	86.748	87.752	103.215	101.277	97.485
5-9	3.694	3.784	6.092	5.766	6.181
10-49	2.988	3.085	4.023	4.025	4.446
50+	882	927	1.008	1.026	1.090

TREGTIA E JASHTME



I Hyrje


Ky kapitull paraqet informacion mbi shkëmbimin e mallrave ndërmjet Shqipërisë dhe shteteve të tjera të botës. Statistikat e tregtisë së jashtme të mallrave janë një instrument shumë i rëndësishëm për vendimmarrësit në sektorët publikë dhe privatë. Ato ndihmojnë në përgatitjen e bisedimeve bilaterale dhe multilaterale në kuadrin e politikave tregtare dhe për vlerësimin e ekonomive të tregut. Ato ndihmojnë gjithashtu kompanitë në studimin e tregut dhe përcaktimin e strategjive të tyre tregtare.

Statistikat mbi tregtinë e mallrave përmbajnë të dhëna mbi tregtinë e jashtme të mallrave, eksportet-importet e mallrave në Shqipëri.

Për këtë arsye, statistikat e tregtisë së mallrave përpilojnë eksportet (FOB) dhe importet (CIF) dhe disa statistika të tjera në mënyrë më të detajuar, si për shembull eksport/import sipas vendeve partnere, grupvendeve, grupmallrave, etj.

Gjatë periudhës 5-vjeçare (2013-2017) vihet re një rritje mesatare vjetore me 5,0 % për eksportet dhe 2,8 % për importet. Gjatë kësaj periudhe, deficitin tregtar është rritur mesatarisht me 6,9 % në vit.

Fig. 1
Tregtia e jashtme e mallrave 2013-2017



I Tregtia e jashtme sipas produkteve

Produktet që zënë një pjesë të konsiderueshme në eksportet shqiptare, për periudhën 5-vjeçare, janë eksportet e mallrave të përpunuara. Grupet e produkteve më të eksportuara për vitin 2017 janë: "Mallra të përpunuara" me 66,3 %, duke u rritur 10,5 % mesatarisht në vit gjatë periudhës 2013-2017; "Ushqime, pije dhe duhan" me 9,0 %, duke u rritur 26,0 % në vit gjatë periudhës 2013-2017; "Lëndët djegëse" me 8,8 %, duke u ulur 24,4 % mesatarisht në vit gjatë periudhës 2013-2017; dhe "Materiale të papërpunuara" me 8,5 % të eksporteve, duke u ulur 3,2 % mesatarisht në vit gjatë periudhës 2013-2017.

Grup produktet që dominojnë importin për periudhën 2013-2017 janë: "Mallra të përpunuara" me 37,6 %, duke u rritur 8,7 % mesatarisht në vit gjatë periudhës 2013-2017; "Makinëri dhe pajisje transporti" me 21,0 %, duke u rritur 8,5 % mesatarisht në vit gjatë periudhës 2013-2017; dhe "Ushqime, pije dhe duhan" me 12,5 %, duke u rritur 4,0 % mesatarisht në vit gjatë periudhës 2013-2017.

Fig. 2
Eksportet sipas grup-mallrave kryesore





Fig. 3
Importet sipas grup-mallrave kryesore



I Tregtia e jashtme sipas vendeve partnere

Gjatë periudhës 2013-2017, eksportet në vlerë kanë shënuar rritje të konsiderueshme drejt Italisë, Kosovës dhe Greqisë. Në krahasim me pesë vite më parë, harta e eksporteve shqiptare duket se është diversifikuar ndjeshëm.

Në vitin 2017, partneri me peshën më të madhe në eksportet me Shqipërinë është Italia e cila zë 53,5 %, duke u rritur 6,7 % mesatarisht në vit gjatë periudhës 2013-2017. Partneri i dytë tregtar në eksporte është Kosova e cila zë 7,7 % eksporteve, duke u rritur 8,0 % mesatarisht në vit gjatë periudhës 2013-2017. Partneri i tretë tregtar në eksporte është Spanja e cila zë 5,5 % të eksporteve, duke u ulur 1,1 % mesatarisht në vit gjatë periudhës 2013-2017. Partneri i katërt tregtar për nga pesha e eksporteve është Greqia e cila zë 4,3 % të eksporteve, duke u rritur 10,6 % mesatarisht në vit gjatë periudhës 2013-2017. Më tej, në strukturën e eksporteve për nga pesha, në vitin 2017, vijojnë Gjermania me 4,0 %, Maqedonia dhe Kina me 3,1 %, Mali i Zi dhe Serbia me 1,8 %, etj.

Importet janë rritur nga Italia, Kina, Turqia, Greqia dhe Gjermania, gjatë harku kohor 2013-2017.

Në vitin 2017, partneri që zë peshën më të madhe në importe është Italia me 28,6 % të importeve, duke u rritur 1,3 % mesatarisht në vit gjatë periudhës 2013-2017; Partneri i dytë tregtar në importe është Turqia e cila zë 8,1 % të importeve, duke u rritur 11,6 % mesatarisht në vit gjatë periudhës 2013-2017; Partneri i tretë tregtar në importe është Gjermania e cila zë 8,1 % të importeve, duke u rritur 15,9 % mesatarisht në vit gjatë periudhës 2013-2017; Partneri i katërt tregtar për nga pesha e importeve është Greqia e cila zë 8,0 % të importeve, duke u rritur 3,0 % mesatarisht në vit gjatë periudhës 2013-2017. Më pas vijnë Kina me 7,9 %, Serbia me 4,0 %, Spanja me 2,2 %, Zvicra me 2,1 %, Rusia me 1,9 %, etj.

Në vitin 2017, eksportet me vendet e BE zënë 77,1 % të eksporteve, duke u rritur 3,0 % mesatarisht në vit gjatë periudhës 2013-2017, ndërsa eksportet me vendet e Eurozonës zënë 72,2 % të eksporteve, duke u rritur 2,1 % mesatarisht në vit, gjatë kësaj periudhe.

Fig. 4
Partnerët kryesorë në eksporte





Fig. 5
Partnerët kryesorë në importe



Në vitin 2017, importet nga vendet e BE zënë 61,6 % të importeve, duke u rritur 3,8 % mesatarisht në vit gjatë periudhës 2013-2017, ndërsa importet nga vendet e Eurozonës zënë 54,5 % të importeve, duke u rritur me 3,7 % mesatarisht në vit, gjatë kësaj periudhe.

Transporti ndërkombëtar i mallrave me rrugë detare është lloji më i përdorur i transportit për eksportet/importet e mallrave gjatë periudhës 2013-2017. Në këtë periudhë, mesatarisht në vit janë transportuar me det 69,2 % dhe me rrugë 28,8 % e vlerës së mallrave të eksportuara gjithsej. Ndërkaq, për importin mesatarisht në vit janë transportuar me det 52,3 % dhe me rrugë 39,8 % e vlerës së mallrave të importuara gjithsej.

Tab. 1
Tregtia e jashtme e mallrave 2013-2017
(në milion lekë)

Viti	Eksporte	Importe	Bilanci tregtar	Volumi Tregtar	% of coverage
2013	246.397	517.378	-270.980	763.775	48
2014	255.759	552.281	-296.522	808.040	46
2015	243.183	544.616	-301.433	787.799	45
2016	243.498	579.248	-335.750	822.745	42
2017	272.988	626.186	-353.198	899.174	44

Tab. 2

Tregtia e jashtme e mallrave sipas Klasifikimit Standart të
Tregtisë së Jashtme (SITC Rev.4), 2013-2017
(në milion lekë)

		2013	2014	2015	2016	2017
	Eksporte					
	Gjithsej	246.397	255.759	243.183	243.498	272.988
0	Ushqime dhe kafshë të gjalla	9.752	11.831	15.599	19.167	24.488
1	Pije dhe duhan	1.226	1.187	1.031	1.598	1.485
2	Materiale të papërpunuara	26.583	22.897	22.102	23.289	23.141
3	Lëndë djegëse	76.366	64.569	45.090	27.397	23.902
4	Yndyrna bimore dhe shtazore	221	91	117	225	243
5	Produkte kimike	1.854	2.371	2.872	3.060	3.382
6	Mallra të përpunuara	47.137	52.409	49.657	44.276	57.828
7	Makineri e pajisje transporti	8.225	9.203	10.794	11.255	15.118
8	Mallra të tjera të përpunuara	74.828	90.713	95.751	112.660	123.156
9	Mallra të paklasifikuara diku tjetër	204	489	169	571	243
	Importe					
	Gjithsej	517.378	552.281	544.616	579.248	626.186
0	Ushqime dhe kafshë të gjalla	66.829	70.111	72.759	73.616	78.268
1	Pije dhe duhan	19.110	15.996	16.080	18.343	20.272
2	Materiale të papërpunuara	13.065	20.680	13.954	12.180	18.926
3	Lëndë djegëse	88.504	85.538	56.641	46.945	61.711
4	Yndyrna bimore dhe shtazore	5.293	5.723	5.807	5.562	5.202
5	Produkte kimike	59.825	63.657	64.471	68.618	74.302
6	Mallra të përpunuara	111.527	120.169	126.422	144.207	146.820
7	Makineri e pajisje transporti	95.240	103.089	114.034	126.677	131.630
8	Mallra të tjera të përpunuara	57.720	67.025	74.268	82.390	88.874
9	Mallra të paklasifikuara diku tjetër	266	293	180	710	181
	Bilanci tregtar					
	Gjithsej	-270.981	-296.522	-301.433	-335.751	-353.198
0	Ushqime dhe kafshë të gjalla	-57.077	-58.280	-57.160	-54.449	-53.779
1	Pije dhe duhan	-17.883	-14.809	-15.049	-16.745	-18.787
2	Materiale të papërpunuara	13.518	2.216	8.148	11.109	4.214
3	Lëndë djegëse	-12.138	-20.969	-11.550	-19.548	-37.808
4	Yndyrna bimore dhe shtazore	-5.072	-5.632	-5.690	-5.337	-4.959
5	Produkte kimike	-57.971	-61.286	-61.599	-65.557	-70.920
6	Mallra të përpunuara	-64.390	-67.760	-76.765	-99.931	-88.992
7	Makineri e pajisje transporti	-87.016	-93.887	-103.239	-115.422	-116.512
8	Mallra të tjera të përpunuara	17.109	23.688	21.483	30.270	34.282
9	Mallra të paklasifikuara diku tjetër	-62	196	-11	-139	62

Tab. 3
Eksportet sipas vendeve partnere
 (në milion lekë), 2013-2017

	2013	2014	2015	2016	2017
Vendet e BE	189.044	198.060	183.021	189.704	210.575
Austria	1.253	1.962	2.976	1.188	1.837
Belgjike	193	404	309	339	602
Bullgaria	2.321	2.751	3.159	2.953	3.059
Cekia	951	796	832	1.457	2.329
Danimarka	363	138	436	857	401
Estonia	2	11	12	437	688
Finlanda	3	16	26	13	32
Franca	5.246	2.757	2.410	2.562	2.913
Gjermania	9.461	7.209	7.568	8.282	10.861
Greqia	7.776	8.848	9.511	11.150	11.602
Hollanda	1.699	2.287	2.058	1.328	1.278
Hungaria	125	233	1.871	2.414	3.014
Irlanda	5	12	7	23	38
Italia	114.160	133.046	123.703	132.890	146.040
Kroacia	380	342	488	943	839
Letoni	54	22	48	71	64
Lithuania	28	11	79	77	129
Luxembourg	420	339	14	9	112
Malta	16.540	15.906	11.209	8.016	470
Mbretëria e Bashkuar	1.450	442	454	533	480
Polonia	124	886	448	399	840
Portugalia	30	10	23	61	27
Qipro	12	1.155	13	29	9
Rumania	393	880	1.337	3.435	4.726
Slovakia	114	632	157	324	296
Slovenia	1.769	164	1.147	1.370	377
Spanja	24.088	16.684	12.607	7.994	14.992
Suedia	84	119	119	552	2.519
Zona Euro	183.233	191.200	175.201	179.568	197.084
Kina	11.455	8.738	6.570	7.452	8.399
Kosova	16.292	18.774	20.921	16.605	20.924
Mali i Zi	3.173	3.520	3.375	4.377	5.017
Maqedonia	4.397	5.301	6.414	6.421	8.431
Serbia	2.247	1.608	3.204	4.700	4.833
Shtetet e Bashkuara	1.129	1.463	2.144	1.604	3.444
Turqia	9.223	10.094	6.943	2.803	2.132
Zvicer	4.361	1.937	2.406	2.574	1.339
Të tjera	5.078	6.264	8.184	7.257	7.894
Gjithsej	246.397	255.759	243.183	243.498	272.988

Tab. 4
Importet sipas vendeve partnere
 (në milion lekë), 2013-2017

	2013	2014	2015	2016	2017
Vendet e BE	332.877	337.441	336.052	365.926	385.673
Austria	6.185	6.408	7.308	6.376	7.708
Belgjike	2.396	2.403	2.921	3.282	3.491
Bullgaria	8.601	7.790	7.478	7.684	9.016
Cekia	4.112	3.513	3.925	5.559	5.528
Danimarka	509	1.078	1.293	1.004	2.812
Estonia	50	58	26	384	60
Finlanda	1.693	1.389	1.974	1.353	1.737
Franca	15.528	10.690	12.055	11.481	10.973
Gjermania	30.002	32.963	36.349	54.959	50.713
Greqia	45.700	52.058	42.718	45.657	49.879
Hollanda	3.380	4.272	3.591	4.570	4.702
Hungaria	4.322	4.475	4.824	4.933	5.185
Irlanda	1.542	1.980	1.981	1.979	2.579
Italia	170.445	164.419	165.001	169.583	179.236
Kroacia	5.818	6.144	7.451	4.402	4.434
Letoni	72	133	177	146	186
Lithuania	251	346	290	362	526
Luxembourg	49	32	312	63	163
Malta	336	283	27	6	15
Mbretëria e Bashkuar	4.154	5.500	5.035	4.159	5.540
Polonia	7.803	7.987	8.311	9.038	10.023
Portugalia	579	748	1.149	1.372	1.644
Qipro	234	303	187	345	228
Rumania	4.860	6.082	6.084	7.024	7.574
Slovakia	1.293	1.817	1.474	1.645	1.828
Slovenia	3.718	3.455	3.657	3.745	4.724
Spanja	8.026	9.588	8.715	12.676	13.466
Suedia	1.220	1.528	1.738	2.141	1.702
Zona Euro	296.104	299.123	295.810	326.661	341.203
Bosnia dhe Herzegovina	3.266	3.354	3.231	3.626	3.377
Kina	34.985	40.335	46.567	50.814	49.489
Kosova	6.014	5.976	5.483	5.819	8.443
Mali i Zi	1.837	2.311	3.067	2.711	3.730
Maqedonia	8.606	8.350	8.578	7.765	8.755
Rusia	10.140	11.680	12.027	10.891	11.779
Serbia	15.201	23.664	20.751	18.069	24.997
Shtetet e Bashkuara	12.444	13.343	8.633	10.861	8.955
Turqia	32.889	39.011	43.726	45.654	50.780
Zvicër	8.179	16.858	8.264	6.821	13.068
Të tjera	50.940	49.958	48.237	50.291	57.139
Gjithsej	517.378	552.281	544.616	579.248	626.186

Tab.5

Tregtia e mallrave sipas partnerëve kryesorë tregtarë (në milion lekë), 2013-2017

(në milion lekë), 2013-2017

	2013	2014	2015	2016	2017
Eksporte	246.397	255.759	243.183	243.498	272.988
Gjermania	9.461	7.209	7.568	8.282	10.861
Greqia	7.776	8.848	9.511	11.150	11.602
Italia	114.160	133.046	123.703	132.890	146.040
Kina	11.455	8.738	6.570	7.452	8.399
Kosova	16.292	18.774	20.921	16.605	20.924
Malta	16.540	15.906	11.209	8.016	470
Serbia	2.247	1.608	3.204	4.700	4.833
Spanja	24.088	16.684	12.607	7.994	14.992
Turqia	9.223	10.094	6.943	2.803	2.132
Zvicer	4.361	1.937	2.406	2.574	1.339
Importe	517.378	552.281	544.616	579.248	626.186
Gjermania	30.002	32.964	36.349	54.959	50.713
Greqia	45.700	52.058	42.718	45.657	49.879
Italia	170.445	164.419	165.001	169.583	179.233
Kina	34.985	40.335	46.567	50.814	49.489
Kosova	6.014	5.976	5.483	5.819	8.443
Malta	336	283	27	6	15
Serbia	15.201	23.664	20.751	18.069	24.997
Spanja	8.026	9.588	8.715	12.676	13.466
Turqia	32.889	39.011	43.726	45.654	50.780
Zvicer	8.179	16.858	8.264	6.821	13.068
Bilanci tregtar	-270.981	-296.522	-301.433	-335.751	-353.198
Gjermania	-20.541	-25.755	-28.781	-46.677	-39.851
Greqia	-37.924	-43.210	-33.207	-34.506	-38.277
Italia	-56.286	-31.373	-41.298	-36.692	-33.193
Kina	-23.531	-31.598	-39.997	-43.362	-41.091
Kosova	10.278	12.798	15.438	10.786	12.480
Malta	16.204	15.623	11.182	8.010	455
Serbia	-12.954	-22.056	-17.547	-13.368	-20.164
Spanja	16.062	7.097	3.892	-4.681	1.526
Turqia	-23.666	-28.917	-36.783	-42.851	-48.648
Zvicer	-3.819	-14.921	-5.858	-4.247	-11.729

Tab. 6
Eksportet sipas mënyrës së transportit
 (në milion lekë), 2013-2017

	2013	2014	2015	2016	2017
Gjithsej	246.397	255.759	243.183	243.498	272.988
Transporti detar	189.266	188.788	164.305	158.226	171.468
Transporti rrugor	50.872	64.564	73.443	78.413	97.800
Transporti ajror	2.101	1.633	1.095	1.474	1.300
Mënyra të tjera transporti	4.158	774	4.339	5.385	2.419

Tab. 7
Importet sipas mënyrës së transportit
 (në milion lekë), 2013-2017

	2013	2014	2015	2016	2017
Gjithsej	517.378	552.281	544.616	579.248	626.186
Transporti detar	289.369	293.381	280.965	301.741	304.258
Transporti rrugor	184.888	203.824	220.317	244.187	274.506
Transporti ajror	21.358	19.238	20.916	19.953	17.868
Mënyra të tjera transporti	21.762	35.838	22.419	13.367	29.554

BUJQËSIA



I Hyrje

Sektori i bujqësisë është një ndër sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare. Produktet bujqësore janë pjesë e formimit të indentitetit rajonal të vendit, me një gamë të gjerë të ndryshimeve mjedisore, natyrore dhe klimatike. Informacioni statistikor, për degën e bujqësisë, i referohet të dhënave administrative të grumbulluara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoritë e Bujqësisë, në nivel qarku, si dhe vlerësimet e ekspertëve. Baza ligjore për grumbullimin e statistikave të prodhimit bimor është Programi i Statistikave Zyrtare 2017-2021. Drithërat kryesore të kultivuara në vendin tonë janë gruri, misri, elbi, thekra dhe tagjirat. Peshë të konsiderueshme në prodhimin e bimëve të arave zënë gjithashtu perimet, patatet dhe fasulet. Grupet kryesore të drufrutorëve të kultivuara në vendin tonë janë pemët frutore (molla, dardha, pjeshka, kumbulla, qershia, aroret, etj.), ulliri, agrumet dhe rrushi.

I Gjetjet kryesore

Në vitin 2017 u prodhuan 1.151.928 ton perime, me një rritje prej 2,02 %, krahasuar me një vit më parë. Niveli më i lartë i prodhimit të perimeve në Shqipëri arrihet në qarkun Fier me 405.928 ton, qarkun Tiranë me 124.148 ton dhe qarkun Berat me 121.433 ton. Qarqet Gjirokastrë dhe Kukës kanë nivelet më të ulëta të prodhimit të perimeve, me 14.098 dhe 14.452 ton.

Në Shqipëri, perimet më të rëndësishme në termat e prodhimit ndaj prodhimit gjithsej të tyre janë bostanoret 25,67 % (shalqi e pjepër), domatet 24,9 %, perimet e thata 9,87 %, kastravecet 9,57 % dhe specat 6,53 %.

Prodhimi i pemëve frutore, në vitin 2017, u karakterizua nga një rritje prej 0,32 %, krahasuar me një vit më parë. Niveli më i lartë i prodhimit të pemëve frutore shënohet në qarqet Korçë, Elbasan, Fier dhe Berat, ndërsa qarqet Gjirokastrë dhe Vlorë shënojnë nivelet më të ulëta të prodhimit të pemëve frutore. Të dhënat për prodhimin e pemëve frutore përfshijnë pemët frutore në blloqe dhe të shpërndara. Pemët frutore më të rëndësishme në termat e prodhimit ndaj prodhimit

gjithsej të tyre janë molla me 37,41 %, kumbulla 16,48 %, fiku 7,80 %, qershia 7,44 % dhe pjeshka 7,13 %.

Shqipëria ka kushte klimatike që favorizojnë prodhimin e ullirit. Në vitin 2017 u prodhuan 107.830 tonë ullinj, duke sjellë një rritje me 8,83 %, krahasuar me një vit më parë. Të dhënat për prodhimin e ullirit përfshijnë ullinj të mbjellë në blloqe dhe ullinj të shpërndarë. Sasia më e lartë e prodhimit të ullirit në Shqipëri është e përqendruar në zonat fushore dhe bregdetare: në qarkun Berat, Fier dhe Vlorë. Zonat verilindore, me klimë të ftohtë, si qarqet Kukës, Korçë dhe Dibër, nuk janë zona të përshtatshme për kultivimin e ullirit. Prodhimi i agrumeve në vitin 2017 është rritur me 3,17 % në krahasim me një vit më parë. Agrumet më përfaqësuese në termat e prodhimit ndaj prodhimit gjithsej të tyre janë mandarina me 69,88 %, portokalli me 22,25 % dhe limoni 7,84 %. Në qarkun e Vlorës janë prodhuar 68,12 % të agrumeve.

I Përkufizime

Përdorimi i tokës

Sipërfaqja gjithsej e njësisë ekonomike bujqësore (fermës) është tërësia e terrenit të përbërë nga shuma e sipërfaqes bujqësore të përdorur (SBP) dhe sipërfaqes së tokës tjetër.

Sipërfaqja bujqësore e përdorur (SBP) përbëhet nga:

- tokë e punueshme (arë),
- tokë e zënë me kultura drufrutore,
- kopshtet e shtëpive dhe
- kullotat e livadhet.

Tokë e punueshme

Toka e punueshme është toka e pluguar ose e lëruar rregullisht, sipas një sistemi të qarkullimit bimor. Qarkullimi bimor është praktika e rritjes alternative të kulturave bimore njëvjeçare në një fushë specifike, sipas një modeli ose renditjeje, të planifikuar në vitet prodhuese pasuese. Kulturat njëvjeçare ndryshojnë çdo vit, por ato mund të jenë edhe shumëvjeçare (jonxhë). Për të dalluar tokën e punueshme nga toka e zënë me kultura drufrutore ose kullota e livadhe përdoret një prag prej pesë vjetesh. Sipërfaqja e kultivuar me bimë arash është sipërfaqja e mbjellë me bimë arash në vitin bujqësor të dhënë. Këtu bëhet fjalë

për sipërfaqe me kultura kryesore (të para). Këto kultura kryesore normalisht kanë vlerë ekonomike më të lartë se kulturat e tjera dhe zënë tokën në pjesën më të madhe të vitit. Kulturat kryesore janë drithërat e bukës, kulturat e pranverës, misri kokërr, patatja, fasulja, bimët industriale, foragjeret shumëvjeçare, etj.

Kopshtet e shtëpive

Kopshtet e shtëpive janë sipërfaqet e caktuara të tokës për rritjen e produkteve bujqësore, me të cilat synohet të plotësohen nevojat e fermerit dhe të familjes së tij. Zakonisht kopshtet e shtëpive janë të ndara nga pjesa e tokës së punueshme.

Sipërfaqja e mbjellë me drufrutorë

Sipërfaqja me drufrutorë është sipërfaqja e tokës e zënë me pemë frutore, ullinj, agrume dhe vreshta. Këtu llogaritet vetëm sipërfaqja e mbjellë në blloqe me kultura drufrutore.

Livadhet dhe kullotat

Livadhet dhe kullotat janë sipërfaqe të zëna me bimë barishtore shumëvjeçare, që zënë terrenin për një periudhë relativisht të gjatë kohe, mbi 5 vjet, nëpërmjet kultivimit ose rritjes natyrore.

Sipërfaqja e tokës tjetër përbëhet nga:

- sipërfaqja e zënë nga pyjet,
- sipërfaqja bujqësore e papërdorur dhe
- sipërfaqja jobujqësore.

Pyjet

Pyll është sipërfaqja e tokës më e madhe se 1 dynym, me drurë pyjorë në formë grumbulli, që mbulojnë mbi 30 % të saj dhe me potencial për të arritur lartësi mbi 3 m, i cili përfaqëson një ekosistem kompleks dhe shumëfunksional, me ndikime në mjedisin rrethues.

Tokë bujqësore e papërdorur

Tokë bujqësore e papërdorur është sipërfaqja e përdorur paraprakisht si sipërfaqe bujqësore, e cila gjatë dy ose më shumë viteve të njëpasnjëshme nuk është punuar për arsye ekonomike, sociale e të tjera.

Sipërfaqe jobujqësore

Sipërfaqe jobujqësore është toka e zënë nga objekte, rrugë, gurore, tokë jopjellore, shkëmbinj, etj.

Vit prodhimi

Me vit prodhimi nënkuptojmë vitin kalendarik në të cilin fillon vjelja e prodhimit.

Sipërfaqe e kultivuar

Sipërfaqja e kultivuar korrespondon me sipërfaqen totale të mbjellë për prodhimin e një kulture bujqësore specifike gjatë një viti të dhënë, nga e cila përjashtohet sipërfaqja e dëmtuar nga dëmtues natyrorë (përmytjet, zjarre etj). Sipërfaqja e kultivuar përfshin sipërfaqet e kulturave të para dhe të dyta.

Sipërfaqe prodhuese e drufrutorëve

Sipërfaqe prodhuese e drufrutorëve është sipërfaqja që potencialisht jep prodhim. Përjashtohet sipërfaqja e pemtoreve të reja, blloqet e gjera të drufrutorëve dhe ato të degraduara.

Tab. 1
Sipërfaqja e mbjelle e bimëve të arave

000 ha

Nr	Emërtimi	2013	2014	2015	2016	2017
1	Drithra	142,1	143,2	142,6	148,0	145,8
	Grurë	71,2	70,0	69,6	70,5	68,1
	Misër	53,5	55,0	54,6	58,5	58,1
	Thekër	1,2	1,4	1,3	1,2	1,2
	Elb	2,5	2,7	2,5	3,1	3,1
	Tagjira	13,6	14,1	14,6	14,7	15,4
2	Perime bostan	30,0	30,0	31,1	31,2	31,9
3	Luleshtrydhe	-	-	-	-	0,1
4	Patate	9,1	9,6	10,1	9,7	9,9
5	Fasule	14,2	14,6	14,9	13,7	13,0
6	Duhan	1,7	1,5	1,2	1,1	0,9
7	Lule dielli	0,8	0,7	0,7	0,7	0,5
8	Sojë	0,3	0,2	0,2	0,3	0,2
9	Panxhar sheqeri	-	-	-	-	0,7
10	Foragjere të njoma	215,3	204,2	207,3	208,6	215,7
11	Bime medicinale		5,0	5,0	5,1	5,4
	Sipërfaqja e mbjellë	413,3	408,9	413,1	418,3	424,2

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural


Tab. 2
Prodhimi i bimëve të arave

000 ton

Nr	Emërtimi	2013	2014	2015	2016	2017
1	Drithra	702,9	700,4	695,5	698,4	701,7
	Grurë	294,0	280,0	275,0	275,0	274,9
	Misër	372,0	380,0	380,0	379,7	381,1
	Thekër	2,9	3,1	3,0	2,7	2,7
	Elb	6,9	7,3	7,0	9,0	9,0
	Tagjira	27,0	30,0	30,4	32,0	34,1
2	Perime Bostan	924,0	950,0	1030,0	1129,0	1151,9
3	Lule shtrydhe	-	-	-	-	5,1
4	Patate	236,7	240,0	245,0	238,3	249,8
5	Fasule	28,0	30,0	28,0	24,8	21,2
6	Duhan	2,8	3,0	2,2	1,8	1,4
7	Lule dielli	1,5	2,0	2,0	2,0	1,1
8	Sojë	0,3	0,4	0,5	0,7	0,5
9	Panxhar Sheqeri	-	-	-	-	29,7
10	Foragjere të njoma	6048,0	6100,0	6000,0	6.144	6.689
11	Bime medicinale	-	17,4	10,8	10,6	12,8

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Fig. 1
Prodhimi i bimëve të arave, 000 ton



Tab. 3
Rendimenti i bimëve të arave

Kv/ha

Nr	Emërtimi	2013	2014	2015	2016	2017
1	Grurë	41.3	40.0	39,5	39,0	40,4
2	Misër	66.3	65,2	65,0	64,9	61,1
3	Thekër	23,4	22.3	22,8	22,5	22,6
4	Elb	27.4	26.5	27,6	28,9	29,5
5	Tagjira	19.8	21.3	20,9	21,6	21,9
6	Perime	256.0	263,6	278,3	288,6	287,0
7	Patate	248,0	244,1	237,2	224,2	234,8
8	Fasule	19.0	19,7	17,9	17,5	16,1
9	Duhan	17.2	20.2	17,7	16,8	15,5
10	Lule dielli	19.0	29.2	29,6	29,0	22,3
11	Sojë	17.0	16.1	18,2	22,7	20,3
12	Foragjere	258.9	267,0	267,0	294,5	310,1

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Tab. 4
Sipërfaqja me perime të njoma

000 ha


Nr	Qarqet	2013	2014	2015	2016	2017
	Gjithsej	24,2	23,7	23,8	25,6	25,5
1	Berat	1,8	1,8	1,9	2,1	2,2
2	Diber	1,0	1,1	1,0	1,1	1,2
3	Durres	2,8	2,7	2,7	2,7	2,7
4	Elbasan	1,9	1,8	1,8	2,1	1,9
5	Fier	5,4	5,3	5,1	6,1	5,7
6	Gjirokaster	0,5	0,5	0,8	0,5	0,5
7	Korce	1,3	1,4	1,5	1,4	1,5
8	Kukes	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5
9	Lezhe	1,3	0,9	1,1	1,2	1,3
10	Shkoder	2,3	2,2	2,2	2,2	2,3
11	Tirane	3,8	3,9	4,0	4,1	4,2
12	Vlore	1,5	1,4	1,4	1,5	1,6

Tab. 5
Prodhimi i perimeve të njoma

000 ton

Nr	Qarqet	2013	2014	2015	2016	2017
	Gjithsej	587,3	597,0	646,3	740,0	742,5
1	Berat	71,0	76,3	90,2	104,1	106,8
2	Diber	32,9	34,6	30,3	35,2	32,7
3	Durres	63,1	64,8	66,8	70,7	63,1
4	Elbasan	54,4	50,9	52,1	67,4	59,7
5	Fier	163,1	165,8	182,4	227,5	240,7
6	Gjirokaster	9,1	9,1	12,8	8,2	8,3
7	Korce	31,0	35,8	39,0	37,4	40,0
8	Kukes	11,5	11,6	10,7	11,4	11,0
9	Lezhe	22,5	17,6	22,5	27,4	26,0
10	Shkoder	40,9	40,6	41,7	45,7	48,0
11	Tirane	66,7	68,4	75,0	80,5	80,8
12	Vlore	21,1	21,5	22,8	24,7	25,5

Fig. 2
Prodhimi i perimeve, 000 ton



Tab. 6
Sipërfaqja e serrave me perime

	2013	2014	2015	2016	2017
Serra ngrohje	49	55	70	71	55
me xham	14	14	15	19	23
me plasmas	35	41	55	52	32
Serra diellore	960	1.030	1.173	1.334	1.485
me xham	64	60	46	47	42
me plasmas	896	970	1.127	1.287	1.443
Serra gjithsej	1.009	1.085	1.243	1.405	1.540

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Tab. 7
Prodhimi i perimeve në serra

	2013	2014	2015	2016	2017
Serra ngrohje	4.850	5.521	7.790	6.918	5.260
me xham	1.400	1.450	1.550	1.750	2.145
me plasmas	3.450	4.071	6.240	5.168	3.115
Serra diellore	80.400	87.500	100.480	112.755	135.607
me xham	5.900	5.300	2.630	3.095	2.430
me plasmas	74.500	82.200	97.850	109.660	133.177
Serra gjithsej	85.250	93.021	108.270	119.673	140.867

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Tab. 8
Rendimenti i perimeve në serra

Kv/ha

	2013	2014	2015	2016	2017
Serra ngrohje	989.8	1003.8	1112,9	974,4	956,4
me xham	1000.0	1035.7	1033,3	921,1	932,6
me plasmas	985.7	992.9	1134,5	993,8	973,4
Serra diellore	837.5	849.5	856,6	845,2	913,2
me xham	893.9	883.3	571,7	658,5	578,6
me plasmas	833.3	842.3	868,2	851,4	922,9
Serra gjithsej	844.0	857.3	871,0	852,0	914,7

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Tab. 9
Numri rrënjëve të drufrutorëve gjithsej

000 rrënjë

Nr	Emërtimi	2013	2014	2015	2016	2017
1	Pemë frutore	11.909	12.254	12.405	12.594	13.130
2	Ullinj	8.620	8.994	9.225	9.608	9.786
3	Agrume	1.125	1.200	1.282	1.354	1.394
4	Pjergulla	5.974	6.075	6.109	6.197	6.173
5	Vreshta (Ha)	10.178	10.383	10.438	10.533	10.695

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Tab. 10
Numri i rrënjëve të drufrutorëve në prodhim

000 rrënjë

Nr	Emërtimi	2013	2014	2015	2016	2017
1	Pemë frutore	9.292	9.654	10.185	10.575	10.961
2	Ullinj	5.277	5.803	6.332	6.643	7.442
3	Agrume	767	859	951	1.044	1.109
4	Pjergulla	5.494	5.599	5.655	5.775	5.828
5	Vresht (ha)	9.579	9.625	9.891	10.011	10.057

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural


Tab. 11
Prodhimi i drufrutorëve

000 ton

No	Përshkrimi	2013	2014	2015	2016	2017
1	Pemë frutore	218,0	220,0	245,0	261,0	262,6
2	Ullinj	92,0	98,0	96,0	99,0	107,8
3	Agrume	20,0	21,0	30,0	40,0	41,0
4	Rush Gjithsej	204,0	203,7	205,0	205,1	202,9

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Fig. 3
Prodhimi i drufrutorëve, 000 ton



Tab. 12
Rendimenti i drufrutorëve

kg/rrenjë

Nr	Emërtimi	2013	2014	2015	2016	2017
1	Pemë frutore	23,5	22,8	23,6	24,7	24,0
2	Ullinj	14,7	16,9	12,1	14,9	14,5
3	Agrume	26,1	24,4	31,5	38,0	37,0
4	Pjergulla	15,4	15,0	14,6	14,0	13,8
5	Vresht (Kv/ha)	124,5	124,5	123,8	124,3	121,8

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Tab. 13
Sipërfaqja e ujitur sipas qarqeve

Ha

Nr	Qarku	2013		2014		2015		2016		2017	
		Aftësia ujitëse		Aftësia ujitëse		Aftësia ujitëse		Aftësia ujitëse		Aftësia ujitëse	
		potenciale	aktuale	potenciale	aktuale	potenciale	aktuale	potenciale	aktuale	potenciale	aktuale
1	Berat	13,500	8,160	13,760	8,830	14,116	9,532	14,215	9,570	14,231	9,919
2	Dibër	23,128	16,504	23,128	16,504	25,285	18,880	26,163	19,363	26,290	19,915
3	Durrës	20,695	11,893	19,736	11,866	19,853	10,894	20,004	10,980	19,993	11,214
4	Elbasan	34,926	22,190	34,906	22,243	35,266	22,093	35,552	22,145	35,597	22,205
5	Fier	76,775	46,705	83,604	46,772	80,335	48,997	78,761	52,524	79,019	52,788
6	Gjirokastrë	19,884	9,756	18,989	8,332	18,833	8,118	17,397	8,080	17,400	8,413
7	Korçë	35,907	22,446	35,652	24,610	37,085	27,949	36,875	27,683	38,875	27,963
8	Kukës	11,384	8,130	11,412	8,130	11,347	8,090	13,096	10,836	11,500	10,500
9	Lezhë	17,779	9,794	17,163	10,758	18,585	11,745	18,774	11,315	18,774	11,545
10	Shkodër	34,635	17,078	34,220	16,126	34,520	16,788	34,520	16,788	34,520	16,788
11	Tiranë	14,872	9,102	26,980	11,652	25,095	18,409	25,070	18,384	25,070	18,542
12	Vlorë	34,179	23,500	34,179	23,530	33,097	23,530	33,097	23,530	33,097	23,650
Gjithsej		337,664	205,258	353,729	209,353	353,417	225,025	353,524	231,198	354,366	233,442

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Tab. 14
Makinertë bujqësore sipas qarqeve, 2017

Nr

Nr No	Qarku Prefecture	Traktor me rrota Wheeled tractors	Minitraktorë Minitractors	Makina mbjellëse Sowing machinery	Motokorrëse Mower	Autokombajna Autocombines	Traktor me zinxhirë Tractor in chain	Freza Fresa
1	Berat	539	285	213	161	35	14	863
2	Dibër	283	89	116	104	35	9	144
3	Durrës	353	546	220	242	40	16	453
4	Elbasan	877	587	420	196	88	76	492
5	Fier	2.690	1.125	1.002	614	202	32	1.296
6	Gjirokastrë	278	110	112	109	33	2	1.003
7	Korçë	1.457	1.235	758	260	92	13	869
8	Kukës	279	207	171	91	20	7	119
9	Lezhë	469	258	243	231	25	5	356
10	Shkodër	1.046	348	181	333	42	3	388
11	Tiranë	574	557	331	270	42	29	550
12	Vlorë	695	328	291	157	43	5	437
Gjithsej		9.540	5.675	4.058	2.768	697	211	6.970

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Tab. 15
Numri i makinerive bujqësore

Nr

Nr	Emërtimi	2013	2014	2015	2016	2017
Gjithsej		20.975	20.127	22.328	22.265	22.738
1	Traktor me rrota	9.513	9.794	10.101	9.419	9.540
2	Mbjellëse të lashtash	3.487	3.188	3.759	3.942	4.058
3	Traktor motokorrës	2.280	2.440	2.531	2.661	2.768
4	Autokombajna	703	692	699	704	697
5	Minitraktorë	4.992	4.013	5.238	5.539	5.675

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

BLEGTORIA



I Hyrje

Blegtoria ka qenë dhe mbetet një sektor i rëndësishëm për ecurinë ekonomike dhe sociale të vendit. Nga blegtoria merren produkte të çmuara ushqimore, mish, qumësht, vezë, mjaltë. Të dhënat mbi vijueshmërinë e statistikave të blegtorisë në vite janë siguruar nga vrojtimet vjetore si dhe shfrytëzimi i të dhënave administrative të grumbulluara nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

Vlerësimi i numrit të krerëve është bazuar në lëvizjen e blegtorisë për secilën kategori të gjedhëve, të leshtave të dhirtave dhe derrave. Vlerësimi për prodhimin e mishit për secilën kategori, është bazuar në përlogaritjet e bëra për lëvizjen e blegtorisë, pra në numrin e krerëve të skartuar dhe në peshën mesatare për krerë të therur.

Vlerësimi i prodhimit të qumështit nga lopët, është bërë duke u bazuar në numrin mesatar vjetor të tyre, që rezulton nga lëvizja e blegtorisë, dhe në rendimentin mesatar të qumështit për lopë. I njëjti arsyetim është ndjekur edhe për prodhimin e qumështit nga delet dhe dhitë.

I Gjetje Kryesore

Numri i krerëve të blegtorisë. Referuar strukturës së blegtorisë në njësi gjedhi, numrin më të madh të krerëve të blegtorisë e kanë gjedhët me 47,0 % ndaj numrit gjithsej të krerëve të blegtorisë. Të imtat janë 31,0 %, derrat janë 6,0 %, shpendët 9,0 % dhe njëthundrakët 7,0 % ndaj numrit gjithsej të krerëve të blegtorisë në njësi gjedhi.

Numri i krerëve të gjedhit në vitin 2017 ishte rreth 475 mijë krerë duke pësuar rënie me 3,5 % krahasuar me 2016.

Të leshta: Numri i të leshtave në vitin 2017 ishte 1.926 mijë krerë duke shënuar një rënie me 2,4 % krahasuar me 2016.

Të dhirta: Numri i të dhirtave në 2017 ishte 933 mijë krerë duke pësuar rënie me 0,8 % krahasuar me 2016.

Shpendët: Numri i krerëve të shpendëve në vitin 2017 ishte 7,835 mijë krerë duke shënuar rënie me 0,5 % krahasuar me 2016.

Derra: Në vitin 2017 numri i derrave ishte 180 mijë krerë duke pësuar rënie me 1,5 % krahasuar me një vit më parë.


Bletët: Aktiviteti i fermerëve në disa zona të vendit po zgjerohet edhe në drejtimin të mbarështrimit të bletëve. Në vitin 2017 numri i koshereve ishte 290 mijë duke shënuar rënie me 5,8 % krahasuar me 2016.

Tab. 3
Struktura e blegtorisë (në 1000 njësi gjedhi)

Emërtimet	2013	2014	2015	2016	2017
Totali	974	989	953	952	924
Gjedhë	498	500	452	452	438
Të imta	272	262	286	286	283
Derra	46	51	57	57	56
Shpendë	83	99	86	86	78
Njëthundrakë	74	78	72	72	67

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Fig. 5
Struktura e blegtorisë në njësi gjedhi në %, viti 2017



Tab. 1
Numri i bagëtive, në 000 krerë

Treguesit	2013	2014	2015	2016	2017
Gjedhë	498	500	504	492	475
- Lopë	356	358	357	355	349
Të imta	2.723	2.804	2.850	2.913	2.859
Të leshta	1.856	1.869	1.918	1.972	1.926
- Dele	1.413	1.419	1.417	1.428	1.407
Të dhirta	867	904	932	941	933
- Dhi	656	695	700	716	717
Derra	152	172	171	181	180
- Dosa	12	12	11	13	12
Njethundrakë	93	91	91	94	89
Shpendë	8.928	9.493	8.558	8.326	7.835
nga këto: pula	5.934	6.645	5.323	4.790	4.820
Blete (koshere)	246	261	271	303	290

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Fig. 1
Numri i bagëtive





Fig. 2
Numri i shpendëve



Prodhome Blegtorale

Prodhimi i qumështit për vitin 2017 është 1.156.286 ton. Struktura e prodhimit të qumështit referuar vitit 2017 është: qumësht lope 85,0 %, qumësht dele 7,5 %, qumësht dhie 7,5 %.

Prodhimi i qumështit nga lopët për vitin 2017 është 982.510 ton ose 0,8 % më shumë krahasuar me 2016. Rendimenti mesatar vjetor i qumështit në nivel vendi për vitin 2017 është 2.849 kg për krerë. Rendimentin më të lartë e ka qarku i Fierit me rreth 4.086 kg për krerë. Rendimentin më të ulët e ka qarku i Gjirokastrës me 1.744 kg qumësht për krerë. Prodhimi qumështit nga delet për vitin 2017 është 1,8% më pak se në vitin 2016. Rendimenti mesatar vjetor, në nivel vendi i qumështit të deles është 61.8 Kg për krerë. Rendimentin më të lartë e ka qarku i Durrësit me 98,5 Kg për krerë.

Prodhimi qumështit nga dhinë për vitin 2017 është 2,3 % më i lartë se në vitin 2016. Rendimenti mesatar vjetor i qumështit të dhive në nivel vendi për vitin 2017 është 121 kg për krerë. Qarku me rendimentin më të lartë të qumështit për vitin 2017 është Durrës me 178 kg për krerë. Qarku me rendimentin më të ulët është Gjirokastra me 98 kg për krerë.

Prodhimi i mishit peshë e gjallë

Prodhimi i mishit peshë e gjallë, në nivel vendi për vitin 2017 është 161.286 ton ose 0,9 % më i lartë krahasuar me vitin 2016. Struktura e prodhimit të mishit për vitin 2017 është: mish nga gjedhët 44,8 %, mish nga të imtat 32,3 %, mish nga derri 10,5 % dhe mish nga shpendët 12,4 %.

Të tjera prodhome blegtorale

Prodhimi i vezëve në vitin 2017 ka pësuar një rënie me rreth 2,3 % krahasuar me vitin 2016. Prodhimi mjaltit ka pësuar rënie me 7,9 % krahasuar me vitin 2016.

Tab. 2
Prodhimet blegtorale, në 000 ton

Treguesit	2013	2014	2015	2016	2017
Qumësht	1.131	1.133	1.131	1.145	1.156
Qumësht lope*	969	965	964	975	983
Qumësht dele	84	89	87	85	87
Qumësht dhie	78	79	80	85	87
Mish peshë e gjallë	153	155	158	160	161
Mish gjedhi	70	71	71	72	72
Mish të imtash	49	50	53	51	37
Mish derri	17	18	17	17	17
Mish shpendi	17	17	17	20	20
Lesh (ton)	830	3.100	3.332	3.431	3.123
Vezë (në mil)	3.000	835	830	830	811
Mjaltë (ton)	3.000	3.000	3.200	3.923	3.614

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Fig. 3
Struktura e prodhimit të qumështit, viti 2017





Fig. 4
Prodhimi mishit peshë e gjallë



Prodhimi i qumështit dhe nën produkteve në Agro-Industri

Në vitin 2017, sasia e qumështit të grumbulluar është rreth 131 mijë ton duke shënuar rritje me rreth 5,0 %, krahasuar me 2016. Gjatë kësaj periudhe, sasia e qumështit të lopës të grumbulluar është rreth 110 mijë ton duke shënuar një rritje me 6,6 %, krahasuar me 2016. Nga ana tjetër, në vitin 2017 sasia e grumbulluar e qumështit të deles është rreth 13 mijë ton duke shënuar një rritje me 1,5 %, krahasuar me një vit më parë. Sasia e grumbulluar e qumështit nga dhitë është rreth 9 mijë ton duke shënuar një rënie me 8,0 %, krahasuar me vitin 2016.


Në vitin 2017, sasia e qumështit të prodhuar për konsum është rreth 13 mijë ton, në rritje me 21,6 %, krahasuar me 2016. Ndaj sasisë gjithsej të qumështit të prodhuar në vitin 2017, qumështi gjysëm i skremuar përbënte rreth 17,2 %, qumështi i plotë i përpunuar 79,3 %, qumështi i papërpunuar 2,9 % dhe qumështi i skremuar rreth 0,5 %.

Sasia e prodhuar e djathit sipas origjinës në vitin 2017 u rrit me 2,9 %, krahasuar me një vit më parë. Sasia e djathit të përpunuar ra me 24,0 %. Prodhimi i gjalpës shënoi një rritje me rreth 6,6 % krahasuar me një vit më parë.

Tab. 4
Sasia e qumështit të grumbulluar në Agroindustri, Kg

<i>Emërtimet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Sasia yndyrës Kg</i>	<i>Njësitë yndyrore</i>	<i>Përmbajtja e yndyrës, %</i>	<i>Përmbajtja e proteinave Kg</i>	<i>Njësitë proteinore</i>	<i>Përmbajtja e proteinave, %</i>
2014							
Qumësht lope	95.129.761	3.542.953	354.295.338	3,72	3.024.316	302.431.551	3,18
Qumësht dele	10.817.436	718.928	71.892.758	6,65	-	-	-
Qumësht dhie	7.981.140	333.464	33.346.445	4,18	-	-	-
Krem	-	-	-	-	-	-	-
2015							
Qumësht lope	105.181.101	4.027.253	402.725.339	3,83	3.231.554	323.155.352	3,07
Qumësht dele	11.671.108	814.687	81.468.694	6,98	-	-	-
Qumësht dhie	8.292.103	344.887	34.488.669	4,16	-	-	-
Krem	-	-	-	-	-	-	-
2016							
Qumësht lope	102.864.509	3.980.861	398.086.077	3,87	3.129.333	312.933.250	3,04
Qumësht dele	13.279.690	890.711	89.071.076	6,71	-	-	-
Qumësht dhie	8.787.530	352.566	35.256.636	4,01	-	-	-
Krem	-	-	-	-	-	-	-
2017							
Qumësht lope	109.601.825	4.188.123	418.812.297	3,82	3.294.003	329.400.281	3,01
Qumësht dele	13.484.215	914.630	91.463.004	6,78	-	-	-
Qumësht dhie	8.080.942	326.812	32.681.176	4,04	-	-	-
Krem	-	-	-	-	-	-	-

Fig.6
Sasia gjithsej e qumështit të grumbulluar, në tonë



Tab. 5
Nënproduktet e prodhuara, Kg

Nënproduktet	2014	2015	2016	2017
Qumësht për konsum	12.103.314	11.106.414	10.982.665	13.358.811
Qumësht i papërpunuar	1.021.111	828.575	533.400	390.631
Qumësht i përpunuar	3.652.427	4.651.728	6.424.566	10.598.692
I pasterizuar	3.621.467	4.132.694	6.242.246	10.440.734
UHT	30.960	519.034	182.320	157.958
Qumësht gjysëm i skremuar	6.843.673	5.590.684	3.950.395	2.297.764
I pasterizuar	4.317.440	5.516.565	2.967.321	1.082.799
UHT	2.526.233	74.119	983.074	1.214.965
Qumësht i skremuar	586.103	35.427	74.304	71.724
I pasterizuar	565.463	15.227	74.304	71.724
UHT	20.640	20.200	-	-
Krem	248.123	21.680	183.969	266.019
Më pak se 29% yndyrë	177.520	10.140	100.210	233.654
Më shumë se 29% yndyrë	70.603	11.540	83.759	32.365
Qumësht i acidifikuar (kos, dhallë etj)	14.283.587	15.652.086	15.687.260	15.128.708
Me shtesa	0	0	0	-
Pa shtesa	14.283.587	15.652.086	15.687.260	15.128.708
Qumësht i përqendruar	-	-	-	-
Gjalpë dhe produkte të tjerë yndyrorë	682.958	935.574	824.419	877.777
Gjalpë (Tradicional)	668.168	924.438	798.999	868.263
Gjalpë i shkrirë	14.790	11.136	25.420	9.514
Djathë	11.938.676	13.533.031	14.301.162	14.712.154
Sipas origjinës				0
Djathë nga qumështi i lopës	8.618.413	10.207.317	10.515.556	10.895.070
Djathë nga qumështi i deles	2.190.924	2.256.590	2.646.623	2.757.922
Djathë nga qumështi i dhisë	1.129.339	1.069.124	1.138.983	1.059.162
Sipas fortësisë				0
Djathë i butë	6.962.121	8.091.775	8.100.805	8.255.670
Djathë gjysëm i fortë	3.607.586	4.478.458	4.333.689	4.093.721
Djathë i fortë	576.634	284.262	533.111	918.019
Të tjera prodhime (Gjizë qumështi, Salcë Kosi)	792.335	678.536	1.333.557	1.444.744
Djathë i përpunuar	256.200	253.000	279.000	211.960

PESHKIMI

Shqipëria ka potenciale ujore natyrale, të cilat janë të përshtatshme për rritjen e peshqve. Peshkimi është një sektor i rëndësishëm i ekonomisë shqiptare. Zhvillim ka marrë akuakultura, si sektor i rëndësishëm dhe me perspektive për ekonominë vendase.

Metodologji

Të dhënat e peshkimit grumbullohen nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Të dhënat mbledhen duke u mbështetur në metodikën e GFCM për grumbullimin e të dhënave bazuar në segmentet e flotës së peshkimit, grumbullimin e logbook-eve nga anijet, intervistat me operatorët e akuakulturës etj. Të dhënat për zënien e peshkut grumbullohen sipas kategorive ujore dhe në nivel vendi.

Peshkimi ndahet sipas kategorive ujore të cilat janë:

1. Peshkimi detar
2. Bregdet
3. Laguna
4. Ujëra të brendëshme
5. Akuakultura
6. Molusqe

Përkufizime

Aktivitet peshkimi - janë veprimtaritë e lidhura me kërkimin e peshkut, me lëshimin, vendosjen dhe tërheqjen e mjeteve të peshkimit, transferimin në bord të zënieve, trasbordimin, ruajtjen në bord, transformimin në bord, transferimin, vendosjen në kosha, majmërinë dhe shkarkimin e peshqve dhe produkteve të peshkimit.

Peshkimi- përfshin të gjitha të dhënat e aktivitetit të flotës dhe kapacitetin prodhues të sipërfaqeve të ndryshme të peshkimit.

Ujëra të brendshme - janë lagunat bregdetare, liqenet natyrore, liqenet e hidrocentraleve, ujëmbledhësit e bujqësisë, lumenjtë dhe ujëra të tjera të Republikës së Shqipërisë, të ndryshme nga ujërat detare.

Flota- është numri total i anijeve të peshkimit që shfrytëzon një burim të caktuar.

Kapaciteti i peshkimit- është sasia e peshkut që mund të merret nga një njësi peshkimi.

Zënie peshku- të dhënat i referohen sasisë së zënies të të gjitha llojeve të specieve detare (të peshkut, krustance, molusqe etj), specieve të ujërave të ëmbla (lumenj, liqene, ujëmbledhësa, akuakulturë).

Akuakultura- është rritja e peshkut, në të cilin përfshihen: rritje peshku, molusqe krustance me anë të rasateve.

Gjetje Kryesore

Peshkimi detar zë rreth 56,0 % të totalit të peshkimit, ujërat e brendëshme zënë 24,0 %, bregdeti 13,0 % dhe lagunat 7,0 % të totalit të peshkimit. Akuakultura kultivohet më shumë në rrethin e Sarandës, qarku Vlorë përkatësisht me 78,9 % të prodhimit ndaj totalit të përgjithshëm. Molusqet kultivohen vetëm në rrethin e Sarandës, qarku Vlorë.

Në vitin 2017, zënia e peshkut ka qenë 12.719 ton nga 12.534 ton që ishte në vitin 2016, duke pësuar një rritje me 1,0%. Akuakultura ka pësuar një rritje të madhe gjatë vitit 2017 me 25,0 % krahasuar me një vit më parë.

Tab. 6
Zënie peshku

Emërtimi	në ton				
	2013	2014	2015	2016	2017
Peshkimi gjithsej	8.987	8.722	7.875	7.884	8.289
- Detar	5.526	5.211	5.052	4.646	4.609
- Bregdeti	1.319	1.312	614	952	1.074
- Laguna	573	536	550	598	599
- Ujërat e brëndshme	1.569	1.663	1.659	1.688	2.007
Akuakultura	1.585	1.500	3.000	3.200	4.000
Molusqe	750	800	295	1.450	430
Zënie gjithsej	11.322	11.022	11.170	12.534	12.719

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

PYJET DHE BIODIVERSITETI



I Hyrje

Pyjet gjithnjë e më shumë po marrin rëndësi, jo vetëm për lëndën drusore dhe për prodhimet jo drusore, por për ndikimin e madh dhe të pazëvendësueshëm në biodiversitet, shëndet, ekonomi dhe turizëm.

Pyjet e Shqipërisë, në vitin 2017, shtrihen në një sipërfaqe prej 1.051.871 ha, që përfaqëson 60,44 % të fondit pyjor dhe kullësor. Kullotat dhe livadhet zënë një sipërfaqe prej 478.081 ha ose 27,47 % të fondit pyjor dhe kullësor.

Fondi i tokës pyjore përbën 36,6 % të sipërfaqes së Shqipërisë dhe ai kullësor 16,6 %.

I Gjetjet kryesore

Sipërfaqja e përgjithshme e fondit të tokës pyjore në vitin 2017 është 1.051 871 hektarë, me një vëllim të përgjithshëm të lëndës drusore 54.925/000 m³. Si pasojë e zjarreve dhe shfrytëzimeve, në vitin 2017 vihet re një rënie prej 0,03 % në sipërfaqe dhe 0,4 % në volum, krahasuar me atë të vitit 2016.

Në vitin 2017 volumi i përgjithshëm i pyjeve arrin në 54.925/000 m³, ku 94 % e këtij volumi përbëhet nga pyjet publike dhe 6 % nga pyjet private. Si pasojë e shfrytëzimeve, zjarreve dhe prerja e druve të zjarrit për fshatarësinë, ky volum është ulur afërsisht me 260.000 m³, krahasuar me volumin e vitit 2016.

Në vitin 2017 volumi i drurit industrial të shfrytëzuar nga pyjet arrin në 15.292 m³, ku 81 % e këtij volumi përbëhet nga drurë fletore dhe 19 % nga drurë halore .

I Përkufizime

Fond pyjor janë të gjitha sipërfaqet pyjore e jopyjore, burimet pyjore e jopyjore bashkëshoqëruese, infrastruktura përkatëse, përfshirë edhe sipërfaqet e zhveshura, të cilat krijojnë një mjedis harmonik me pyjet e tokën pyjore (çeltirat, shkëmbinjtë, dunat dhe ranishtat), brezat pyjorë mbrojtës, grupet e veçuara të drurëve dhe shkurret.

Pyll është sipërfaqja e tokës me një grup të dendur drurësh pyjorë, në formë të qëndrueshme ose me bimësi tjetër të rrallë pyjore, me sipërfaqe më të madhe se një dynym e me shkallë mbulimi jo më të vogël se 30 %, që prodhon masë drusore, ushtron ndikim në mjedisin rrethues dhe që siguron funksionet e pyllit.

Shfrytëzimi i pyjeve përfaqëson operacionet e prerjes dhe të nxjerrjes së lëndës drusore nga pyjet.

Fondi kullësor janë të gjitha sipërfaqet e kullotave dhe livadheve natyrore, drurët e shkurret brenda sipërfaqeve të tyre që përdoren për kullotje jashtë fondit të tokës bujqësore.

Zona të mbrojtura shpallen territore tokësore, ujore, detare e bregdetare të caktuara për mbrojtjen e diversitetit biologjik, të pasurive natyrore dhe kulturore, bashkëshoqëruese.

Rezervë strikte natyrore janë territore më të mëdha se 50 ha, me vlera natyrore të veçanta, të formuara nga ekosisteme natyrore ose lehtësisht të ndryshueshme, që përfaqësojnë bioqendra dhe biokorridore me rëndësi kombëtare dhe rajonale.

Park kombëtar janë territoret e gjëra, zakonisht jo më të vogla se 1000 ha, unike për nga vlerat kombëtare dhe ndërkombëtare, një pjesë e madhe e të cilave janë ekosisteme natyrore, të ndikuara pak nga veprimtaria e njeriut

Monument natyror është formacioni natyror (përfshirë edhe dru të veçantë), me sipërfaqe deri 50 ha, formacioni i veçantë gjeologjik dhe gjeomorfologjik, një depozitë mineralesh ose një habitat i një lloji të rrallë e të kërcënuar ose me rëndësi e vlerë të veçantë shkencore dhe estetike. Park natyror janë territoret që përfaqësojnë bioqendra dhe biokorridore me rëndësi rajonale e vendore ose zonat me bimë, kafshë, minerale e gjetje paleontologjike, veçanërisht të mbrojtura ose zonat që përdoren për qëllime studimore, edukative dhe kulturore .

Zonat e mbrojtura e burimeve të menaxhuara janë zonat që përfshijnë territore të gjëra e relativisht të izoluara dhe të pabanuara, ku hyhet me vështirësi ose rajone që janë ende pak të populluara dhe që

mund të jenë nën presion të vazhdueshëm për t'u populluar dhe përdorur më gjerësisht dhe kthimi i tyre për përdorim intensiv është i paqartë ose i papërshtatshëm, shpallen zona të mbrojtura të burimeve të menaxhuara.

Tab. 1

Të dhëna për bilancin kadastral të fondit pyjor e kullosor të Shqipërisë

Viti	Pyje		Kullota		Sipërfaqe me bimësi pyjore		Sipërfaqe inproduktive		Gjithsej	
	Sip.Ha	%	Sip.Ha	%	Sip.Ha	%	Sip.Ha	%	Sip.Ha	%
2013	1.040.881	60,0	491.011	28,0	29.400	2,0	167.613	10,0	1.728.906	100
2014	1.052.772	60,4	478.292	27,5	25.315	1,5	185.310	10,6	1.741.689	100
2015	1.052.253	60,4	478.188	27,5	25.315	1,5	185.141	10,6	1.740.897	100
2016	1.052.237	60,4	478.188	27,5	25.315	1,5	185.141	10,6	1.740.880	100
2017	1.051.871	60,4	478.081	27,5	25.270	1,5	185.118	10,6	1.740.339	100

Burimi informacionit: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Tab. 2

Fondi pyjor sipas pronësisë

Viti	Sipërfaqja e pyjeve / ha				Volumi i përgjithshëm i pyjeve/000m ³		
	Pyje Publikë	Pyje private	Gjithsej		Pyje Publikë	Pyje private	Gjithsej
2013	1.008.580	32.302	1.040.881		72.928	3.316	76.244
2014	1.023.992	28.780	1.052.772		72.789	3.294	76.083
2015	1.023.473	28.780	1.052.253		51.953	3.294	55.247
2016	1.023.457	28.780	1.052.237		51.891	3.294	55.185
2017	1.023.091	28.780	1.051.871		51.631	3.294	54.925

Burimi informacionit: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit


Tab. 3

Pyjet sipas mënyrës së qeverisjes

Viti	Sipërfaqe ha							
	Trungishtë	%	Cungishtë	%	Shkurre	%	Gjithsej	%
2013	452.228	43,4	336.319	32,3	252.333	24,2	1.040.881	100
2014	379.453	36,0	295.780	28,1	377.539	35,9	1.052.772	100
2015	379.396	36,1	295.440	28,1	377.417	35,9	1.052.253	100
2016	379.380	36,1	295.440	28,1	377.417	35,9	1.052.237	100
2017	379.380	36,1	295.074	28,1	377.417	35,9	1.051.871	100

Burimi informacionit: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Fig. 1
Pyjet sipas mënyrës së qeverisjes, Ha



Tab. 4
Volumi i lëndës drusore në pyje sipas mënyrës së qeverisjes

Viti	Volumi në 000 m ³							
	Trungishtë	%	Cungishtë	%	Shkurre	%	Gjithsej	%
2013	57.337	75,2	11.498	15,1	7.409	9,7	76.244	100
2014	43.377	57,0	29.139	38,3	3.567	4,7	76.083	100
2015	43.368	78,5	8.313	15,0	3.566	6,5	55.247	100
2016	46.094	83,0	5.304	9,6	3.787	6,9	55.185	100
2017	45.886	83,5	5.255	9,6	3.784	6,9	54.925	100


Burimi informacionit: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Tab. 5
Shfrytëzimi i pyjeve dhe produktet kryesore

Viti	Trupa gjithsej m ³	Lëndë ndërtimi m ³	Shtylla miniere m ³	Degë voze m ³	Dru zjarri m ³	Qymyr druri m ³	Gjithsej m ³
2013	24.436	5.167	613	0	828.056	10.290	868.562
2014	31.497	5.449	700	0	789.290	480	827.416
2015	10.754	1.727	241	0	758.388	510	771.620
Liqen, është një trup me ujëra të brendshme sipërfaqësore dhe nëntokësore të qëndrueshëm.

Ujëra bregdetare, janë ujërat sipërfaqësore të cilat ndodhen në brendësi të një vije imagjinare, e cila është e baraslarguar në secilën nga pikat e saj 1 milje detare nga pjesa e jashtme e pikës më të afërt të vijës bazë dhe që shërben si referim për të përcaktuar shtrirjen e ujërave territoriale dhe që shtrihen eventualisht deri në kufirin e jashtëm të ujërave tranzitore.

Erozioni është fenomen natyror, kryesisht gërryerje, ç'vendosjen dhe transportin e lëndëve të ngurta tokësore kryesisht nën forcën e veprimit të ujit ose erës. Faktorë veprues me kontribut kryesor në erozionin e tokës, përveç natyrës, është aktiviteti njerëzor, ndërtimet, bujqësia, turizmi dhe mbi të gjitha zvogëlimi i sipërfaqeve të mbuluara nga biomasa. Në rastin e Shqipërisë dëmtimi i pyjeve është faktori kryesor që shkakton erozionin e tokës.

Pesticide, është çdo substancë ose përzierje substancash që ka qëllim të parandalojë, shkatërojë, të largojë, ose të zvogëlojë efektin e gjallesave primitive, insekteve dhe kafshëve dëmtuese të pasurisë, mjedisit, apo shëndetit të qenieve të gjalla me interes për njeriun.

I Gjetjet kryesore

Ndotja e ajrit - Përmbajtja e disa ndotësve në ajër përgjithësisht ka ardhur në ulje por duke patur origjinë dhe efekte të ndryshme nuk mund të llogariten indikatorë përgjithësues për ndotjen në total. Kryesisht LNP me origjinë nga hidrokarbure të djegura dhe më pak nga ndërtimet ka tendencë rritje duke kaluar disa herë normat e pranuar nga EU dhe OSH.

Mbetjet urbane - Sasia e mbetjeve urbane në shkallë vendi, si refleksion i mënyrës së jetesës, ka patur shumë ndryshime duke ruajtur përgjithësisht sasinë mbi 1 milion ton në vit. Në vitin 2017 janë menaxhuar rreth 1.2 milion ton mbetje urbane me një tendencë të lehtë rënie referuar vitit të mëparshëm. Tirana është qarku që ka përqindjen më të madhe të gjenerimit të mbetjeve urbane me 31,0 %, ndjekur nga Durrësi me 14,4% dhe pasta Fieri 11,9% duke ruajtur afërsisht një korrelacion linear mes mbetjeve dhe banorëve rezidentë. Në shkallë vendi në vitin 2017 janë menaxhuar rreth 436 kg mbetje të ngurta urbane për banor, ndërsa cilat 386 kg/banor janë mbetje tipike urbane dhe

diferenca prej 50 kg/banor janë mbetje industriale menaxhuar bashke me ato urbane.

Uji i lumenjve dhe liqeneve - Sipas të dhënave të mbledhura dhe klasifikimit të UNECE përgjithësisht lumenjtë dhe liqenet në vendin tonë kanë ujëra me cilësi të mirë. Në vitin 2017 ndër lumenjtë që kanë shënuar cilësinë më të lartë, sipas stacioneve të monitorimit janë, Drini i zi në Topojan dhe Vjosa në Çarçove kurse lumi me cilësi uji më të keqe është lumi Gjanica në vendin e bashkimit me lumin Seman.

Ujërat larës, plazhet - Matja e cilësisë së ujërave larës në plazhe konsiston kryesisht në njohjen e treguesve kryesor të ndotjes, "FC" dhe "IE". Në vitin 2017 rezultoi që plazhet më të ndotura janë në Durrës me 9 stacione dhe Vlorë me 4 stacione të cilat kanë nevojë emergjente për rehabilitim. Ndër vite cilësia e ujërave larës ka trend përmirësimi dhe cilësinë më të mirë e kanë plazhet Velipojë, Shëngjin, Dhërmi, Himarë dhe Borsh.

Erozioni - Si një nga format kryesore të degradimit të tokës, është mjaft i dukshëm në Shqipëri. Faktori kryesor që po degradon tokën në Shqipëri është dëmtimi i pyjeve ndjekur nga ndërtimet abuzive. Pasojat janë, përmbajtje masive dhe mungesë uji në burimet natyrore. Zvoglimi i kapaciteteve hidroenergjetike të baseneve dhe dëme në rrugë, toka bujqësore dhe zona të banuara.

Pesticidet - Ndër vite sasia e pesticideve të importuar ka qënë dhe vazhdon të jetë e madhe referuar sipërfaqes së tokës bujqësore të përdorur, megjithatë trendi i sasisë të importuar ka luhatur te mëdha në vite.

Fig. 1
Sasia e mbetjeve të ngurta urbane të menaxhuara




Fig. 2
Sasia e mbetjeve të menaxhuara për banor rezident





Fig. 3
Mbetje inerte të menaxhuara sipas viteve



Tab. 1
Mbetjet e ngurta urbane sipas qarqeve

Nr.	County	Mbetje Urbane (ton)					Mbetje Urbane per banor (ton/banor)					
		2013	2014	2015	2016	2017	2012	2013	2014	2015	2016	2017
1	Berat	43.129	46.531	59.356	64.500	64.353	0,341	0,333	0,341	0,266	0,476	0,505
2	Dibër	23.147	28.834	35.331	22.727	18.826	0,235	0,240	0,291	0,191	0,150	0,156
3	Durrës	105.534	140.387	145.563	156.218	143.280	0,513	0,196	0,411	0,420	0,438	0,495
4	Elbasan	41.076	56.329	105.992	99.617	113.081	0,266	0,226	0,138	0,138	0,278	0,406
5	Fier	116.492	161.304	250.142	149.668	141.869	0,360	0,513	0,408	0,409	0,409	0,476
6	Gjirokastrë	60.519	98.752	55.116	85.878	36.134	0,583	0,514	0,386	0,387	0,390	0,574
7	Korçë	54.005	10.176	101.753	12.610	89.571	0,273	0,344	0,314	0,104	0,134	0,426
8	Kukës	28.633	36.691	11.306	49.573	15.983	0,197	0,199	0,217	0,218	0,350	0,207
9	Lezhë	31.217	40.727	50.876	33.860	49.870	0,272	0,476	0,442	0,441	0,340	0,393
10	Shkodër	48.950	78.369	84.794	60.286	99.483	0,296	0,300	0,341	0,342	0,242	0,485
11	Tiranë	289.180	422.326	371.681	492.890	388.169	0,491	0,391	0,405	0,513	0,469	0,439
12	Vlorë	96.019	108.458	141.323	72.550	93.294	0,584	0,535	0,558	0,558	0,265	0,493
	Total	937.901	1.228.884	1.413.233	1.300.377	1.253.913	0,392	0,325	0,425	0,491	0,452	0,436

Burimi : Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe INSTAT-Vrojtimet vjetore

Tab. 2
Mbetjet inerte te menaxhuara sipas qarqeve

Nr.	Mbetje Inerte (ton)					
	County	2013	2014	2015	2016	2017
1	Berat	18.050	20.368	13.611	5.763	8.222
2	Dibër	16.080	1.360	2.650	4.740	14.570
3	Durrës	4.592	5.426	5.731	7.594	3.934
4	Elbasan	28.900	15.880	4.917	6.217	9.670
5	Fier	14.566	14.523	12.534	12.869	18.337
6	Gjirokastrë	44.672	2.175	6.880	19.154	36.897
7	Korçë	8.162	3.613	5.959	24.475	23.851
8	Kukës	6.700	25.100	5.765	11.303	12.221
9	Lezhë	15.945	1.185	5.303	5.387	2.465
10	Shkodër	12.510	43.784	58.743	6.240	2.650
11	Tiranë	48.751	4.044	7.826	16.213	22.995
12	Vlorë	74.432	73.700	85.080	83.054	6.518
	Total	293.360	211.158	214.999	203.009	162.330

Burimi : Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe AKM



ENERGJIA


BILANCI VJETOR I PËRGJITHSHËM I ENERGJISË

I Hyrje

Bilanci energjistik është një dokument që paraqet situatën aktuale në sektorin e energjisë në Republikën e Shqipërisë. Bilanci i përgjithshëm është përmbledhje e gjithë balanceve të burimeve energjitike të disponueshme dhe është hartuar i

plotë që nga viti 1998. Bilanci paraqet origjinën dhe përdorimin specifik sipas burimeve të energjisë dhe përbëhet nga dy pjesë kryesore: furnizimi dhe përdorimi i energjisë.

Fig. 1
Prodhimi i produkteve parësore sipas viteve




I Gjetjet kryesore

Furnizimi është llogaritur si fluks energjistik për atë kohë në të cilën prodhimi total i furnizuar i korrespondon "konsumit të dukshëm". Raporti i prodhimit kombëtar të energjisë me sasinë e energjisë së harxhuar jep shkallën e pavarësisë energjitike në nivel kombëtar dhe për secilin burim energjie.

Përdorimi i energjisë është llogaritur si sasi për përdorim "final" ose ndryshe, pas përdorimit për konsum të "ndërmjetëm" (pas transformimit). Vihen re ndryshime në strukturën e konsumit final të energjisë sipas degëve për periudhën kohore 2013-2017. Këto ndryshime janë më të dukshme në degën e industrisë dhe energjinë e konsumuar nga konsumatorët familjarë, bizneset, administratën publike, etj.

Fig. 2
Struktura e konsumit të energjisë sipas degëve



I Burimi i të dhënave

Bilancet e përgjithshme vjetore të energjisë për vendin paraqiten në njësi energjie kilo ton naftë ekuivalent (ktoe) dhe si burim informacioni shërben Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN).

I Përkufizime

Konsumi i brendshëm bruto është i barabartë me Prodhim + Import – Eksport ± Ndryshim stoku.

Matja e stokut mbulon gjendjen e prodhuesve të energjisë, importuesve, shpërndarësve, transformuesve dhe përdoruesve finalë, kur ato njihen.

Konsumi final i energjisë i korrespondon energjisë së shpërndarë përdoruesve finale, sipas origjinës, dhe të gjitha llojeve të energjive pa kufizim.

Konsumi final joenergjetik llogarit përdorimet e energjisë si material primar, për përdorime joenergjetike.

Energjia parësore është energjia bruto, pas nxjerrjes, pa përfshirë asnjë transformim (linjit, naftë, gaz natyror, energji hidrike ose nukleare etj.)

Energjia dytësore është energjia e fituar nga transformimi i një energjie parësore ose ndonjë energjie tjetër dytësore (në veçanti nga energjia elektrike me origjinë termike).

Tab. 1
Bilanci i përgjithshëm i energjisë

Emërtimi	2013	2014	2015	2016	2017
Konsumi i brendshëm bruto	2.346	2.340	2.205	2.309	2.366
Prodhimi i produkteve primare	2.041	2.021	2.117	2.013	1.661
Import	1.768	1.898	1.508	1.358	1.569
Ndryshimi i gjendjeve	-235	-308	-127	133	177
Eksport	1.201	1.245	1.265	895	650
Depozituar	27	27	28	34	36
Konsumi në degën e energjisë	53	59	42	115	156
Humbje në shpërndarje	168	95	108	125	107
Disponibël për konsum final	2.123	2.157	2.025	2.060	2.147
Konsumi final joenergjetik	152	87	52	143	77
Konsumi final i energjisë	1.971	2.070	1.973	1.917	2.070

(ktoe)

Burimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN)

Tab. 2
Prodhimi dhe konsumi i energjive parësore

(ktoe)

Emërtimi	2013	2014	2015	2016	2017
Prodhim i produkteve parësore	2.041	2.021	2.117	2.013	1.661
Qymyr	2	0	69	4	46
Naftë	1.207	1.368	1.279	1.056	959
Gaz natyror	16	28	30	79	82
Energji elektrike	598	406	507	669	389
Dru zjarri	202	202	214	188	168
Të tjera	17	17	17	17	17
Disponibël për konsum final	2.123	2.157	2.025	2.060	2.147
– Qymyr	73	93	140	61	100
– Naftë	1.235	1.287	1.160	1.270	1.299
– Gaz natyror	5	8	12	51	54
– Energji elektrike	593	561	507	474	515
– Dru zjarri	202	193	190	190	165
– Të tjera	15	16	16	15	16

Burimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN)

Tab. 3
Prodhimi dhe konsumi i energjive parësore, për frymë

(ktoe /10.000 banorë)

Emërtimi	2013	2014	2015	2016	2017
Prodhimi gjithsej	7,05	6,99	7,33	7,00	5,78
– Qymyr	0,01	0,00	0,24	0,01	0,16
– Naftë	4,17	4,73	4,43	3,67	3,34
– Gaz natyror	0,06	0,10	0,11	0,27	0,28
– Energji elektrike	2,07	1,40	1,75	2,33	1,35
– Dru zjarri	0,70	0,70	0,74	0,65	0,58
– Të tjera	0,06	0,06	0,06	0,06	0,06
Konsumi gjithsej	7,33	7,46	7,01	7,16	7,47
– Qymyr	0,25	0,32	0,49	0,21	0,35
– Naftë	4,26	4,45	4,01	4,42	4,52
– Gaz natyror	0,02	0,03	0,04	0,18	0,19
– Energji elektrike	2,05	1,94	1,76	1,65	1,79
– Dru zjarri	0,70	0,67	0,66	0,66	0,57
– Të tjera	0,05	0,05	0,05	0,05	0,05

Burimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN)

Tab. 4
Konsumi i energjisë sipas degëve

(ktoe)

Emërtimi	2013	2014	2015	2016	2017
Konsumi final i energjisë në:	1.971	2.070	1.973	1.917	2.070
Industri	305	418	360	318	413
Transport	802	816	813	827	828
Konsumatorët familjarë, biznese, administrata publike etj	760	722	701	669	689
- nga të cilët konsumatorë familjarë	572	546	522	499	485
Bujqësi	76	80	71	74	74
Peshkim	27	34	29	29	39
Të tjera	1	0	0	0	22

Burimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN)

BILANCI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Hyrje


Energjia elektrike është burimi kryesor i energjisë në vendin tonë. Operatorët kryesorë që operojnë janë Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH), Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit.

Gjatë vitit 2017, prodhimi neto vendas i energjisë elektrike është 4.525 GWh nga 7.136 GWh energji të prodhuar në 2016, duke shënuar rënie të prodhimit prej 36,6 %.

Rënia e prodhimit të energjisë elektrike në vitin 2017 ka ndikuar në rritjen e importeve dhe rënien e eksporteve të energjisë elektrike. Importet bruto (energji në marrje) u rritën me 86,3 %, ndërsa sasia e eksporteve bruto (energji në dhënie) u ul me 73,9 %, krahasuar me vitin 2016.

Energjia elektrike e prodhuar në vitin 2017 është 4.525 GWh ku 64,5 % e prodhimit është realizuar nga hidrocentralet publike dhe 35,5 % nga prodhues të pavarur privatë dhe koncesionarë.

Fig. 1
Energji në dispozicion, prodhimi neto vendas, importi dhe eksporti bruto



Importi bruto i energjisë elektrike (energji në marrje) rezultoi me rritje në vitin 2017, duke arritur vlerën 3.403 GWh nga 1.827 GWh që ishte në vitin 2016.

Eksporti bruto i energjisë elektrike (energji në dhënie) arriti vlerën 488 GWh në vitin 2017, nga 1.869 GWh që ishte vitin e kaluar.

Në vitin 2017, humbjet në rrjet janë 1.876 GWh nga 1.986 GWh që ishin në vitin 2016, duke pësuar një rënie me 5,5 %. Humbjet në shpërndarje, në vitin 2017, kanë rënë me 4,3 %, krahasur me vitin e kaluar. Humbjet në transmetim kanë rënë me 16,9 % dhe përbëjnë 8,4 % të humbjeve gjithsej në rrjet.

Përdorimi i energjisë elektrike nga konsumatorët, në vitin 2017, u rrit me 8,9 %, duke arritur vlerën 5.563 GWh, nga 5.108 GWh që ishte në vitin 2016. Ndikimin më të madh në rritjen e përdorimit të energjisë elektrike nga konsumatorët e kanë dhënë konsumatorët jofamiljarë, të cilët kontribuan me +7,6 pikë përqindje në vitin 2017, krahasuar me vitin 2016, përkundërt kontributit prej +1,3 pikë përqindje të energjisë së konsumuar nga konsumatorët familjarë.

Fig. 2
Shkëmbimi i energjisë elektrike




Fig. 3
Konsumi i energjisë elektrike, humbjet në rrjet dhe përdorimi nga konsumatorët





Fig. 4
Përdorimi i energjisë elektrike nga konsumatorët



I Burimi i të dhënave

Bilanci i Energjisë Elektrike jep informacion statistikor mbi prodhimin neto vendas të energjisë elektrike, shkëmbimin e energjisë elektrike, humbjet në rrjet, si edhe konsumin final në vendin tonë. Statistikat për energjinë elektrike publikohen për periudhë gjashtëmujore nga të dhënat mujore të grumbulluara prej burimeve administrative, si:

- KESH sh.a, shoqëri e pavarur shtetërore që prodhon, transformon dhe kryen shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike;
- OSHEE sh.a, shoqëri e pavarur shtetërore që kryen furnizimin, shitjen e energjisë elektrike, si edhe operimin dhe menaxhimin e rrjetit të shpërndarjes;
- OST sh.a, shoqëri e pavarur shtetërore që operon në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike nga pikëpamja fizike dhe e shpërndarjes. OST sh.a garanton kapacitetet e nevojshme transmetuese për:
- furnizimin e pandërprerë me energji elektrike të nënstacioneve të sistemit të shpërndarjes dhe konsumatorëve të energjisë elektrike të lidhur direkt në rrjetin e transmetimit;
- transmetimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vendit;
- tranzitet dhe shkëmbimet e nevojshme me vendet e rajonit.

I Përkufizime

Energji në dispozicion i referohet sasisë së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhimi vendas i energjisë elektrike plus sasisë së importuar (përfshirë këmbimet) minus sasisë së eksportuar (përfshirë këmbimet).

Prodhimi neto vendas llogaritet si shumë e sasisë bruto të energjisë elektrike të prodhuar nga të gjithë prodhuesit në vend si prodhimi i hidrocentraleve, termocentraleve dhe prodhuesit e tjerë, duke zbritur konsumin dhe humbjet vetjake në prodhim.

Energji termo i referohet energjisë elektrike të prodhuar nga termocentralet.

Energji hidro i referohet sasisë së energjisë elektrike të gjeneruar nga uji në hidrocentralet.

Humbjet dhe konsumi vetjak i referohet energjisë elektrike të përdorur nga veprimtaritë ndihmëse të stacionit të energjisë të lidhura direkt me

prodhimin si ftohje e ujit, shërbimet e stacionit të energjisë, ngrohje, ndriçim, etj.

Prodhues të pavarur privatë dhe koncesionarë u referohen prodhuesve private të energjisë elektrike, të cilët, në rastin e Shqipërisë, përbëhen nga impiante ish-publike të privatizuara ose impiante të ndërtuara nga subjektet private vendase apo të huaja, përmes kontratave koncesionare me Republikën e Shqipërisë. Këta prodhues lidhen direkt në sistemin e transmetimit dhe linçensohen nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) dhe mund t'i shesin kapacitete ose energji OST-së dhe OSHEE-së, për të mbuluar humbjet në sistemin e transmetimit dhe shpërndarjes, si edhe tek klientët të tjerë.

Prodhues të tjerë i referohet prodhimit të energjisë elektrike nga burime të tjera të energjisë, duke përfshirë energjinë hidro dhe termo.

Shkëmbimi i energjisë elektrike i referohet diferencës midis eksportit dhe importit të energjisë elektrike. Kjo përfshin edhe tranzitet dhe shkëmbimet (dhënie – marrje energjie) e nevojshme të energjisë elektrike me vendet e rajonit.

Konsumi i energjisë elektrike i referohet përdorimit nga konsumatorë familjarë dhe jofamiljarë, dhe sasisë së humbjeve në rrjet të energjisë elektrike.

Humbjet në rrjet përbëjnë humbjet në transmetim, duke përfshirë edhe konsumin vetjak në transmetim, si edhe humbjet në shpërndarje. Humbjet teknike në shpërndarje janë të vlerësuara nga OSHEE sh.a. Humbjet jo teknike i referohen diferencës së humbjeve gjithsej në shpërndarje me humbjet teknike në shpërndarje, si edhe të diferencave statistikore që rrjedhin nga ndryshimet në kohën e matjes së prodhimit, e cila është e sfazuar me të dhënat e shitjes apo konsumit.

Përdorimi nga konsumatorët është i barabartë me shumën e energjisë elektrike të konsumuar nga konsumatorë familjarë dhe jofamiljarë. Familjarët i referohet sasisë së konsumit të energjisë elektrike në familje.

Jofamiljarët i referohet sasisë së konsumit të energjisë elektrike nga sektorët e industrisë, transportit, agrikulturës, shërbimeve publike, etj., duke përfshirë konsumin nga familjarët.

Tab. 1
Bilanci i energjisë elektrike

MWh

Treguesit		2013	2014	2015	2016	2017
A	Energji në dispozicion (A=1+2-3)	7.857.033	7.793.736	7.265.089	7.094.061	7.439.609
1	Prodhimi neto vendas (1=1.1+1.2+1.3)	6.959.326	4.726.246	5.865.671	7.135.914	4.524.981
1,1	Termocentrale	0	0	0	0	0
1,2	Hidrocentrale (1.2=a+b)	6.959.326	4.726.246	5.865.671	7.135.914	4.524.981
a	Publike (a=a.1-a.2)	5.811.762	3.408.556	4.451.975	5.091.616	2.916.990
a.1	Prodhim bruto i hidrocentraleve publike	5.839.414	3.429.701	4.475.819	5.151.784	2.945.029
a.2	Konsum dhe humbje vetjake	27.652	21.145	23.844	60.168	28.038
b	Prodhues të pavarur privatë dhe koncesionarë	1.147.564	1.317.690	1.413.696	2.044.297	1.607.991
1,3	Të tjerë prodhues (energji të rinovueshme të tjera)	0	0	0	0	0
2	Importi bruto (energji në marrje)	2.322.528	3.355.987	2.355.358	1.826.753	3.403.043
3	Eksporti bruto (energji në dhënie)	1.424.821	288.497	955.941	1.868.605	488.415
B	Konsumi i energjisë elektrike (B=1+2)	7.857.033	7.793.736	7.265.089	7.094.061	7.439.609
1	Humbjet në rrjet (1.1+1.2)	3.305.622	2.783.182	2.195.837	1.985.901	1.876.138
1,1	Humbjet dhe konsumi vetjak në transmetim	209.655	160.942	158.581	190.008	157.906
1,2	Humbjet në shpërndarje (1.2=a+b)*	3.095.967	2.622.241	2.037.256	1.795.892	1.718.232
a	Humbjet teknike në shpërndarje	1.086.049	1.459.175	1.366.520	1.346.501	1.247.678
b	Humbjet jo teknike në shpërndarje	2.009.918	1.163.065	670.736	449.391	470.555
2	Përdorimi nga konsumatorët (2=2.1+2.2)	4.551.411	5.010.553	5.069.252	5.108.160	5.563.471
2,1	Familjarë	2.269.335	2.501.800	2.522.261	2.587.259	2.655.417
2,2	Jo Familjarë	2.282.076	2.508.754	2.546.991	2.520.901	2.908.053

TRANSPORTI



I Hyrje


Ky kapitull paraqet të dhëna mbi statistikat e transportit. Statistikat e transportit përshkruajnë tiparet kryesore të transportit jo vetëm në termat e sasisë së mallrave, numrit të pasagjerëve që lëvizin çdo vit, numrit të mjeteve dhe infrastrukturës që përdoret, por gjithashtu dhe të kontributit të shërbimeve të transportit në ekonomi si një e tërë.

Grumbullimi i të dhënave mbështetet në Ligjin e Statistikës, në Programin e Statistikave Zyrtare 2017-2021, (PSZ), si dhe në rregulloret e Komisionit Evropian mbi statistikat e transportit. Statistikat e transportit i sigurojnë të dhënat nga burimet administrative dhe mbulojnë të gjithë llojet e transportit. Statistikat prodhohen mbështetur në të dhënat mbi numrin e pasagjerëve, sasinë e mallrave, numrin e mjeteve dhe aksidenteve. Të dhënat mbi numrin e pasagjerëve pasqyrojnë tendencën e lëvizjes së pasagjerëve në vendin tone sipas mënyrave të ndryshme të lëvizjes së tyre me hekurudhë, det dhe ajër. Statistikat e transportit të mallrave sigurojnë informacion mbi sektorin e transportimit të mallrave në vendin tone nëpërmjet tre mënyrave të transportit me tokë (hekurudhë), me det dhe ajër.

I Gjetjet kryesore

Në periudhën kohore 2013-2017, numri mesatar vjetor i pasagjerëve që udhëtojnë me linjat hekurudhore është ulur 30,1 %, me linjat detare është rritur 10,6 % dhe me linjat ajrore është rritur 10,8 %. Pra, vihet re se midis tre mënyrave të lëvizjes së pasagjerëve transporti ajror rezulton me rritjen me të madhe të numrit mesatar vjetor të pasagjerëve. Në harkun kohor 2013 -2017, numri i udhëtarëve që lëvizin me linjat hekurudhore është 32.034 mijë pasagjerë për km. Në këtë hark kohor, numri i mesatar vjetor i pasagjerëve për km është ulur me 30,3 % shoqëruar me uljen e numrit të pasagjerëve për mijë banorë nga 4 në vitin 2013 ka shkuar në 1 pasagjerë për mijë në vitin 2017. Gjatë harkut kohor 2013-2017, numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linjat detare është afro 6 milionë persona, ku përfshihen pasagjerë shqiptarë dhe të huaj. Gjithashtu, gjatë këtij harku, numri më i lartë i pasagjerëve për mijë banorë është regjistruar në vitin 2017 me 524 pasagjerë, ku mesatarja për pesë vite është 422 pasagjerë për mijë banorë. Në harkun kohor 2013-2017, në aeroportin e vendit tonë kanë kryer veprimtari ajrore afro 17 shoqëri fluturimi. Gjatë kësaj periudhe, numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linjat ajrore ka qenë afro 10,4 milionë pasagjerë. Në transportin ajror, numri i pasagjerëve ka tendencë rritje ndër vite, nga 606 pasagjerë për mijë banorë në vitin 2013 në 914 pasagjerë për mijë banorë në vitin 2017.

Fig.1
Numri i pasagjerëve në transportin tokësor , detar dhe ajror, 2013-2017



I Transporti i mallrave

Gjatësia e linjës hekurudhore në shfrytëzim në vitin 2017, është 334 km nga 346 km që ka qenë në vitin 2013. Në periudhën kohore 2013-2017, transporti hekurudhor i mallrave është rritur mesatarisht 29,5 %, ndërsa transporti i mallrave në ton për km është rritur mesatarisht 39,1 % gjatë të njëjtës periudhë. Në vitin 2017, volumi i ngarkim shkarkimit në rrugë

detare është rritur 7,1 % në krahasim me 2016, ndërsa në harkun kohor 2013-2017, ky volum është rritur mesatarisht 0,2 %. Transportimi i mallrave dhe i postës me rrugë ajrore në periudhën 2013-2017 ka qenë mesatarisht 1.790 ton mallra dhe 447 ton me postë ajrore. Viti 2014 shënon sasinë më të madhe të mallrave të transportuara me ajër me 1.845 ton mallra dhe vlerën më të lartë të shërbimit postar me 480 ton gjithsej.

Tab. 1

Transporti i mallrave hekurudhor, detar dhe ajror,
2013-2017

Vitet	Transporti hekurudhor i mallrave 000/ton.km	Transporti hekurudhor i mallrave 000/ton	Volumi detar i ngarkim shkarkimit 000/ton	Transporti ajror i mallrave ton	Posta ton
2013	22.975	151	4.001	1.778	386
2014	39.889	338	4.066	1.845	480
2015	23.125	198	3.840	1.766	463
2016	8.827	76	3.754	1.751	449
2017	25.287	150	4.022	1.811	455

I Numri i mjeteve të transportit rrugor

Gjatë periudhës kohore 2013-2017, numri mesatar i mjeteve të transportit rrugor për pasagjerë është rritur mesatarisht 5,5 %, ku rritja më e madhe është shënuar në vitin 2014 me 11,0 %. Numri i tyre për mijë banorë është nga 129 mjete në 2013 në 160 mjete në 2017, ku numri mesatar vjetor gjatë kësaj periudhe është 151 mjete për banorë. Në numrin gjithsej të mjeteve rrugore për pasagjerë, peshën më të madhe me 91,2 %

e zënë mesatarisht autoveturat. Numri mesatar i autoveturave për banorë gjatë të njëjtit hark kohor është 137 autovetura për mijë banorë. Në vitin 2016, është shënuar rritja më e madhe e numrit të autoveturave me 152 autovetura për mijë banorë. Mjetet e transportit rrugor për mallra në harkun kohor 2013-2017 kanë pasur një tendencë rritje mesatarisht me 5.6 %. Në numrin gjithsej të mjeteve të transportit për mallra peshën mesatare më të madhe e zënë kamionët dhe traktorët rrugorë me 89,7 %.

Tab. 2

Mjetet e transportit rrugorë për pasagjerë dhe mallra,
2013-2017

Mjetet e transportit rrugorë për pasagjerë						Mjetet e transportit rrugorë për mallra				
	Gjithsej	Autovetura	Autobuz dhe mikrobuz	Motoçikleta dhe triçikla	Kamping	Gjithsej	Kamionna dhe Traktorë rrugore	Makineri bujqesore	Rimorkio	Të tjera
2013	374.068	341.691	5.676	26.664	37	71.884	65.061	543	6.081	199
2014	415.121	378.053	6.048	30.975	45	75.769	68.442	642	6.460	225
2015	443.227	403.680	6.423	33.070	54	78.839	71.011	736	6.787	305
2016	479.217	436.013	7.050	36.096	58	83.889	74.973	967	7.504	445
2017	460.299	422.084	6.761	31.399	55	75.271	66.588	822	7.326	535

I Aksidentet

Statistikat mbi aksidentet mbulojnë numrin e aksidenteve dhe të vrarëve që ndodhin në transportin rrugor dhe hekurudhor. Siguria është çështja kryesore e çdo lloj transporti. Aksidentet rrugore janë shumë prezente në ditët tona ku mbeten persona të vrarë apo dhe të plagosur. Shkaktohet për mundësinë e ndodhjes së aksidenteve janë të shumta si: cilësia e infrastrukturës rrugore, kushtet klimaterike, gjeografike si dhe dendësia e popullsisë. Gjithashtu, sjellja e drejtuesve të mjeteve përbën shkak për mundësinë e ndodhjes së aksidenteve si: mungesa eksperiencës,

shpejtësia mbi normat e lejuara, moszbatimi i rregullave të qarkullimit, konsumi i alkoolit, etj. Në vitin 2017 numri i aksidenteve rrugore është ulur me 2,7 % krahasuar me vitin 2016. Gjatë periudhës 2013-2017 numri mesatar i të vdekurve nga aksidentet rrugore ishte 264 persona. Viti 2017 ishte viti me numrin më të ulët të të vdekurve nga aksidentet rrugore me 222 persona. Gjatë periudhës 2013-2017 numri mesatar i aksidenteve hekurudhore ka qënë 15 aksidente. Viti 2014, shënon numrin më të ulët të të aksidentuarve me 8 persona. Gjithashtu, numri i personave të vdekur në vitin 2014 ishte 1 person , nga 3 vdekur që është numri mesatar i tyre

Tab. 3
Aksidentet rrugore, 2013-2017

Vitet	Numri i aksidenteve	Numri i personave të aksidentuar (gjithsej)	Të vrarë	T ë Plagosur
2013	2.075	2.798	295	2.503
2014	1.914	2.617	264	2.353
2015	1.992	2.692	270	2.422
2016	2.032	2.778	269	2.509
2017	1.978	2.611	222	2.389

Tab. 4
Aksidentet hekurudhore, 2013-2017

Vitet	Numri i aksidenteve	Numri i persona të aksidentuar (gjithsej)	Të vrarë	T ë Plagosur
2013	23	22	4	18
2014	8	6	1	5
2015	25	17	3	14
2016	11	17	3	14
2017	9	8	2	6

I Burimi i të dhënave

Informacioni statistikor mbi transportin merret nga burimet administrative. Informacioni sigurohet nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturaes..

I Përkufizim

Transporti hekurudhor mbulon shërbimet e lëvizjes së pasagjerëve dhe mallrave me linjat hekurudhore brenda vendit.

Transporti detar mbulon shërbimet e lëvizjes së pasagjerëve dhe mallrave në porte.

Transporti ajror mbulon mbulon shërbimet e lëvizjes së pasagjerëve dhe mallrave me linjat ajrore .

PRODUKTI I BRENDSHËM BRUTO (PBB)



I Hyrje

Llogaritë Kombëtare pasqyrojnë zhvillimet makro-ekonomike të një vendi dhe i ofrojnë përdoruesve tregues kryesorë dhe informacion bazë për zhvillimin ekonomik të tij. Ato tregojnë se sa është kapaciteti prodhues i vendit, sa konsumohet, investohet dhe shkëmbehet me vendet e tjera të botës.

Në Qershor 2014, Shqipëria fitoi statusin e vendit kandidat për aderim në Bashkimin Evropian, status i cili shoqërohet me një numër të madh detyrimesh për të qenë në linjë të plotë me standardet e BE-së. Pjesë e këtyre detyrimeve është edhe zhvillimi i statistikave, veçanërisht i atyre të Llogarive Kombëtare, në përputhje me Sistemin Evropian të Llogarive Kombëtare dhe Rajonale (ESA 2010). Në Shtator të vitit 2014, të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian implementuan ESA 2010. Në këtë kuadër, Llogaritë Kombëtare në Shqipëri kanë bërë një punë intensive në fushën e statistikave për implementimin e ESA 2010 dhe Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE

Rev.2, të cilat janë reflektuar në të dhënat e PBB-së. Implementimi i kësaj metodologjie është shumë i rëndësishëm pasi siguron përpilimin e statistikave të llogarive kombëtare në mënyrë konsistente, të krahasueshme, të besueshme dhe të përditësuara. Në këtë mënyrë, përshkrimi i ekonomisë së vendit apo rajoneve të tij bëhet plotësisht i krahasueshëm me ekonominë e vendeve të tjera.

I Gjetjet kryesore

Produkti i Brendshëm Bruto me çmime korrente ka pasur ritme në rritje përgjatë viteve 2012-2016, duke u vlerësuar me 1.475.251 milionë lekë në 2016, nga 1.332.811 milionë lekë në vitin 2012. Në terma realë, ekonomia shqiptare gjatë vitit 2016 shënoi një rritje prej +3,35 %, krahasuar me vitin 2015, pas një rritje prej +2,22 % në vitin 2015, krahasuar me vitin 2014. Mbështetur mbi rezultatet e paraqitura në tabelën e mëposhtme, PBB për frymë, në vitin 2016, arriti në 513 mijë lekë (ose € 3.734) nga 498 mijë lekë (ose € 3.563) që ishte në vitin 2015. Mesatarja e PBB për banor, gjatë viteve 2012-2016, është 484 mijë lekë.

Tab. 1

Treguesit kryesorë të llogarive kombëtare

Treguesit	Njësia	2012	2013	2014	2015	2016*
Burimet (me çmime korrente)	Mln lekë	1.966.865	1.984.002	2.053.817	2.073.055	2.150.117
PBB me çmime tregu	Mln lekë	1.332.811	1.350.053	1.395.305	1.434.307	1.475.251
Importet e mallrave e shërbimeve (fob)	Mln lekë	634.054	633.950	658.512	638.749	674.866
Përdorimet (me çmime korrente)	Mln lekë	1.966.865	1.984.002	2.053.817	2.073.055	2.150.117
Eksportet e mallrave e shërbimeve (fob)	Mln lekë	385.682	390.386	393.657	391.098	426.693
Konsumi Final i Popullatës	Mln lekë	1.032.478	1.073.609	1.119.647	1.146.558	1.186.805
Konsumi Final i Administratës Publike dhe i Institucioneve Jo-fitimprurëse	Mln lekë	151.214	155.680	167.371	170.213	178.465
Formimi Bruto i Kapitalit Fiks	Mln lekë	353.044	352.088	337.087	350.164	361.989
Ndryshimet e gjendjeve dhe Mospërputhje statistikore	Mln lekë	44.447	12.240	36.054	15.022	(3.835)
Rritja vjetore e PBB (krahasuar me çmimet e vitit të mëparshëm)	%	1,42	1,00	1,77	2,22	3,35
Produkti i Brendshëm Bruto për frymë	1000 lekë	460	466	483	498	513
	Euro	3,305	3,323	3,450	3,563	3,734
	USD	4,248	4,411	4,579	3,953	4,132

2016* Gjysmë-finale

Struktura e prodhimit të brendshëm bruto, sipas 3 grupimeve kryesore të aktiviteteve ekonomike, nuk ka pësuar ndryshime të rëndësishme përgjatë viteve 2012-2016. Peshën më të madhe në ekonomi, gjatë vitit 2016, kanë vazhduar ta zënë

aktivitetet Shërbimet (me një mesatare prej 46,67 %), ndjekur nga Industria dhe Ndërtimi (21,13 %) dhe Bujqësia, gjuetia, pyjet dhe peshkimi (19,91 %), sipas shifrave të paraqitura në tabelën e mëposhtme.

Tab.2

Struktura e PBB sipas aktivitetit ekonomik (në %)

Aktiviteti ekonomik	2012	2013	2014	2015	2016*
Bujqësia, gjuetia, pyjet dhe peshkimi	18,77	19,57	19,99	19,78	19,91
Industria dhe Ndërtimi	22,92	23,06	21,51	21,76	21,13
Shërbimet	44,95	44,61	45,78	46,28	46,67


2016* Gjysmë-finale

Konsumi final, i cili përbëhet nga konsumi final i familjeve, i administratës publike dhe institucioneve jofitimprurëse në shërbim të familjeve, përbën peshën kryesore të shpenzimeve në ekonomi, me 92,54 % në vitin 2016. Ky komponent u rrit me 2,94 % në terma reale. Në vitin 2016, Formimi Bruto i Kapitalit Fiks përbën

24,54 % të PBB-së dhe u rrit me 3,34 % në terma reale, krahasuar me vitin 2015. Eksportet e mallrave dhe shërbimeve u rritën në terma reale me 11,34 %, krahasuar me vitin 2015, ndërkohë që importet e mallrave dhe shërbimeve u rritën në terma reale me 6,95 %.

Fig. 1

Struktura e PBB me metodën e shpenzimeve në %, vitet 2015 dhe 2016*




*vlerësimi për vitin 2016 është gjysëmfinal

Grafiku i mëposhtëm jep strukturën e shpenzimeve për konsum final të familjeve sipas grupeve kryesore për vitin 2016. Vërehet se grupi "Ushqime dhe pije joalkoolike" zë peshën kryesore në shpenzimet për konsum final të familjeve dhe

grupi "Komunikimi" zë peshën më të ulët. Në një këndvështrim më të përgjithshëm, mund të thuhet se shpenzimet për shërbime përbëjnë 42,14 %, shpenzimet për produkte ushqimore 40,15 % dhe shpenzimet për produkte joushqimore 17,71 %.

Fig. 2

Struktura e shpenzimeve për konsum final të familjeve në %, viti 2016*



*Vlerësimi për vitin 2016 është gjysëm-final

Tab.3

Treguesit kryesorë rajonalë, 2016


Rajonet Statistike niveli 2/3		PBB çmime korrente	PBB çmime korrente	PBB çmime korrente	Struktura ndaj PBB-së	Kontributi ndaj rritjes Reale	PBB për frymë	PBB për frymë	PBB për frymë	Struktura e indeksit për frymë ndaj PBB-së
		mIn Lekë	mIn Euro	mIn USD	%	%	mijë Lekë	Euro	USD	%
AL	Republika e Shqipërisë	1.475.251	10.740	11.884	100	3,35	513	3,734	4,132	100
AL01	Veri	349.612	2.545	2.816	23,7	0,96	422	3,070	3,397	82,2
AL02	Qendër	699.198	5.090	5.632	47,4	1,85	614	4,471	4,948	119,7
AL03	Jug	426.440	3.105	3.435	28,9	0,54	469	3,416	3,780	91,5

*Vlerësimet për vitin 2016 bazohen në të dhëna gjysmë-finale

Në vitin 2016, sipas rajoneve statistikore niveli 2, në rajonin Qendër, PBB me çmime korrente ishte 699,2 miliardë lekë ose 47,4 % ndaj totalit të PBB-së së vendit. Krahasuar me vitin 2015, PBB me çmime korrente shënoi një rritje prej 3,9 %. PBB me çmime korrente në Rajonin Jug ishte 426.4 miliardë lekë ose 28,9 % ndaj totalit të vendit. Krahasuar me

vitin 2015, në rajonin Jug, PBB me çmime korrente shënoi një rritje me 1,8 %. PBB me çmime korrente, në Rajonin Veri, ishte 349.6 miliardë ose 23,7 % ndaj totalit të PBB-së. Krahasuar me vitin 2015, PBB në terma realë, në rajonin Veri, shënoi një rritje prej 4,1 %.


Fig. 3
PBB për frymë sipas rajoneve statistikore niveli 3, viti
2016*



Niveli më i lartë i PBB-së për frymë sipas rajoneve statistikore në nivel 3, në vitin 2016, ishte në Qarkun Tiranë me 699 mijë lekë dhe shënoi një rritje prej 1,9 %, krahasuar me vitin 2015. PBB për frymë e këtij qarku ishte 36,4 % mbi mesataren e vendit. Më pas renditet Qarku Fier, me 530 mijë lekë, duke shënuar një rënie prej 4,2 % ndaj vitit 2015. PBB për frymë e këtij qarku ishte 3,3 % mbi mesataren e vendit.

Niveli më i ulët i PBB-së për frymë sipas rajoneve statistikore në nivel 3, në vitin 2016, u vlerësua në Qarkun Kukës me rreth 314 mijë lekë, duke shënuar një rënie me 1,2 %, krahasuar me vitin 2015. PBB për frymë e këtij qarku ishte 38,8 % nën mesataren e vendit. Më tej, me PBB-në për frymë më të ulët vijon Qarku Elbasan me rreth 360 mijë lekë, duke shënuar një rritje me 3,8 % ndaj vitit 2015. PBB për frymë e këtij qarku ishte 29,9 % nën mesataren e vendit.

Fig. 4
Kontributi i Rajoneve Statistikore në rritjen ekonomike, viti 2016*



*Vlerësimet për vitin 2016 bazohen në të dhëna gjysmë-finale

Në vitin 2016, sipas rajoneve statistikore në nivel 1 (Republika e Shqipërisë), PBB me çmime korrente u vlerësua 1.475.251 milionë lekë, duke shënuar një rritje në terma realë prej rreth 3,35 %, krahasuar me vitin 2015.

Kontributin më të madh në rritjen ekonomike, për vitin 2016, e ka dhënë Qarku Tiranë me +1,62 pikë përqindje, pasuar nga Qarku Vlorë me + 0,44 pikë përqindje dhe Qarku Durrës me +0,39 pikë përqindje.


Kontributin më të ulët në rritjen ekonomike e ka dhënë Qarku Fier me -0,50 pikë përqindje, i pasuar

nga Qarku Kukës me një kontribut prej -0,04 pikë përqindje dhe Qarku Gjirokastrë me një kontribut prej +0,06 pikë përqindje.

Sipas rajoneve statistikore në nivel 3, rritjen më të lartë e shënoi Qarku Vlorë, me një rritje në terma realë prej 7,69 %, i ndjekur nga Qarku Korçë, me një rritje në terma realë prej 6,20 % dhe Qarku Dibër me një rritje në terma realë prej 6,19 %.

Rritja ekonomike u ngadalësua në Qarkun Fier, duke shënuar një rënie në terma realë prej 4,22 % dhe në Qarkun Kukës me një rënie në terma realë prej 2,04 %.

Fig. 5
Pesha ndaj PBB-së sipas rajoneve statistikore niveli 2,3 viti 2016



Në rajonin statistikor niveli 3, pesha më e ulët ndaj totalit të PBB-së në rang vendi u shënuar në qarkun Kukës me 1,7 % dhe në qarkun Gjirokastrë me 2,4 %. Ndërsa peshën më të madhe të PBB-së e shënoi qarku Tiranë me 40,4 %.

Në vitin 2016, pesha ndaj PBB-së për Rajonin Qendër ishte 47,4 % e totalit të Shqipërisë. Pesha ndaj PBB-së për Rajonin Jug ishte 28,9 % e totalit të Shqipërisë. Pesha ndaj PBB-së për Rajonin Veri ishte 23,7 % e totalit të Shqipërisë.

I Metodologji

Llogaritjet e PBB-së mbështeten metodologjikisht në konceptet bazë të Sistemit Evropian të Llogarive (ESA 2010) dhe të Sistemit të Llogarive Kombëtare (SNA 2008) të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Të dyja këto metodologji janë përditësimet më të fundit të ESA 1995 dhe SNA 1993.

Sistemi Evropian i Llogarive Kombëtare dhe Rajonale (ESA 2010) është korniza më e re e llogarive të BE-së e përshtatshme ndërkombëtarisht, e cila siguron një përshkrim sistematik e të detajuar të ekonomisë.

Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) përfaqëson vlerën totale në para të të gjitha të mirave dhe shërbimeve të prodhuara gjatë një periudhe specifike nga njësitë prodhuese rezidente brenda territorit ekonomik të një vendi. Llogaritjet e PBB-së mbështeten metodologjikisht në konceptet bazë të Sistemit Evropian të Llogarive (ESA 2010) dhe të Sistemit të Llogarive Kombëtare (SNA 2008) të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Të dyja këto metodologji janë përditësimet më të fundit të ESA 1995 dhe SNA 1993.

Metodat kryesore të llogaritjes së PBB-së janë:

- Metoda e Prodhimit;
- Metoda e Shpenzimeve;
- Metoda e të Ardhurave.

INSTAT kryen vlerësimin e PBB-së vetëm sipas metodës të prodhimit e të shpenzimeve me çmime korrente dhe konstante.

Vlerësimi i PBB-së me metodën e prodhimit mund të përmbledhet në dy hapa. Në hapin e parë, Vlera e Shtuar Bruto (VSHB) me çmimet bazë për të gjitha degët e aktiviteteve ekonomike vlerësohet si diferencë midis prodhimit me çmimet bazë dhe konsumit ndërmjetës me çmimet e tregut, duke zbritur nga secila degë vlerën e Shërbimeve Ndërmjetësuese Financiare të Matura Indirekt (FISIM).

VSHB= Prodhim – Konsum Ndërmjetës - FISIM

Në hapin e dytë, Vlerës së Shtuar Bruto të të gjitha degëve në total i shtohen taksat mbi produktet dhe i zbriten subvencionet mbi produktet, duke përfshirë në këtë mënyrë PBB-në me çmimet e tregut.

PBB= VSHB + Taksa – Subvencione

Treguesi i rritjes reale të PBB-së është ndër treguesit më të rëndësishëm të sistemit të Llogarive Kombëtare. Për llogaritjen e tij është e nevojshme llogaritja e PBB-së me çmime konstante.

PBB sipas metodës së prodhimit me çmime konstante matet si shumë e vlerës së shtuar të të gjitha aktiviteteve ekonomike me çmime konstante plus taksat minus subvencione mbi produktet me çmime konstante.

Vlerësimi i PBB-së me metodën e shpenzimeve përfshin lidhjen ndërmjet 4 sektorëve të ekonomisë: Familjeve, Ndërmarrjeve, Qeverisë dhe Sektorit të Jashtëm. Duke qenë se PBB mat prodhimin e të gjithë ekonomisë së një vendi, ajo mund të matet gjithashtu duke mbledhur të gjithë shpenzimet e realizuara nga të katër këta sektorë. Përdorimi i kësaj metode është quajtur metoda e Shpenzimeve, e cila bazohet në ekuacionin:

$$PBB = KF + FBKF + NGJ + (E - I)$$

KF- Konsumi Final; FBKF – Formimi Bruto i Kapitalit Fiks; NGJ- Ndryshimi i Gjendjeve; E- Eksportet; I- Importet;

Nga ky ekuacion përftojmë vlerën e PBB-së nominale (me çmime korrente), e cila axhustohet me indeksin e çmimeve, duke na dhënë vlerën e PBB-së reale (me çmimet e vitit të mëparshëm), si treguesi më i rëndësishëm për përcaktimin e rritjes në volum të PBB-së vjetore.

I PBB rajonale

Në Llogaritë Rajonale, si dhe në vlerësimin e tregueve të saj, është përdorur metoda e prodhimit. Ashtu si në Llogaritë Vjetore, të njëjtat burime të dhënash janë përdorur edhe në nivel rajonesh statistikore për matjen e prodhimit dhe konsumit ndërmjetës.

Metodat e përdorura janë një kombinim i metodës Poshtë –Lart, metodës Mikse (Metoda Pseudo-Poshtë-Lart) dhe metodës Lart-Poshtë, në një linjë me Manualin e ESA, Kapitulli 13:

Metoda Poshtë-Lart bazohet në principin se i gjithë informacioni mbledhet nga KAU lokale dhe më pas agregohet në nivel total ekonomie.

Metoda Lart-Poshtë është metoda inverse me atë më sipër. Vlera e VSHB shpërndahet tek një rajon

dhe në degë të ekonomisë, dhe jo tek njësitë lokale. Në këtë rast, indikator shpërndahet me anë të peshave rajonale duke përdorur një tregues sa më të afërt me vlerën e shtuar.

Metoda Pseudo-Poshtë-Lart është një ndërthurje e metodave të mësipërme. Kjo metodë konsiston në vendosjen e peshave rajonale tek ndërmarrjet kur të dhënat për njësitë lokale mungojnë. Peshat mund të jenë treguesit e kompensimit të punonjësve, numri i punonjësve etj., sipas njësive lokale dhe rajoneve statistikore. Mjaft ndërmarrje kanë njësi lokale vetëm në një rajon dhe metoda e përdorur në këtë rast është metoda Poshtë – Lart.

I Klasifikime

Klasifikimet janë thelbësore për prodhimin, përpilimin dhe shpërndarjen e statistikave. Klasifikimet përditësohen herë pas here për të reflektuar zhvillimet ekonomike, teknologjike dhe ndryshimet strukturore të ekonomisë, e për të mundësuar krahasimin dhe lidhjen e të dhënave në nivel evropian dhe në përgjithësi, në atë botëror, si pjesë e një sistemi të integruar.

Klasifikimet e përdorura në Llogaritë Kombëtare janë:

- Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike Rev.2 (NVE Rev.2). Klasifikimi i mëparshëm NVE Rev. 1.1 është përditësuar me klasifikimin e ri NVE Rev. 2, i cili paraqet koncepte të reja në nivele më të larta të klasifikimit dhe detaje të reja të cilat reflektojnë forma të ndryshme të prodhimit, si dhe industritë e reja në zhvillim;
- Nomenklatura e Produkteve (NP);
- Klasifikimi i Konsumit Individual sipas Përdorimit (COICOP);
- Klasifikimi i Shpenzimeve të Qeverisë sipas Funksionit (COFOG)
- Klasifikimi Njësive Territoriale Statistikore (NUTS).

Burimet e informacionit

Për vlerësimet e PBB-së përdoret informacioni i siguruar nga burime të ndryshme statistikore dhe administrative. Të dhënat e përdorura mund të jenë prodhim statistikor i vetë INSTAT ose i institucioneve të ndryshme kombëtare si Ministritë, Drejtoritë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Doganave, Qendra Kombëtare e Regjistrimit, Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Agjencia Kombëtare e Burimeve

Natyrore dhe të tjera. Duke krahasuar këto burime me njëra-tjetrën, arrihet të prodhohet një pamje e vetme e ekonomisë e cila është gjithëpërfshirëse, konsistente, koherente dhe tërësisht e integruar.

Burimet statistikore përfshijnë të dhënat e siguruar nga regjistrime dhe anketa të ndryshme mbi njësitë ekonomike ose familjet, ndër të cilat mund të përmendim: Regjistri i Ndërmarrjeve; Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave; Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve; Anketa e Tregtisë me Pakicë; Anketa e Buxhetit të Familjeve; Anketa e Forcave të Punës; Anketa të Matjes së Nivelit të Jetesës; Anketa të Statistikave të Çmimeve, etj.

